

VLERËSIMI I NDIKIMIT



.. EKIPET E KOSOVËS .. PËR SIGURI NE BASHKËSI




MISSION IN KOSOVO

osce

Organization for Security and
Co-operation in Europe
OSCE Mission in Kosovo








FALËNDERIMET

Ekipi i Programit të Ekipeve Vepruese për Siguri në Bashkësi dëshiron t'i falënderojë EVSB-të për devotshmërinë e tyre të pafund për reduktimin e krimit dhe shtimin e sigurisë në komunitetet e tyre me përkushtim dhe zell si dhe për punën e tyre të përditshme për të përmirësuar kualitetin e jetesës për banorët në qytetet dhe fshatrat e tyre.

Ekipi dëshiron t'i falënderojë Departamentin e Drejtësisë/PNTNHK e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Departamentin për Siguri Publike të Misionit të OSBE-së në Kosovë për përkushtimin e tyre të palodhshëm për përmirësimin e sigurisë dhe rritjes së kualitetit të jetës për të gjitha komunitetet përmes përkrahjes së tyre për këtë program të rëndësishëm dhe për punën që kanë ndërmarrë.

Ekipi i Programit të EVSB-ve i detyrohet dhe falënderon shumë Qendrën e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZh) për përkrahjen e tyre të vazhdueshme dhe me shumë entuziazëm për këtë program. Duke ofruar një "vend të sigurt" për të gjitha EVSB-të gjatë trajnimeve të tyre, pavarësisht nga etnia, gjinia, aftësia, besimi apo mosha, përvoja e pjesëmarrësve ishte pozitive.

Ekipi i Programit gjithashtu dëshiron t'i falënderojë të gjithë ata individë të cilët kanë kontribuar në zhvillimin dhe implementimin e programit të EVSB-të. Falënderime të posaçme i shkojnë (sipas radhitjes alfabetike) Anna Richards, Arbërnore Ymerit, Ardian Veselit, Bedri Xanit, Betim Llapashticës, Erduan Gjigollit, Hana Bajramit, Jirina Foltysova, Julie Fleming, Marija Jović, Monica Llamazares, Nikola Pajović, Remzije Ibrahimit, Shqipe Durgutit, Steve Bennett, Tamara Duffey, Visar Dermakut dhe Ymer Zagragja, si dhe vetë EVSB-ve për kontributin e tyre të paçmueshëm gjatë dizajnimit, hulumtimit dhe shkrimit të këtij Vlerësimi.



PARATHËNIE

Si njerëz, ne të gjithë kemi të drejtë të jetojmë në siguri, me liri të lëvizjes dhe jetë kualitative. Pas konfliktit në Kosovë, individë përjetuan një ndjenjë pasigurie në komunitetet e tyre për shkak të një kombinimi të çështjeve të krimit dhe sigurisë, si dhe mosbesimit në ofruesit apo siguruesit e sigurisë.

Në mënyrë që këto pasiguri të identifikohen dhe adresohen në mënyrë efektive, duhet të punojmë së bashku u në partneritet me komunitetet tona, qeverisjen lokale dhe policinë, që të angazhohemi në përpjekjet parandaluese dhe të zgjidhjes së problemeve. Në vitin 2003, Programi ndihmës trajnues ndërkombëtar për hetimin e krimit (PNTNKH) i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara në partneritet me Departamentin për Siguri Publike të Misionit të OSBE-së në Kosovë, iniciuan programin “Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi” si pilot-program në katër (4) komuna të Kosovës. Ky program buroi nga vizioni i z. Steve Bennett i cili, në atë kohë, ishte Drejtor i Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës (tani Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZh)). Vizioni i tij për të ndërtuar Shërbimin Policor të Kosovës (ShPK) si shërbim demokratik policorë që punon në partneritet me komunitetet dhe komunat, u plotësua nga përvoja e ekipit shumë profesional, pra nga ekspertët ndërkombëtarë dhe në këtë mënyrë formuan formuan bazën për programin e EVSB-ve në Kosovë. Tani, me praninë e tyre në 20 komuna, EVSB-të përbëhen nga banorë të interesuar, policë dhe zyrtarë komunal, të cilët bashkohen për të punuar në partneritet me palë tjera të interesit për të identifikuar dhe implementuar zgjedhje për problemet e sigurisë dhe rendit me të cilat ballafaqohen në komunitetet e tyre. Duke u bazuar në filozofinë e policisë së orientuar në komunitete dhe mendimit të Zotëri Robert Peel që “njerëzit e përbëjnë policinë dhe policia përbën njerëzit” funksioni i EVSB-ve si urë në mes banorëve dhe institucioneve, që punojnë në çështje të ndryshme siç janë mjedisi, siguria në komunikacion, kushtet e dobëta të jetesës në komunitetet joshqiptare dhe sjellja anti-shoqërore në shkolla. Ato vazhdojnë të arrijnë sukses, duke përmirësuar jetën e atyre të cilët i përfshijnë dhe duke formuar partneritete të qëndrueshme dhe besueshme gjatë punës së tyre.

Ndërtimi i kapaciteteve të njerëzve lokal për t’i adresuar brengat e tyre në këtë mënyrë, paraqet një mundësi të çmueshme për zhvillim të qëndrueshëm. Në verë të vitit 2007, u iniciua një hulumtim gjithëpërfshirës në mënyrë që të vlerësohet ndikimi i EVSB-ve në sigurinë e komuniteteve në Kosovë. Ky raport prezanton gjetjet e hulumtimit, duke analizuar suksesin dhe sfidat e programit. Ai gjithashtu identifikon mënyrat në të cilat programi mund të ecë para në një kohë kur të gjitha komunitetet e Kosovës janë të pajisura, të gatshme dhe të vullnetshme për t’iu adresuar brengave të sigurisë në komunitete në bashkëpunim me policinë, autoritetet komunale dhe institucionet tjera përgjegjëse për garantimin e sigurisë dhe rendit në Kosovë.

Jeffrey A. Thomas
Këshilltar i Lartë i Zbatimit të Ligjit
Departamenti i Drejtësisë i SHBA-së/PNTNKH

Carsten Twelmeier
Drejtor, Departamenti për Siguri Publike
Misioni i OSBE-së në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport vlerëson ndikimin që kanë pasur Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSBS) në sigurinë dhe rritjen e kualitetit të jetës në komunat ku veprojnë. Raporti përfaqëson gjetjet kryesore të një hulumtimi të ndërmarrë në vitin 2007 deri në vitin 2008, dhe përqendrohet në çështje të sigurisë në komunikacion, sigurisë së mjedisit, Shërbimin Policor të Kosovës (ShPK) dhe marrëdhëniet e komuniteteve dhe marrëdhëniet ndëretnike. Raporti gjithashtu analizon pikat më të forta të programit të EVSB-së, sfidat me të cilat ballafaqohet ai dhe EVSB-të, si dhe identifikon një numër rekomandimesh për të fuqizuar punën e EVSB-së në të ardhmen.

Që nga formimi i tyre nga Programi ndihmës trajnues ndërkombëtar për hetimin e krimit (PNTNHHK) i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara në partneritet me Misionin e OSBE-së në Kosovë, Departamenti për Siguri Publike, EVSB-të kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në çështjet e sigurisë dhe rritjes së kualitetit të jetës tek komunitetet e Kosovës. Një çështje që rregullisht është adresuar nga EVSB-të me sukses të konsiderueshëm, është siguria në komunikacion. EVSB-të kanë vendosur shenja të rrugëve, kanë krijuar vendkalime për këmbësorë dhe kanë ndërtuar trotuare, duke asistuar për krijimin e parakushteve themelore për nivele të përmirësuara të sigurisë në rrugë, si për këmbësorët ashtu edhe për ngasësit e automjeteve. Më tej, EVSB-të, së bashku me policë të ShPK-së, kanë qenë të suksesshëm në ngritjen e

vetëdijes për çështjet e komunikacionit në mesin e rinisë kosovare. Si rezultat i kësaj, shumica e pjesëmarrësve të EVSB-të dhe përfituesve të intervistuar perceptojnë se niveli i sigurisë në komunikacion është përmirësuar në aspektin lokal. Megjithatë, ky raport thekson nevojën për përkushtim të plotë nga autoritetet komunale dhe palët tjera të interesit në mënyrë që të arrihet një përmirësim i qëndrueshëm në nivelet e sigurisë në komunikacion në Kosovë.

EVSB-të gjithashtu kanë arritur sukses të madh në bërjen e ndryshimeve në kushtet lokale mjedisore. Duke ndërmarrë një numër operacionesh të pastrimit dhe projekte të tjera të fokusuara në mjedis, ata kanë arritur të përmirësojnë dukjen e mjedisit, të ulin rrezikun e shkaktuar nga hedhja e papërshtatshme e mbeturinave dhe rrezikun nga qentë endacak, një problem ky që ndërlidhet me mbeturinat e tepërta. Vetëdija e publikut përkritazi me çështjet mjedisore duket se është në ngritje dhe niveli i përfshirjes në këto projekte është inkurajues. EVSB-të gjithashtu kanë arritur që të ndikojnë pozitivisht në qëndrimin e rinisë kosovare lidhur me çështjet mjedisore. Si i tillë, ky raport gjithashtu vë në dukje nevojën për një përfshirje më të qëndrueshme nga autoritetet komunale, si për largimin e mbeturinave ashtu dhe masave të domosdoshme që problemi i qenve endacak të trajtohet në mënyrë afatgjate.

Si rezultat i qasjes përfshirëse që kanë marrë EVSB-të, ato gjithashtu kanë

qenë në gjendje të ndikojnë pozitivisht në marrëdhëniet ndëretnike në disa komunitete. Duke përfshirë anëtarë të komuniteteve të ndryshme në përbërjet e tyre dhe duke punuar me dhe për komunitetet joshqiptare gjatë implementimit të projekteve, EVSB-të kanë qenë në gjendje të ndërtojnë partneritete të besueshme dhe bashkëpunuese, duke përmirësuar nivelet e besimit, komunikimit dhe lirisë së lëvizjes. EVSB-të gjithashtu janë dëshmuar aktive në ndërtimin e marrëdhënieve në mes rinisë së komuniteteve të ndryshme, një gjë shumë e nevojshme për bashkëpunimin afatgjatë.


Duke asistuar në implementimin e filozofisë së policisë në bashkësi dhe duke i bashkuar ShPK-në dhe qytetarët rregullisht për të punuar në projekte, EVSB-të kanë arritur një ngritje në komunikim, bashkëpunim dhe besim në mes të komunitetit dhe ShPK-së. Megjithatë, ky raport gjithashtu vë në dukje nevojën për një përkushtim në implementimin praktik të policisë në komunitet në mënyrë që ShPK të ngjallë besimin e plotë të publikut.

Ky raport gjithashtu tregon se EVSB-të janë dëshmuar të suksesshme në krijimin e partneriteteve të qëndrueshme në mes siguresve të ndryshëm të sigurisë dhe rendit në Kosovë dhe komuniteteve në të cilat punojnë. Ky raport gjithashtu vë në dukje nevojën që EVSB-të të marrin përkrahjen e domosdoshme financiare dhe logjistike për sukses të vazhdueshëm dhe të shtuar.

PËRMBLEDHJE

1. HYRJE.....	11
2. NDËRTIMI I KAPACITETIT: NJË SHQYRTIM I PROGRAMIT TË EVSB-ve ...	14
2.1 <i>Krijimi dhe trajnimi i EVSB-ve.....</i>	14
2.2 <i>Këshilli Ekzekutiv i EVSB-ve.....</i>	17
2.3 <i>Trajnimi i trajnerëve.....</i>	17
3. NDIKIMET SPECIFIKE TË PROJEKTIT.....	18
3.1 <i>Siguria në komunikacion.....</i>	18
3.1.1 <i>Brengat dhe çështjet kryesore të adresuara nga EVSB-të.....</i>	18
3.1.2 <i>Perceptimi i komunitetit për sigurinë në komunikacion.....</i>	19
3.1.3 <i>Përfshirja sociale në iniciativat për siguri në komunikacion.....</i>	21
3.1.4 <i>Përfshirja e të rinjve dhe ndikimi nga kjo përfshirje.....</i>	22
3.1.5 <i>Kontributi i partnerëve të EVSB-ve.....</i>	23
3.1.6 <i>Partneritetet dhe zgjedhja e problemeve.....</i>	24
3.2 <i>Kushtet mjedisore dhe siguria.....</i>	25
3.2.1 <i>Shqetësimet kyçe dhe çështjet e adresuara nga EVSB-të.....</i>	26
3.2.2 <i>Perceptimet e komunitetit për kushtet mjedisore.....</i>	29
3.2.3 <i>Përfshirja e shoqërisë në nismat mjedisore.....</i>	30
3.2.4 <i>Përfshirja e të rinjve dhe ndikimi mbi ta.....</i>	32
3.2.5 <i>Kontributi i partnerëve të EVSB-ve.....</i>	33
3.2.6 <i>Partneritetet dhe zgjidhja e problemeve.....</i>	35
3.3 <i>Konkludim.....</i>	36
3.4 <i>Rekomandimet.....</i>	38

4. NDIKIMET E GJERA PROGRAMORE.	39
4.1 <i>Bashkëpunimi ndëretnik.</i>	39
4.1.1 <i>Bregat kryesore dhe çështjet e trajtuara nga EVSB-të.</i>	39
4.1.2 <i>Perceptimet e bashkësisë mbi marrëdhëniet ndëretnike.</i>	43
4.1.3 <i>Përfshirja sociale në projektet me elemente ndëretnike.</i>	45
4.1.4 <i>Përfshirja e të rinjve dhe ndikimi në ta.</i>	46
4.1.5 <i>Partneritete dhe zgjidhja e problemeve.</i>	47
4.2 <i>Marrëdhëniet Bashkësi – ShPK.</i>	47
4.2.1 <i>Koncepti i veprimeve policore në bashkësi.</i>	48
4.2.2 <i>Shqetësimet dhe çështjet kryesore të adresuara në EVSB.</i>	49
4.2.3 <i>Pikëpamjet e bashkësisë për ShPK-në.</i>	50
4.2.4 <i>Përfshirja Sociale në marrëdhëniet ShPK-bashkësi.</i>	53
4.2.5 <i>Përfshirja e të rinjve dhe ndikimi në ta.</i>	54
4.2.6 <i>Bashkëpunimi dhe zgjidhja e problemit.</i>	55
4.3 <i>Përfundimi.</i>	58
4.4 <i>Rekomandimet.</i>	58
5. FUQIA, SFIDAT DHE MËSIMET E MËSUARA.	60
5.1 <i>Fuqitë e programit të EVSB-së.</i>	60
5.1.1 <i>Lidhja e bashkësisë dhe institucioneve publike.</i>	60
5.1.2 <i>Krijimi i raporteve të mirëfillta bashkëpunuese.</i>	61
5.1.3 <i>Trajnimi i EVSB-së dhe programi ndihmës.</i>	62
5.2 <i>Sfidat e programit të EVSB-së.</i>	63
5.2.1 <i>Përkrahja financiare dhe logjistike.</i>	63
5.2.2 <i>Komunikimi brenda EVSB-së.</i>	65
5.3 <i>Mësimet e mësuara dhe drejtimi i përparuar.</i>	66
6. KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET	69



1. HYRJE

Në mënyrë që të adresohen në mënyrë efektive brengat e sigurisë dhe rendit, komunitetet lokale duhet të punojnë së bashku me ofruesit e sigurisë dhe institucionet. Ekipet e Kosovës për Siguri në Bashkësi (EVSB), të krijuara dhe administruara përmes një partneriteti bilateral në mes të Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara, Programi ndihmës trajnues ndërkombëtar për hetimin e krimit (PNTNHC)¹ dhe Misionin e OSBE-së në Kosovë, Departamenti i Sigurisë Publike, përpiquen të lehtësojnë këtë bashkëpunim dhe, duke bërë kështu, rrisin kualitetin e jetesës dhe nivelin e sigurisë në komunitetet e Kosovës. Kjo është posaçërisht e rëndësishme duke e pasur parasysh konfliktin e vitin 1998-1999 në Kosovë, që kontribuojë në një ndjenjë të pandërprerë të pasigurisë tek një numër komunitetesh dhe i acarojë brengat tashmë ekzistuese të sigurisë në komunitet.

Që nga fillimi i programit në vitin 2003, EVSB-të, të cilat tani operojnë në 20 komuna të Kosovës, kanë trajtuar rrënjë të ndryshme të krimeve, brenga të sigurisë dhe rendit, nga siguria në komunikacion deri në dhunën familjare, nga dhuna nëpër shkolla e deri tek rreziku nga qentë endacak. Çdo EVSB formohet si rezultat i një përzgjedhjeje të hollësishme dhe programi trajnues,

¹ PNTNHC punon me qeveritë e huaja për të zhvilluar institucione profesionale dhe transparente të zbatimit të ligjit, të cilat i mbrojnë të drejtat e njeriut, e luftojnë korrupsionin dhe ulin rrezikun e krimit dhe terrorizmit tejkombëtar. Për më tepër informacione, ju lutemi shihni: www.usdoj.gov/criminal/icitap

para fillimit të punës së tyre për të krijuar partneritete të zbatueshme, për identifikimin e brengave të komuniteteve, pastaj të implementohen zgjidhjet afatgjate nga poshtë lartë. EVSB-të punojnë me disa palë të interesit në mënyrë që t'i arrijnë objektivat e tyre, duke përfshirë Shërbimin Policor të Kosovës (ShPK), autoritetet komunale, forcën shumëkombëshe paqeruajtëse të NATO-s (KFOR), organizatat lokale joqeveritare (OJQ) dhe udhëheqësit e komuniteteve dhe natyrisht me banorë dhe vetë komunitetet (përfshi këtu përfaqësuesit e komuniteteve joshqiptare, gratë, rininë dhe udhëheqësit fetar). Kjo u ofron individëve një mundësi për të punuar si ekip me qëllim të përmirësimit të mundësive për të bërë ndryshime dhe për të krijuar themele të forta për zhvillim të ardhshëm të komunitetit të tyre.

Në vitin 2006, ekipi i programit të EVSB-ve vendosi të bëjë një vlerësim të programit në mënyrë që të shihet se çfarë ndikimi kanë EVSB-të në krim, siguri dhe kualitet të jetesës, si dhe në ndryshimet e gjëra shoqërore. Si i tillë, u vendos të iniciohej një vlerësim që ishte i natyrës pjesëmarrëse, një *Vlerësim Pjesëmarrës i Ndikimit* (në tekstin e mëtejshëm, *Vlerësimi*). Një hulumtim i tillë është i dobishëm në dokumentimin e ndikimeve të paqëllimshme të një programi afatgjatë që mund të mos identifikohet në aktivitete më të ngushta monitorimi/vlerësimi. Ai është i dobishëm për shqyrtimin e programeve afatgjata të cilat, për arsye të afatit kohorë, ka gjasë të kenë ndikim më të gjerë se sa projektet e implementuara më shpejtë. Për më tepër, është një proces i dobishëm i mësimit për organizatat/ekipet dhe partnerët e tyre, të cilët dëshirojnë t'i shqyrtojnë intervenimet e

tyre në suaza komplekse (p.sh., rindërtimi i Kosovës së pas-konfliktit) ku akterë/aktivitete të shumta intervenojnë në nivele të ndryshme. Përfshirja e implementuesve, partnerëve implementues dhe përfituesve në një përpjekje bashkëpunuese për të dokumentuar dhe mësuar nga ndikimet e programit, jo vetëm që i bënë më të vlefshme këto gjetje, ajo gjithashtu promovon pronësi të procesit.

Vlerësimi 20 mujor ka bashkuar këshilltarë të jashtëm, implementues të programit dhe një ekip të vogël të ndihmës hulumtueseve lokal, ndërsa angazhon në mënyrë aktive anëtarët e EVSB-ve të shqyrtojnë me vendosmëri programin 5 vjeçar. Qëllimi i hulumtimit, që nga fillimi i tij, ishte t'i bashkojë Ekipin e Programit të EVSB-ve dhe anëtarët e EVSB-ve si partnerë implementues të një aktiviteti pjesëmarrës:

- T'i nxjerrë mësimet e mësuara gjatë katër viteve të implementimit të programit në mënyrë që të rritet qëndrueshmëria.
- Të kanalizohen këto mësimet ashtu siç shfaqeshin në fazën e re të programit të EVSB-ve për implementim në 2007 dhe 2008.

Gjatë takimit të Këshillit Ekzekutiv të EVSB-ve² në tetor 2006, në Štrpce/Shtërpçë, Ekipi i Programit të EVSB-ve prezantoi idenë e implementimit të përbashkët të një vlerësimi pjesëmarrës të ndikimit. Përgjigja ishte pozitive dhe përkrahëse, ndonëse u bë e qartë se kjo do të ishte një përvojë e re dhe sfiduese për EVSB-të dhe Ekipin e Programit të EVSB-ve, meqë nuk ishin kryer vlerësime sistematike të

programit apo projekteve të EVSB më parë. Mjetet kryesore të hulumtimit ishin intervistat individuale në terren dhe intervistat grupore për të nxjerrë të dhëna kualitative, si dhe pyetësorët e strukturuar për ta plotësuar këtë me të dhëna sasiore, për të mundësuar një analizë krahasuese. Një seancë fillestare për dizajnin e metodologjisë u mbajt me qëllim të nxjerrjes së pikëpamjeve të Ekipit të Programit të EVSB-ve si implementues të parë të programit. Gjatë seancës u diskutuan ndikimet provuese, treguesit e realizueshëm dhe mjetet e sugjeruara të verifikimit. Natyra pjesëmarrëse e Vlerësimit u siguroi që në fillim, meqë EVSB-të kontribuuan në dizajnin e metodologjisë së hulumtimit. Disa punëtori u lehtësuan nga ekipi hulumtues, ku anëtarët e EVSB-ve i shpalosën treguesit dhe mjetet kryesore për verifikim, të cilat shërbyen si udhërrëfyes për punën e ekipit hulumtues. Gjatë këtyre punëtorive, u vendos për orarin e hulumtimit, si dhe për rolet dhe përgjegjësitë e EVSB-ve në mbështetje të Vlerësimit.

Hulumtimi në terren filloi në shkurt 2007, me ndihmën dhe pjesëmarrjen e të gjitha 16 njësive të EVSB-ve që vepronin në atë kohë.³ U bënë një sërë vizitash të komunitetit, gjatë të cilave u kryen intervista individuale dhe grupore me palë kyçe të programit dhe përfituesit, duke i përfshirë këtu përfaqësuesit komunal, mësuesit e shkollave, policët dhe anëtarët e komunitetit. Në total, mbi 250 individë morën pjesë në hulumtim, përfshi këtu edhe anëtarët e komuniteteve

2 Për më tepër informata mbi këtë mekanizëm, ju lutemi shihni pjesën 2.2

3 Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Leposavić/Leposaviq, Lipjan/Lipljan, Novobërdë/Novo Brdo, Obiliq/Obilić, Prizren, Rahovec/Orahovac, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina dhe Vushtrri/Vučitrn.

të ndryshme etnike të Kosovës. Kujdes i veçantë u tregua në përfshirjen e mendimeve të grave dhe rinisë. Modeli i atyre që janë intervistuar për vlerësimin nuk pretendon të jetë përfaqësues për Kosovën, apo qoftë edhe i atyre komunave ku është kryer hulumtimi. Në vend të kësaj, intervistat ofrojnë një informacion për përvojat e atyre që përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthore apo që ndikohen nga programi i EVSB-ve për nxjerrjen e mësimeve të dobishme. Intervistat e terrenit u kryen gjatë një periudhe 5 mujore (maj-shtator 2007), që duhet mbajtur mend si diçka që më së miri e vendos në kontekst “ndryshimin” apo ndikimin në afate kohore të dhëna nga hulumtimi (p.sh. “sa mendoni që është përmirësuar niveli i sigurisë në komunikacion në lagjen tuaj gjatë dymbëdhjetë muajve të kaluar?), meqë mund t’i sqarojë ndryshimet në përgjigjet e të intervistuarve.

Analiza dhe shënimi i të dhënave filloi në vjeshtë të vitit 2007, kur u kontraktua kompania hulumtuese ‘Prishtina Regional Enterprise Agency’ (Prishtina-REA) për të ofruar një analizë statistikore të elementeve sasiore të intervistave të terrenit. Në pranverë të vitit 2008 u bënë disa hulumtime shtesë. Megjithatë, përveç nëse nuk theksohet ndryshe, analiza që përmban ky Vlerësim i referohet aktiviteteve dhe ndikimeve deri në mesin e vitit 2007.

Ky raport shqyrton disa nga ndikimet më të rëndësishme që ka pasur programi i EVSB-ve në Kosovë në fushën e krimit, sigurisë dhe kualitetit të jetesës, si dhe anën e fortë dhe sfidat e të njëjtit. Ndonëse ndikimi shpesh matet në aspektin sasiorë, ky

Vlerësim, domosdoshmërisht, ka shqyrtuar objektiva më pak të prekshme: ai përpiket të identifikojë një ndryshim në sjelljet dhe qasjet e shoqërisë, të cilat mund të maten në mënyrë të saktë vetëm nëse bëhen gjatë një periudhe të konsiderueshme kohore dhe përmes metodave kualitative. Sidoqoftë, ky vlerësim përvijon një numër gjetjesh solide lidhur me kontributin që kanë dhënë EVSB-të dhe ndikimin që ato kanë pasur në sigurinë e komuniteteve në Kosovë. Ai paraqet një përshtypje të përgjithshme të programit të EVSB-ve, ndikimet specifike të projektit që ka pasur përkitazi me sigurinë në komunikacion dhe mjedis dhe ndikimin më të gjerë të programit, përfshirë këtu marrëdhëniet ShPK-komunitet dhe marrëdhëniet ndër-etnike. Ky përqendrim, jo vetëm që pasqyron rregullsinë me të cilën EVSB-të janë ballafaquar me këto çështje, por ai gjithashtu pasqyron theksin që EVSB-të i kanë dhënë si brengave të “zakonshme” të sigurisë (ato të cilat i paraprijnë apo që janë në krye të jetës së përditshme) ashtu dhe çështjeve me objektiva më afatgjata dhe me rrënjë më të ndërlikuara. Vlerësimi gjithashtu ofron një analizë të pikave të forta të programit, sfidave me të cilat është ballafaquar dhe mësimet e mësuara (një numër i të cilave tashmë zbatohet në programin që vazhdon). Në fund, Vlerësimi ofron një numër rekomandimesh për zhvillimin e mëtejshëm të EVSB-ve dhe aktiviteteve të tyre. Këto do t’i dorëzohen dhe do të diskutohen me palët relevante të interesit, në veçanti EVSB-ve dhe partnerëve të tyre, bashkësive të tyre dhe akterëve ndërkombëtar kyç që veprojnë në Kosovë, në mënyrë që të rritet suksesi, të lehtësohet zhvillimi strategjik i EVSB-ve në të ardhmen dhe të sigurohet qëndrueshmëria kudo në Kosovë.



VIZITË E KOMUNITETIT NË NJË KAMP
PËR PERSONAT E ZHVENDOSUR BRENDA
VENDIT NË KLINË/KLINA.

2. NDËRTIMI I KAPACITETIT: NJË SHQYRTIMI I PROGRAMIT TË EVSB-ve

Programi i Ekipeve Vepruese për Siguri në Bashkësi filloi në vitin 2003 në katër pilot vende: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Vushtrri/Vučitrn, Novobërdë/Novo Brdo dhe Gjakovë/Đakovica. Suksesi në këto vende solli seri të krijimit të Ekipet e Kosovës për Siguri në Bashkësi EVSB-ve në Dragash/ Dragaš, Kaçanik/Kaçanik, Leposavić/ Leposaviq dhe Rahovec/Orahovac, në vitin 2004, Istog/Istok, Lipjan/Lipljan, Kamenicë/ Kamenica dhe Štrpce/Shtërpçë në pranverë të vitit 2005 dhe Klinë/Klina, Obiliq/Obilić, Prizren dhe Viti/Vitina në vjeshtë të vitit 2005. Gjatë vitit 2007, dy komuna tjera iu bashkëngjiten,⁴ ndërkaq gjatë pranverës së vitit 2008 u bë trajnimi edhe për të tjera.⁵ Programi i EVSB-ve përdorë filozofinë që “policia përbën njerëzit dhe njerëzit përbëjnë policinë”. Qëllimi i tij është të lehtësojë bashkëveprimin ndërmjet udhëheqësve të komunitetit, zyrtarëve komunal dhe ShPK-së në mënyrë që të krijojë marrëdhënie pune bashkëpunuese, që të mund të punojnë së bashku në identifikimin dhe adresimin e çështjeve të krimit, sigurisë dhe kualitetit të jetesës. Si rezultat, programi i përzgjedhjes dhe trajnimit për anëtarët e EVSB-ve bazohen

4 Ferizaj/Uroševac dhe Hani I Elezit/Đeneral Janković.

5 Gjilane/Gnjilane dhe Peja/Peć.

në parimet e përfshirjes dhe diversitetit, ndërkohë që kërkon t’i pajisë individët me aftësi që ju duhen për të ndërmarrë rolin e tyre në mënyrë efektive.

2.1 Krijimi dhe trajnimi i EVSB-ve

Krijimi dhe trajnimi i një EVSB-je përfshinë gjashtë faza. Çdo fazë synon t’i pajisë anëtarët e ekipit me mjetet e domosdoshme për të identifikuar dhe adresuar problemet në komunitetet e tyre, si dhe siguron bazën që ekipi të behët partner dhe palë e interesit i (vetë) qëndrueshëm në komunitetet e tyre përkatëse.

Faza 1: Përzgjedhja e komunitetit

Ekipi i programit përzgjedh një vend për EVSB-në e ardhshme. Vendi pjesëmarrës duhet t’i plotësojë kushtet vijuese:

- Komuna dhe policia lokale duhet të shfaqin përkushtim për bashkëpunim me njëra-tjetrën dhe me komunitetin e tyre, në mënyrë që të identifikojnë çështje të krimit, sigurisë dhe kualitetit të jetesës, si dhe të zhvillojnë dhe implementojnë plane veprimi të projekteve për t’i adresuar këto çështje;
- Njësitë lokale të policisë duhet të kenë përbërje të larmishme dhe duhet të demonstrojnë nivel të lartë të profesionalizmit; dhe
- Komuniteti, policia dhe komuna duhet të pajtohen të punojnë bashkërisht në mënyrë bashkëpunuese dhe demokratike për t’i përfshirë të gjitha komunitetet joshqiptare. Rekomandimet e organizatave tjera që



punojnë në implementimin e iniciativave për sigurinë në komunitete kanë qenë mjet i vlefshëm në përzgjedhjen e vendeve.

Faza 2: Vizita në komunitet

Pas përzgjedhjes së komunitetit, Ekupi i Programit të EVSB-ve takohet me udhëheqjen komunale dhe të ShPK-së në atë komunitet, në mënyrë që të ofrojë informacione lidhur me programin dhe të sigurojë përkrahjen dhe bashkëpunimin e tyre të plotë. Duke i takuar në të njëjtën kohë, Ekupi i Programit është në gjendje të sigurohet se të dy palët kanë vullnet për të punuar në bashkëpunim për programin dhe pranimi i zotimeve të para në këtë mënyrë është dëshmuar si vendimtar për suksesin e ekipeve dhe programit.

Faza 3: Komitetet për Rekrutimin e Pjesëmarrësve

Pas vizitës në komunitet, udhëheqja komunale dhe e ShPK-së identifikojnë një përfaqësues komunal, një përfaqësues të ShPK-së, një anëtar të komunitetit dhe një udhëheqës rinor nga komuniteti pjesëmarrës për të formuar Komitetin e Rekrutimit të Pjesëmarrësve. Nga këta katër individë, së paku një duhet të jetë e gjinisë femërore dhe një nga komuniteti joshqiptarë. Çdo përfaqësues është një udhëheqës i dëshmuar, i përkushtuar ndaj parimeve të programit. Më pas, Komiteti rekruton rreth 35 deri në 40 udhëheqës nga komuna, ShPK-ja dhe komunitetet të motivuara për punë si vullnetarë, për t'u bërë përfaqësues të EVSB-ve. Është siguruar që përfaqësuesit pasqyrojnë larminë e

pranishme në komunitetet e tyre, duke përfshirë atë të moshës, gjinisë, etnisë dhe profesionit.

Faza 4: Takimi me komunitete dhe orientimi

Anëtarët e Ekupit të Programit të EVSB-ve takohen me Komitetin për Rekrutimin e Pjesëmarrësve për të organizuar një takim të komunitetit dhe seancë orientuese.. Ky takim fillestar u siguron përfaqësuesve të EVSB-ve informacione lidhur me programin dhe rolin e tyre. Gjithashtu, kjo është një mundësi për Ekupin e Programit për të mësuar diçka rreth perceptimeve të anëtarëve të EVSB-ve për sigurinë, nivelin e komunikimit ndërmjet palëve të ndryshme të interesit dhe kuptimit sa i përket roleve dhe përgjegjësisë të ndryshme.

Pas kësaj, mbahet një takim i dytë për të vlerësuar brengat e komunitetit më të gjerë që kanë të bëjnë me krimin, sigurinë dhe kualitetin e jetesës. Një numër nga 50 deri në 200 anëtarë të interesuar apo brengosur të komunitetit, përfaqësues të qeverisjes lokale dhe policë nga grupe të ndryshme etnike ndajnë brengat e tyre përmes një diskutimi të lehtësuar. Këto brenga regjistrohen. Më pas, pjesëmarrësit votojnë mbi çështjet e rëndësishme më të madhe në komunitetin e tyre. Këto çështje sjellën në trajnimin mbi "Zgjidhjen e Problemeve", gjatë të cilit projektet zhvillohen nga anëtarët e EVSB-ve për të gjetur zgjidhje për problemet.

Takimi i tretë është mbajtur në fund të trajnimit, gjatë të cilit anëtarët e Ekipeve Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSB)



ANËTARËT E EVSB-SË SË PRIZRENIT DUKE MËSUAR
PËR VLERAT E PARTNERITETEVE TË SHUMËLLOJSHME
GJATË TRAJNIMIT PËR E PROBLEMIT

TAKIMI I KËSHILLIT EKZEKUTIV TË EVSB-VE
NË DRAGASH (DJATHI)
NJË SEANCË E KURSIT TË 'TRAJNIMIT TË
TRAJNERËVE' (MAJT)

ndanë projektet e tyre të cilat i kishin iniciuar dhe e kishin ofruar statusin e azhurnuar të çështjeve të cilat adresoheshin. Takimi me pjesëmarrës ishte një mundësi për të parashtruar pyetje, për të siguruar të dhënat e tyre për projekte si dhe për t'u paraqitur vullnetarë për ndihmë.

Faza 5: Trajnimi

Trajnimi i EVSB-së zgjatë shtatë ditë dhe përfshinë dy komponentë thelbësorë: i pari përqendrohet në 'Partneritetet e Komunitetit dhe Ndërtimi i Ekipeve' dhe përfshinë seanca, si për shembull, zhvillimi i partneritetit, ndërtimi i ekipeve, tejkalimi i dallimeve, ndërtimi i urave ndërmjet policisë dhe komunitetit, ndihma e grupeve, arritja e koncensusit dhe organizimi i takimeve të komunitetit. Nxënësit kanë mundësi të praktikojnë punën në ekipe, si dhe zhvillimin e vizionit dhe deklaratës së misionit për EVSB-të e tyre.

Komponenta e dytë përqendrohet në 'Zgjedhjen e problemit' dhe përfshinë seancat në modelin e zgjedhjes së problemit të llojit SARA, duke përmbledhur 'Skenografimin', 'Analizën' (e problemit dhe të partnerëve), 'Reagimin dhe 'Vlerësimin', po ashtu edhe planifikimin e projektit të veprimit. Kjo iu ofron pjesëmarrësve një mundësi për të hulumtuar mirë zgjedhjet e definuara të problemeve të identifikuar gjatë takimit të komunitetit siç është paraqitur në fazën e sipërpërmendur 4. Trajnimi përfshinë metodat ndërvepruese dhe pjesëmarrëse. Më tutje, kjo i jep pjesëmarrësve një mundësi për të

përvetësuar shkathtësi të vlefshme, duke punuar së bashku për të zhvilluar strategji dhe plane të veprimit për të adresuar çështjet e identifikuar gjatë takimeve të mëhershme të komunitetit.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit rrinë së bashku në kampin e Qendrës së Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QPSPEZH). Kjo ofron mundësi të vlefshme për ndërtimin e partneritetit për të vazhduar jashtë klasave të mësimi, si dhe për të siguruar që pjesëmarrësit janë plotësisht të përqendruar në trajnim. Programi i trajnimit është treguar të jetë i suksesshëm, me pjesëmarrje të plotë dhe partneritet të plotë dhe me ngritje të ekipeve. Administrimi i trajnimit nga trajnuesit e trajnuar vendor gjatë cikleve më të reja është treguar të jetë i dobishëm për nxënësit (shiko pjesën 2.3 më poshtë).

Faza 6: Stërvitjet dhe ndjekja e tyre

Gjatë ndjekjes së trajnimeve, pjesëmarrësit e EVSB-ve fillojnë të implementojnë planet e tyre të projektit të veprimit, dhe mbajnë takimin e tretë të komunitetit për të raportuar për të gjeturat dhe për progresin e komunitetit të tyre. Më pas, EVSB vazhdon të operojë dhe të përkrah punën e Komiteteve Lokale për Siguri Publike (KLSP) dhe Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKS) në përpjekjet e tyre për të adresuar çështjet e krimit, sigurisë dhe jetesës. Për të siguruar qëndrueshmëri, Ekipi i Programit të EVSB-së vazhdon të ofrojë përkrahje, duke siguruar inkurajim dhe stërvitje si në aspektet e përgjithshme të programit,



ashtu edhe në çështjet e posaçme të projektit. Me festimin e suksesit dhe ndihmës së EVSB-së për të përballuar sfidat, Ekipi i Programit mëton të sigurojë të mbajtjen e motivimit brenda EVSB-ve, si dhe ofrimin e mundësisë për të bërë rrjetin dhe idetë për aktivitetet e ardhshme.

2.2 Këshilli Ekzekutiv i EVSB-ve

Një përkrahje dhe koordinim shtesë për EVSB-të është ofruar nga Këshilli Ekzekutiv. Këshilli Ekzekutiv është paraparë të jetë si një forum në të cilin përfaqësuesit e EVSB-ve mund të shkëmbejnë informata, të shkëmbejnë përvoja të ekipeve të tyre përkatëse, dhe të punojnë së bashku për të identifikuar resurset në dispozicion nga komunat e tyre. Këshilli Ekzekutiv, i përbërë nga dy përfaqësues të secilit EVSB, takohet në çdo tre muaj në komunat e ndryshme 'nikoqire'. Edhe pse përfaqësuesit nga Ekipi i Programit të EVSB-së janë prezent, takimet udhëhiqen dhe protokollohen nga anëtarët e këshillit që ofrojnë mundësi të vlefshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të shkathtësive dhe të qëndrueshmërisë.

2.3 Trajnimi i trajnerëve

Nevoja e programit të EVSB për të qenë i qëndrueshëm është e lartë. Kështu, programi për trajnimin e trajnuesve, që mbahet që nga viti 2004, ka synim që ta plotësojë secilin EVSB me nga tre përfaqësues (një zyrtar i SHPK-së, një zyrtar komunal dhe një prijës të komunitetit) me shkathtësi trajnimi dhe moderimi.

Pjesëmarrësit në kurs paraqesin një spektër të gjerë të kualifikimeve, profesioneve dhe moshave dhe këta individë mund të aftësohen për dobi të EVSB-ve të tyre dhe për komunitetin më gjerë, duke ofruar resurse të vlefshme. Më tutje, përderisa kursi i trajnimit të trajnerëve ishte ofruar nga këshilltarët ndërkombëtarë, tani kjo bëhet nga ata vendor. Kjo iu ofron atyre mundësi që të bartin njohuri, shkathtësi dhe përvoja për pjesëmarrësit në programin e ardhshëm të EVSB-ve, dhe përderisa fitojnë përvoja shtesë të stërvitjes, ata sigurojnë që puna e bërë ekimore të jetë efikase..

Kursi i trajnimit të trajnerëve është treguar të jetë i suksesshëm, pjesëmarrësit kishin treguar nivel të mirë të përkushtimeve të tyre në kurs dhe për përgjegjësitë që ata i morën pas diplomimit. Ata vazhdojnë t'i trajnojnë pjesëmarrësit e ri të EVSB-ve dhe trajnuesit e trajnerëve, si dhe t'u ndihmojnë në programet për Komitetet Lokale për Siguri Publike dhe Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi.

Është e rëndësishme të theksohet që programi i EVSB-ve është proces rrjedhës: fazat dhe elementet e sipërpërmendura janë shfrytëzuar si kornizë që mund të adoptohet sipas nevojave dhe finesave të komunitetit në fjalë. Kështu, programi ka evoluar gjatë kohës dhe vazhdon të zhvillohet, duke nxjerr përvojat dhe të dhënat e pjesëmarrësve me qëllim që të përmirësohen vazhdimisht. Kështu, implementimi i mësimave të marra gjatë formimit të EVSB-ve të reja, besohet që ofrojnë bazën optimale të suksesit.

3.

PROJEKTI – NDIKIMI SPECIFIK

Hyrje

Që nga fillimi, EVSB-të janë përfshirë në qindra projekte anembanë Kosovës. Duke u përqendruar në çështjet e llojllojshmërisë, sjelljet negative nëpër shkolla, prostitucioni, edukimi shëndetësor dhe çështja e të pastrehëve, EVSB-të kanë identifikuar dhe adresuar shumë brenga të sigurisë dhe qetësisë në komunitetet ku ata punojnë. Gjatë kësaj kohe, EVSB-të kanë punuar ngushtë me disa partnerë të ndryshëm, përfshirë këtu edhe vetë komunitetet, SHPK-në autoritetet komunale, në mënyrë që të implementohet projektet që kanë për qëllim ndikimin pozitiv në nivelet e sigurisë dhe atyre jetësore që e gëzojnë banorët që i përkasin këtyre komuniteteve.

Edhe pse EVSB-të kanë punuar në çështje të ndryshme, dy fusha të cilat në veçanti kanë pasur vëmendjen gjatë programit janë komunikacioni dhe standardet e mjedisit. Dhe si e tillë, kjo pjesë e raportit përqendrohet në ndikimet që kanë dalë nga implementimi i projekteve që kanë pasur synim këto çështje.

3.1 Siguria në komunikacion

Njëra ndër temat më periodike gjatë kohëzgjatjes së programit të trajnimit është siguria në komunikacion. Disa EVSB, në partneritet me SHPK-në vendore dhe shpesh edhe me autoritetet komunale kanë identifikuar nevojat e komunitetit në lidhje

me çështjet e komunikacionit dhe kanë implementuar projektet e hartuara për t'i adresuar ato. Kështu, kjo mund të shikohet në atë mënyrë që edhe programet e EVSB kanë ndikim të dukshëm në nivelet e sigurisë së komunikacionit dhe ngritjen e vetëdijes në këto komuna. Gjatë procesit të planifikimit për këtë vlerësim, tetë nga 16 vendet e EVSB-ve⁶ zgjodhën ta vendosin fokusin e hulumtimit në këtë çështje. Edhe pse statistikat zyrtare sa i përket aksidenteve në komunikacion mund të jenë tregues të ndryshimeve në nivelin e sigurisë në komunikacion, perceptimet e banorëve dhe niveli i përfshirjes së publikut në projekte gjithashtu mund të dëshmojnë të jetë si mjet i dobishëm në matjen se në çfarë mase është ngritur vetëdija.

3.1.1 Brengat dhe çështjet kryesore të adresuara nga EVSB-të

EVSB-të janë përqendruar në dy çështje primare brenda lëmisë së sigurisë në komunikacion: rritja e nivelit të sinjalizimit në komunikacion dhe ngritja e vetëdijes së të rinjve. Duke punuar në instalimin e shenjave të komunikacionit dhe tabelave të emrave të rrugëve nëpër qytetet dhe fshatrat e Kosovës, EVSB-të kanë pasur mundësi të prodhojnë ndikim të qartë në sigurinë e komunikacionit edhe përtej atyre njerëzve të cilët drejtpërdrejt janë të përfshirë në të. Kjo çështje ishte prekur si shkak i një anëtarit të EVSB-së i cili deklaroi: “unë nuk kam qenë në implementimin e projekteve të komunikacionit, por unë e di që ato janë të mira. Kjo është e dukshme nëpër rrugët kryesore, dhe gati në të gjithë

6 Fushë Kosovë; Kaçanik; Kamenicë; Lipjan; Novobërdë; Obiliq; Prizren dhe Viti.



qytezën.⁷ Gjatë kohëzgjatjes së programit, për shembull EVSB-ja në Kaçanik, ka shënuar vendkalimet e këmbësorëve dhe kishte vënë shenjat e komunikacionit në qytezë, menjëherë i ka përmirësuar kushtet për këmbësorë dhe ka inkurajuar veprimet shtesë të komunës (autoritetet vazhduan t'i instalojnë shenjat shtesë të komunikacionit).⁸ Sipas një polici, kjo ka rezultuar me zvogëlimin e nevojës së patrullimit të policisë së komunikacionit: “ne jemi shumë të kënaqur... sepse para se të vendosim ne shenjat, ka qenë e domosdoshme ta kemi prezencën e lartë të policisë.”⁹ Kështu që, edhe pse ende kërkohen dhe ofrohen patrullat e policisë, prezenca e shenjave të komunikacionit e ka lehtësuar situatën ku është zvogëluar nevoja për patrullimet statike të policisë në qytezë.

Iniciativa të ngjashme janë implementuar në Kamenicë, në bashkëpunim me banorët, SHPK-në dhe me Kuvendin Komunal. EVSB-ja në Istog punoi së bashku me SHPK-në dhe Komunën për të ndërtuar një trotuar në fshatin Gjurakovc, diçka e ngjashme është ndërmarrë edhe nga EVSB-ja në Prizren. EVSB-ja e Prizrenit, me përfshirjen e komunës dhe SHPK-së, gjithashtu ka vënë një numër të shenjave të komunikacionit dhe semaforë përreth tre shkollave në komunë me qëllim të zvogëlimin të një numri të aksidenteve ku pësonin nxënësit e shkollës.¹⁰ Në qytetin e Prizrenit, aksionet për bartjen e automjeteve të parkuara në mënyrë të gabuar po bëhen

më të shpeshta,¹¹ diçka ndoshta që është e pazakonshme për Kosovën, ku automjetet shpesh shihen se janë të parkuara mbi trotuare. Ekziston një përshtypje që zvogëlimi i aksidenteve në komunikacionin rrugor në Prizren nuk është rezultat i vetëm rritjes së numrit të shenjave, tashmë investime të mëdha të komunës në çështjet e komunikacionit dhe në veçanti natyrës aktive të patrullave në komunikacion të SHPK-së¹² - të gjithë faktorët që janë kyç për sukses të qëndrueshëm në përmirësimin e niveleve të sigurisë së komunikacionit.

Disa EVSB gjithashtu kanë punuar me shkollat lokale dhe me policët e SHPK-së për t'i edukuar fëmijët dhe të rinjtë për sigurinë në komunikacion. Duke përfshirë mësimet, klasat dhe pjesët praktike siç janë garat me biçikleta, këto programe kanë joshur pjesëmarrje të gjerë dhe një nivel të mirë të suksesit, duke siguruar që ata që u përfshinë kanë një të kuptuar të shtuar për çështjet e sigurisë në komunikacion. Për arsye të fokusimit të madh në rini, këto projekte janë diskutuar më gjerësisht në pjesën 3.1.4.

3.1.2 Perceptimi i bashkësisë për sigurinë në komunikacion

Edhe pse ka njerëz që në mënyrë të konsiderueshme ose nuk e kanë ditur, ose kanë zgjedhur të mos përgjigjen në pyetje, pjesëmarrësit e EVSB-ve dhe përfituesit e intervistuar në përgjithësi ishin optimistë në lidhje me nivelet e sigurisë në komunikacion, si në tërë Kosovën, ashtu edhe në rrethin e tyre në veçanti. Më tepër se gjysma (52%) e

7 Një grua boshnjake e Kosovës, anëtare e EVSB-së, Obiliq, 15 maj 2007.

8 Anëtari i EVSB-së, Kaçanik, 20 maj 2008.

9 Një shqiptar i Kosovës, polic i SHPK-së/ anëtar i EVSB-së, Kaçanik, 8 maj 2007.

10 Një shqiptar i Kosovës, komandanti i Stacionit të SHPK-së, Prizren, 4 shtator 2007.

11 Zyrtari i COP/ Anëtar i EVSB-së, Prizren, 4 shtator 2007.

12 Një shqiptar i Kosovës, anëtar i EVSB-së në Prizren, 4 shtator 2007.

të anketuarve konsideruan që në 12 muajt e mëhershëm, para datës së intervistës, niveli i sigurisë në komunikacion ishte përmirësuar, dhe me 20% tjerë konsideronin që gjendja kishte mbetur e njëjtë. Vetëm një person (2% i anketës) kishte mendimin që siguria në komunikacion kishte rënë gjatë asaj kornize kohore. Individu banon në Obiliq, ku sipas statistikave zyrtare të SHPK-së, ka parë më shumë se 50% rritje të aksidenteve në komunikacion prej vitit 2006 deri 2007.¹³

Perceptimet optimiste të sigurisë në komunikacion në rrethinat lokale pasqyrohen edhe në nivelin e Kosovës në tërësi.

interesante që ka pasur rënie të lehte në tre komuna dhe rënia është raportuar përafërsisht me 50% në Prizren, faktikisht statistikave të SHPK-së tregojnë që në katër prej tetë komunave¹⁴ vërtetë ka pasur rritje të raportuara të aksidenteve në komunikacion. Kjo mospërputhje mund të jetë për faktin që njerëzit ishin të anketuar gjatë periudhës së mesit të vitit 2006, deri në mesin e vitit 2007, ndërsa statistikave i referohen viteve të plota 2006 dhe 2007. Kjo ka mundur të rezultojë edhe nga dallimi ndërmjet numrit të aksidenteve të raportuara në SHPK dhe numrit të përgjithshëm të aksidenteve të raportuara dhe atyre që nuk janë raportuar




Figura 1: Në përgjithësi, a mendoni që nivelet e sigurisë në komunikacion në Kosovë/rrethinën tuaj është ...? (Baza nr. = 64)


Ekziston një përshtypje e fortë që ka rënë numri i aksidenteve të komunikacionit. Shumica (76%) e të anketuarve deklaruan që incidentet e aksidenteve në komunikacion në rrethinën e tyre kanë rënë gjatë 12 muajve paraprak, dhe pjesa tjetër e mbetur e të anketuarve (24%) konsiderojnë që ka mbetur konstante. Megjithatë, është

fare. Andaj, anketa tregon për përshtypjen që ngritja e nivelit të sigurisë në komunikacion në ato komuna ku janë jetësuar projektet e EVSB-ve, me disa të anketuar që ua mveshin këtë punë së përbashkët të ekipeve dhe të SHPK-së. Për shembull, një drejtor i një shkolle drejtpërdrejt ua kishte lidhur rënien e aksidenteve në komunikacion, ku kishin pësuar nxënësit e tij gjatë rrugës për në shkollë, projektit të implementuar nga EVSB-të lokale që kishin siguruar transportin për fëmijë, në të cilën rrugë ata më parë kishin ecur.¹⁵

13 Ka pasur më se 82 aksidente të komunikacionit në Obiliq gjatë vitit 2006 dhe 124 në vitin 2007. Statistikave zyrtare të SHPK-së, të siguruar në muajin mars 2008.

14 Fushë Kosovë, Lipjan, Novobërdë dhe Obiliq.

15 Një shqiptar i Kosovës, Drejtor i shkollës (shkolla Shaban Shabani), Dragash, 14 qershor 2007



3.1.3 Përfshirja sociale në iniciativat për siguri në komunikacion

Shumë nga të anketuarit e këtij vlerësimi kishin marrë pjesë në projektin për siguri në komunikacion në ndonjë nga fazat e projektit gjatë dy viteve të mëparshme. Edhe pse 38% ende mbeteshin të marrin pjesë, 55% veç kishin marrë pjesë në ato projekte: 22% prej tyre kishin marrë pjesë në një projekt, dhe 8% i mbetur kishin marrë pjesë në dy projekte dhe 25% të të anketuarve kishin marrë pjesë së paku në tre iniciativa për siguri në komunikacion, siç janë puna në vënie e shenjave të komunikacionit, vendkalimit të këmbësorëve ose trotuareve.




Figura 2: sa herë gjatë dy viteve të fundit keni marrë pjesë në projektin për siguri në komunikacion në komunitetin tuaj? (Baza nr = 64)

Figura 3: deri në çfarë mase ju pajtoheni me deklarin "Unë jam i gatshëm të kontribuojë me kohë dhe me para për projektin e sigurisë në komunikacion në komunitetin tim"? (Baza nr = 41)

Tutje, shumica e të anketuarve ishin shprehur që në të ardhmen ata do të ishin gati për t'u përfshirë në projektet e sigurisë në komunikacion, me më se tre të katërtat që deklaruan që ata 'ishin pajtuar shumë' me parimin e përkushtimit të kohës së tyre për iniciativa të tilla.

Është interesante që 79% të atyre që kurrë nuk kanë marrë pjesë më parë në iniciativat për siguri në komunikacion kishin dëshirë të përfshiheshin në to në të ardhmen.

Asnjëri nga të anketuarit që kishin marrë pjesë në dy apo më tepër projektet e mëparshme nuk kishin deklaruar që nuk do të kishin dëshirë t'ua përkushtojnë kohën iniciativave të tilla. Niveli i duhur i përfshirjes së shoqërisë në iniciativat për sigurinë në trafik është inkurajues dhe kjo në fakt shënon atë që synon të zhvillonte EVSB-ja programi që nga fillimi. Akoma më inkurajues është fakti që një pjesë e të intervistuarve kanë treguar gatishmërinë që të kontribuojnë me paratë e tyre në projekt. Ndonëse thuhet shpesh që të ardhurat e



PËRFAQËSUES TË SHPK-SË DHE CSAT –IT DHE FËMIJËT GJATË AKTIVITETEVE TË FOKUSUARA MBI SIGURINË E KOMUNIKACIONIT RRUGOR NË GJAKOVË.

tyre në realitet janë tejet të vogla për të bërë një gjë të tillë: “sikur të kisha të holla unë do të isha tejet i lumtur që t’i jepja (për projektet në trafik) në komunitetin tim”.¹⁶

3.1.4 Përfshirja e të rinjve dhe ndikimi nga kjo përfshirje

Një prej projekteve më të rëndomta të ndërmarrë nga CSAT në fushën e sigurisë në komunikacion është implementimi i programeve vetëdijësuese për të rinjtë, që kanë për qëllim edukimin e fëmijëve, të rinjve dhe studentëve lidhur me rreziqet që paraqiten në komunikacionin rrugor. Gjatë këtyre ligjëratave, orëve mësimore dhe ngjarjeve praktike (siç janë ‘garat me motoçikletë’) zyrtarët e SHPK-së dhe anëtarët e CSAT synuan të arsimojnë studentët në lëmi të ndryshme të sigurisë rrugore.

Në Lipjan p. sh. EVSB-ja në partneritet me SHPK-në ka ofruar ligjërata të vazhdueshme mbi komunikacionin nëpër shkolla. Deri më sot, më se 2,500 kanë marrë pjesë në këto klasa.¹⁷ Një arsimtar i anketuar informatën e plasuar gjatë këtyre klasave e kishte konsideruar si arsye për rënie të aksidenteve të komunikacionit ku kishin pësuar fëmijët, edhe përkundër lokacionit të shkollës në këtë rrugë të ngarkuar.¹⁸ Më tutje, vlera e këtyre mësimëve ishte prezantuar nga një nxënës i cili kishte marrë pjesë si: “Të gjithë pjesëmarrësit të cilët ndonjëherë kishin marrë

pjesë në ndonjë ligjëratë për komunikacion... janë më të përgatitur dhe më të kujdesshëm gjatë kalimit të rrugës”.¹⁹

Programe të ngjashme janë ndërmarrë në Prizren, Obiliq, Dragash dhe në Kaçanik. Së voni, SHPK-ja dhe EVSB-ja kishin mbajtur ligjërata mujore për fëmijët në rrethinën e komunës, ku deri më sot përafërsisht kishin përfituar më se 1700 nxënës nga ky program.²⁰ Në një shkollë të vetme në Kaçanik, ka pasur tre ligjërata të ndryshme për siguri në komunikacion që ishin mbajtur nga SHPK-ja dhe EVSB-ja, ku kishin marrë pjesë gati 270.²¹ Ligjëratat u konsideruan të jenë të një vlere të veçantë për fëmijët, një nxënës deklaroi: “Ne me të vërtetë kemi nevojë për informata të tilla, për shkak se kemi pasur aksidente nëpër rrugët tona... respektimi i shenjave dhe rregullave të komunikacionit do të thotë më pak aksidente”.²²

Programi në Viti përfshinë partneritet edhe më të gjerë, me komunitetin, këshilltarët e fshatit, KFOR-in amerikan dhe me komunën, të gjithë këta bashkëpunojnë në këtë iniciativë. Këto partneritete janë plotësuar me ndihmën e cila ishte ofruar nga tre departamente të ndryshme komunale²³ për rindërtimin e trotuareve dhe vënien e shenjave të komunikacionit. SHPK-ja gjithashtu ka vënë pikat e kontrollit në vendet

16 Një i ri shqiptar i Kosovës, anëtar i EVSB, Kaçanik, 08 Maj 2007.

17 Një shqiptar i Kosovës, polic i SHPK-së/ anëtar i EVSB-së, Lipjan, 20 maj 2008.

18 Një shqiptar i Kosovës, arsimtar i shkollës fillore (Vëllezërit Frashri), Lipjan, 3 maj 2007.

19 Një shqiptar e Kosovës, nxënës e shkollës fillore, Lipjan, 3 maj 2007.

20 Polic i SHPK-së/anëtar i EVSB-së, Kaçanik, 20 maj 2008.

21 Një shqiptar i Kosovës, Kaçanik, 08 maj 2007.

22 Një shqiptar e Kosovës, nxënës e shkollës fillore (Ali Asllani, Doganaj), Kaçanik, 08 maj 2007.

23 Departamenti i Arsimi, Departamenti i Shërbimeve Publike dhe Departamenti për Rindërtim dhe Zhvillim.



ku shfrytëzohen shumë nga nxënësit në rrugëtimin e tyre për në shkollë në mënyrë që të sigurojnë që vozitësit e respektojnë kufizimin e shpejtësisë dhe vozisin me përgjegjësi.

Shumë drejtorë të shkollave i kanë konsideruar këto programe edukative të një efikasiteti të posaçëm, duke deklaruar që ndikimi që ato kanë pasur te nxënësit dhe në sigurinë e tyre ka qenë i dukshëm: procesi i “interesit të gjithë shoqërisë”.²⁴ Tutje, ndikimi i këtyre projekteve në mënyrë të qartë është dëshmuar me ngritjen e vëmendjes për sigurinë në komunikacion që edhe vetë nxënësit e kanë deklaruar; nxënësit vazhdimisht kanë deklaruar që si rezultat i mësimave të SHPK-së dhe EVSB-së për sigurinë në komunikacion në shkollë, ata janë më të kujdesshëm dhe si rezultat i kësaj ndihen më të sigurt.²⁵ Ky element i programit të EVSB në mënyrë të qartë tregon që, kur të punohet në partneritet me SHPK-në dhe me palët tjera të interesuara, ka mundësi që të ndikojë pozitivisht në të gjitha shkallët e vetëdijes dhe sigurisë- ky është një rezultat i qëndrueshëm.

3.1.5 Kontributi i partnerëve të EVSB-ve

SHPK-ja, si në pjesëmarrjen në implementimin e projekteve të sigurisë në komunikacion në bashkëpunim me EVSB-të (siç u diskutua më lartë), ashtu edhe në zbatimin e ligjit ka një rol të madh për ta luajtur në lëmin e sigurisë në komunikacion

dhe kontributi i tyre është lëmi e fokusimit gjatë hulumtimit të këtij vlerësimi. Që nga maji i vitit 2008, më se 522 policë të komunikacioni janë dedikuar për patrullime në tërë Kosovën, që përbën përafërsisht 7% të gjithë SHPK-së.²⁶ Në tetë komuna që kanë konsideruar që ka përmirësime në sigurinë në komunikacion thonë që programet e EVSB-ve kanë ndikuar, popullata në përgjithësi ishte e kënaqur me punën që e bën SHPK-ja në zbatimin e ligjit të komunikacionit. Faktikisht, 30% të të anketuarve ‘janë pajtuar fuqimisht’ që niveli i zbatimit të ligjit të komunikacionit nga ana e SHPK-së i ka përmbushur nevojat e komunitetit të tyre, dhe më se 31% ‘janë pajtuar disi’. Vetëm 1% nuk janë pajtuar që SHPK-ja ka kryer punë të kënaqshme në lidhje me këtë.²⁷ Andaj, disa kanë shprehur dëshirën që të shohin qasje më bazike në sigurinë në komunikacion nga ana e SHPK-së. Për shembull, në vend që t’i vendosin automjetet e tyre patrulluese përgjatë rrugës për t’i ndalur ngasësit e shpejtë, policët e SHPK-së duhet t’i përkushtojnë më shumë kohë takimit me banorë dhe t’i edukojnë ata për sigurinë në komunikacion në mënyrë që të ndryshohen qëndrimet dhe të rrisin sigurinë në mënyrë më të qëndrueshme.²⁸

Tutje, shumica e të anketuarve konsideruan që SHPK-ja, ose është duke bërë në punë ‘të mrekullueshme’ ose ‘të mirë’ në shkëmbimin e informatave për sigurinë në komunikacion në përgjithësi me banorët e Kosovës dhe në veçanti me komunitetin e tyre.

24 Një shqiptar i Kosovës, Drejtori i shkollës fillore në Arbana, Prizren, 04 shtator 2007.

25 Një djalosh shqiptar i Kosovës, nxënës i shkollës fillore (Selman Riza), Fushë Kosovë, 17 maj 2007.

26 Selia Kryesore e SHPK-së për komunikacion 16 maj 2008.

27 Duhet të dihet që një proporcion i dukshëm i të të anketuarve nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.

28 Një anëtar i mëhershëm i programit të EVSB-së, Vushtrri, 28 maj 2008.




Figura 4: 'Çka mendoni, a është SHPK-ja duke ofruar informata të mjaftueshme për sigurinë në komunikacion për qytetarët e Kosovës?' (Baza nr= 64)

Sidoqoftë, gjatë mëtimit të ngritjes së vetëdijes për çështjet e komunikacionit, ka pasur disa sfida në komunikim. Kjo në veçanti ka ndodhur me rastin në Kaçanik, ku mungesa e rrjetit televiziv është konsideruar të jetë pengesë për shkëmbimin efikas të informatave;²⁹ për shembull, do të ishte më efikas një sistem i ngritjes së vetëdijes nëpërmjet posterëve.³⁰ Gjatë vitit 2008, SHPK-ja është duke ndërmarrë një fushatë gjithëpërfshirëse të informatave për sigurinë në komunikacion në partneritet me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit dhe me Misionin e OSBE-së në Kosovë. Andaj, shpresohet që kjo do t'i lehtësojë disa pengesa.

29 Kryetari i Kuvendit Komunal, Kaçanik/Kaçanik, 08 maj 2007.

30 Një shqiptar i Kosovës, Kryetari i Kuvendit Komunal, Viti, 10 maj 2007. veç kësaj, është raportuar që në tërë Kosovën ka qasje të dobët në rrjetet televizive.

3.1.6 Partneritetet dhe zgjidhja e problemeve

EVSB-të shpesh operojnë si zgjedhës pro aktiv të problemeve në qasjen e tyre në sigurinë në komunikacion: e po ashtu në partneritet me Kuvendet Komunale, SHPK-në dhe shkollat lokale, në disa raste ata kanë udhëhequr projekte të ndryshme. Për shembull, është parë që EVSB-të kanë iniciuar projekte me fokusim në vënien e shenjave të komunikacionit, ky proces kërkon bashkëpunim të gjerë ndërmjet palëve të ndryshme të interesuara. Kjo siguron që janë krijuar partneritete të forta dhe të qëndrueshme. Për shembull, një bashkëpunim i lartë i kësaj natyre në Kaçanik, ishte shprehur edhe nga Kryetari i Kuvendit Komunal, i cili theksoi që "EVSB-të dinë si t'i identifikojnë problemet siç janë mungesa e shenjave të komunikacionit. Më pas ata kanë diskutuar me [autoritetet komunale] dhe me banorët se si t'i zgjedhin këto probleme dhe së bashku ta implementojmë e projektin".³¹ Nëpërmjet programeve të EVSB-ve është

31 Kryetari i Kuvendit Komunal, Kaçanik, 08 maj 2007.

inkurajuar edhe bashkëpunimi me KFOR-in, posaçërisht në Kaçanik, ku forcat paqeruajtëse shpesh kanë qenë të përfshira në projekte për sigurinë në komunikacion, si vëzhgues, ashtu edhe kanë ndihmuar në implementim. Si rezultat i kësaj, nga komuna konsiderohet që ky bashkëpunim ndërmjet KFOR-it dhe EVSB-së dhe SHPK-së të jetë i nivelit të kënaqshëm.³²

Në mënyrë më të përgjithshme, bashkëpunimi u zhvillua gjatë projekteve të ndryshme për sigurinë në trafik, gjë që është theksuar nga një numër i të intervistuarve, veçanërisht lidhur me përfshirjen e EVSB-ve. Të intervistuarit në Lipjan u fokusuan më shumë në rolin që e gëzon EVSB-ja si pikë primare e kontaktit për çfarëdo problemi me të cilin përballlet komuniteti. Kjo është vënë në dukje si rezultat i marrëdhënieve të shkëlqyeshme të punës të zhvilluara që nga fillimi, në vitin 2005 dhe niveli i bashkëpunimit ndërmjet komunitetit, SHPK-së dhe EVSB-së.³³ Një bashkëpunim më i shtuar është parë edhe në Istog gjithashtu: EVSB-ja ka inicuar programin ku SHPK-ja në mesditë patrullon rrugët përreth shkollës lokale për t'i parandaluar aksidentet potenciale, që mund të shkaktohen nga grumbullimi i automjeteve jashtë në daljen nga shkolla.³⁴ Përfshirja e lartë e zyrtarëve të SHPK-së në EVSB është gjithashtu një mekanizëm pozitiv për bashkëpunim; në pjesën dërmuese të EVSB-ve ka prani të zyrtarëve të SHPK-së dhe kjo gjë reflektohet

32 Një oficer i KFOR-it amerikan, Kaçanik, 08 maj 2007.

33 Mashkull shqiptar i Kosovës, mësimdhënës në shkollën fillore (Shkolla 'Vëllezërit Frashëri'), Lipjan, 3 maj, 2007.

34 Mashkull shqiptar i Kosovës, anëtar i EVSB-së, Istog, 20 shtator, 2007.

në punën që ata e ndërmarrin dhe në nivelin e informatave që përcillet tek komunitetet.

Megjithatë, disa njerëz të intervistuar kanë vënë në dukje që dështimet e rastësishme të bashkëpunimit dhe partneritetit kanë pasur ndikime negative në realizueshmërinë e projekteve të këtitilla. Për shembull, mbështetja e kufizuar nga udhëheqësia komunale është cituar si faktor, i cili e kufizon nivelin e suksesit që mund të arrihet nga ana e EVSB-ve në fushën e sigurisë në trafik.³⁵ Një shembull i qartë i këtitillë është dështimi i projekteve të inicuar nga EVSB-të e Lipjanit dhe Fushë Kosovës për krijimin e vendkalimeve për kalimtarë dhe vendosjen e shenjave rrugore për shkak të pamundësisë së Kuvendeve Komunale për të ofruar mbështetjen e duhur financiare.³⁶ Shembujt si këto shërbejnë vetëm për të theksuar se nevojitet një përkushtim i plotë i të gjitha palëve për punën e ndërmarrë nga komunitetet përmes EVSB-ve. Megjithatë, përforcimi i përgjithshëm i bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve është diçka për t'u duartrokatur dhe është një tregues pozitiv për ndikimet me shtrirje të gjerë të programit.

3.2 Kushtet mjedisore dhe siguria

Standardet e shëndetit mjedisor dhe sigurisë si dhe çështjet e lidhura me nxehjen globale janë në krye të vetëdijes ndërkombëtare.

35 Mashkull shqiptar i Kosovës, anëtar i EVSB-së, Prizren, 04 shtator, 2007; Zëvendës kryetar i Kuvendit Komunal, Dragash, 14 qershor, 2007.

36 Zyrtar i SHPK-së/ anëtar i EVSB-së, Lipjan, 20 maj, 2008; Zyrtar i SHPK-së/ anëtar i EVSB-së, Fushë Kosovë, 20 maj, 2008.



ANËTARËT E EVSB-SË SË
LEPOSAVIQIT, DUKE PUNUAR NË
PASTRIMIN E PJESËVE TË MBETURA.

Kosova nuk përjashtohet nga kjo: problemet e ndotjes industriale janë të dukshme dhe të dokumentuara mirë.³⁷ Krijimi i një mjedisi më të shëndetshëm për banorët e Kosovës, si rrjedhim ka qenë motivimi i disa projekteve të EVSB-ve, ku EVSB-të kanë punuar në bashkëpunim me një sërë akterësh tjerë, në mënyrë që të arrihen synime të ndryshme, duke përfshirë këtu lagje më të pastra dhe çështjen lidhur me reduktimin e numrit të qenve endacak, hapësira më të këndshme për rekreacion dhe ngritje të vetëdijes së publikut të gjerë. Si rrjedhim i ndikimit që e kanë patur EVSB-të në kushtet e mjedisit ka qenë fokusimi kryesor i vlerësimit në dhjetë komuna.³⁸ Ndonëse, është vështirë që të maten në mënyrë të sigurt ndryshimet në standardet e mjedisit, niveli i përfshirjes së shoqërisë dhe numri i projekteve të ndërmarrja tregon trendin ndaj ngritjes së vetëdijes për mjedisin, parakusht ky për një përmirësim afatgjatë.

3.2.1 Shqetësimet kyçe dhe çështjet e adresuara nga EVSB-të

EVSB-të kanë implementuar një sërë nismash me synim të përmirësimit të kushteve mjedisore. Megjithatë, njëra prej aktiviteteve

më të rëndomta të inicuar nga EVSB-të që nga zanafilla e tyre është pastrimi i lagjeve dhe ngritja e vetëdijes së përbashkët. Për shembull, projektet për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e standardeve të mjedisit në Istog vazhdojnë ende me vite të tëra tani dhe shpeshherë si pjesë e 'Muajit të mjedisit'.³⁹ Projektet e rregullta për pastrim, ndonëse të financuara nga komuna, implementohen në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, SHPK-në, Departamentin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kompanitë lokale për pastrim dhe banorët e disa fshatrave.⁴⁰ Këto projekte kanë përfshirë gjithashtu bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme të shqiptarëve, serbëve dhe ashkalive të Kosovës.⁴¹ Projekte të ngjashme janë implementuar në Kamenicë, ku EVSB-ja ka ndërmarrë 'pastrimin vjetor të mjedisit' më 22 prill, 'Dita e tokës', që nga viti 2004. Këto të gjitha janë ndërmarr në partneritet me komunitetet lokale, SHPK-në, Kuvendin Komunal, KFOR-in, TMK-në, shkollat lokale dhe Kryqin e Kuq. Çdo vit, EVSB-të reklamojnë aktivitetin e tyre përmes mediave lokale, duke siguruar pjesëmarrjen e rreth 4500 dhe 5000 njerëzve në projekt.⁴²

Operacionet gjithëpërfshirëse për pastrim janë ndërmarrë gjithashtu nga EVSB-ja e Shtërpcës, në partneritet me banorët lokal të komunës,⁴³ EVSB-të në Kaçanik dhe Obiliq dhe nga EVSB-ja në Prizren, e cila ka punuar me shkollat lokale, Kuvendin Komunal dhe

37 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Kosovë, Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis 2006 – 2010 (2006). Mund të gjendet në: http://www.ks-gov.net/mmph/document/english/Kosovo_Environmental_Action_Plan.pdf; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Kosovë, Raporti i Gjendjes së Mjedisit në Kosovë (2003) Mund të gjendet në: http://enrin.grida.no/htmls/kosovo/Kosovo_SOE_part1.pdf dhe Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore, Analizat strategjike mjedisore të Kosovës (2000). Mund të gjendet në: <http://www.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF>

38 Dragash; Fushë Kosovë; Istog; Kamenicë; Klinë; Leposaviq; Obiliq; Prizren; Rahovec dhe Shtërpcë.

39 Mashkull shqiptar i Kosovës, Drejtor i Shkollës së Mesme 'Haxhi Zeka', Istog, 20 shtator, 2007.

40 Përfaqësues komunal, Istog, 20 shtator, 2007.

41 Mashkull shqiptar i Kosovës, Istog, 20 September 2007.

42 Mashkull shqiptar i Kosovës, Zyrtar i SHPK-së/anëtar i EVSB-së, Kamenicë, 5 qershor, 2007.

43 Mashkull serb i Kosovës, anëtar i EVSB-së, Shtërpcë, 12 qershor, 2007.



SHPK-në për ta pastruar oborrin e shkollës dhe kopshtet e qytetit.⁴⁴ EVSB-ja në Leposaviq ka qenë veçanërisht aktive në projektet për pastrimin e mjedisit. Që nga krijimi i saj në vitin 2004, EVSB-ja ka ndërmarrë disa projekte të ndryshme për pastrimin e urës dhe një numër iniciativash për rregullimin e bregut të lumit, parqeve publike, shtigjeve malore dhe linjave të rrymës. EVSB-ja ka punuar në pastrimin e rrugës që bashkon fshatin me kishën në afërsi. Veç kësaj, në bashkëpunim me OJQ lokale dhe vullnetarë nga komuniteti ka bërë shënjimin e përafërsisht 100km të shtigjeve malore dhe ua ka dhënë këtë detyrë një numri të anëtarëve për të siguruar, që lokacionet e ndryshme për piknik të mbeten të pastra dhe t'i inkurajojnë banorët që t'i mbledhin mbeturinat e tyre.⁴⁵ Ndikimet e shumta të këtij projekti janë vënë në dukje nga një anëtar i EVSB-së, i cili thotë, “ngjitja lartë... krijon kushte më të mira të jetesës. Shumë njerëz kanë vendosur t'i shfrytëzojnë këto [shtigje] pasi që kanë dëgjuar për projektin tonë. E kemi ngritur vetëdijen e njerëzve për mbajtjen e pastër të mjedisit”.⁴⁶

Në projektet tjera me ndikim të dukshëm në mjedis përfshihet edhe njëri në Fushë Kosovë, projekt ky, i cili kishte për qëllim përmirësimin e lagjes të banuar nga komuniteti ashkali. Kjo është ndërmarrë nga EVSB-ja, anëtarët e komunitetit ashkali, rinia lokale, Kuvendi Komunal dhe një OJQ

ndërkombëtare.⁴⁷ E njëjta OJQ, ‘Shëndeti për të gjithë’, ka mbjell nga një dru për çdo shtëpi në atë lagje.⁴⁸ EVSB-ja në Dragash është treguar të ketë qenë veçanërisht aktive në çështjet e mjedisit, si dhe ka iniciuar një numër ligjëratash rreth hedhjes së mbeturinave dhe pastërtisë së mjedisit në bashkëpunim me shkollat dhe ka ndërmarrë disa operacione ‘pastrimi’ në tërë komunën,⁴⁹ EVSB-ja ka punuar në partneritet me organizatën ‘Era e ndryshimeve’ për shtypjen dhe shpërndarjen e broshurës, duke përvijuar rëndësinë dhe hapat kyçe drejt përkujdesjes ndaj mjedisit.⁵⁰

Çështja e hedhjes jo të duhur të mbeturinave të amvisërive e shton rrezikun e shoqëruar nga qentë endacak në Kosovë. Si rezultat, EVSB-të kanë ndërmarrë operacione për pastrimin e mjedisit të diskutuara lartë, në kombinim me veprime më të koordinuara, në mënyrë që të kenë ndikim pozitiv mbi këtë çështje. Ndonëse, në të kaluarën, njerëzit i kanë vrarë qentë endacak, si përpjekje për t'i kontrolluar ata, një dukuri e tillë tanimë është reduktuar në masë. Kjo dukuri, në masë të madhe është rezultat i perceptimit jo të drejtë, të shprehur nga një numër i të intervistuarve, që gjuajtja e qenve endacak ndalohet, veçanërisht me ligj. Ndonëse, teknikisht nuk është ky rasti, legjislacioni kufizues sa i përket posedimit të armëve dhe

44 Mashkull shqiptar i Kosovës, Zyrtar i ShPK-së, Prizren, 4 shtator, 2007

45 Mashkull serb i Kosovës, anëtar i EVSB-së, Leposaviq, 29 maj, 2007.

46 Mashkull serb i Kosovës, anëtar i EVSB-së, Leposaviq, 24 maj, 2007.

47 Mashkull shqiptar i Kosovës, Përfaqësues i Kuvendit Komunal, Fushë Kosovë, 17 maj, 2007.

48 Mashkull ashkali, nxënës i shkollës fillore, Fushë Kosovë, 18 maj, 2007. Nismat për mbjelljen e drunjëve gjithashtu kanë zënë vend në Novobërdë, Dragash dhe Obiliq.

49 Mashkull shqiptar i Kosovës, anëtar i EVSB-së, Dragash, 14 qershor, 2007.

50 Mashkull shqiptar i Kosovës, anëtar i EVSB-së, Dragash, 14 qershor, 2007.

përdorimit të tyre⁵¹ nënkupton që, në kushte praktike është e paligjshme të shtihet në qentë endacak. Megjithatë, ekzistojnë dispozita legjislative, të cilat e përcaktojnë në mënyrë specifike kontrollin e kafshëve endacake: Ligji për gjuetinë⁵² thotë që “Ministria [e bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural], me akt nënligjor mund t’i autorizoj menaxhuesit e vendgjuetive të kontrollojnë qentë dhe macet endacake në vendgjueti”,⁵³ dhe duke u mbështetur në nenin 13 të Ligjit për veterinarinë,⁵⁴ “në pajtim me procedurat e përcaktuara nga ministri [përgjegjës për shërbimet veterinare], Autoritetet komunale ndërmarrin: ... c. kapjen e qenve dhe maceve të rrugës dhe nëse është e nevojshme, eutanazinë e tyre”.

Megjithatë, EVSB-të dhe partnerët e tyre kanë qenë në gjendje ta implementojnë një numër të projekteve që kanë pasur për qëllim adresimin e çështjes së qenve endacak me rezultate të dukshme. Për shembull, në Leposaviq, 119 qen endacak janë asgjësuar me një iniciativë të këtillë, që ka qar në zvogëlimin e numrit të sulmeve ndaj banorëve.⁵⁵ Në Istog⁵⁶ dhe Prizren janë eliminuar përafërsisht 700 dhe 900 qen endacak, respektivisht⁵⁷ në të dy

51 Shih Rregulloren nr. 2001/7 ‘Për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë’. Mund të gjendet në: http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2001regs/RE2001_07.htm

52 Ligji nr. 02/L-53. Mund të gjendet në: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2005_02-L53_en.pdf

53 Neni 56.4.

54 Ligji nr. 2004/21. Mund të gjendet në: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_21_en.pdf

55 Mashkull serb i Kosovës, anëtar i EVSB-së, Leposaviq, 24 maj, 2007.

56 Mashkull shqiptar i Kosovës, Istog, 20 shtator, 2007.

57 Sekretari i Shoqatës së Gjuetarëve ‘Sharri’, Prizren, 4

vendet ka pasur bashkëpunim të ngushtë dhe mbështetje nga Kuvendi Komunal, SHPK-ja dhe Shoqata lokale e gjuetarëve. Është krijuar një partneritet i shumanshëm në Kamenicë, ku EVSB-të kanë punuar me SHPK-në, Kuvendin Komunal, KFOR-in dhe Shoqatën Lokale për Gjueti për mënjanimin e një numri të madh të qenve endacak.⁵⁸ Projektet e ndërmarra nga EVSB-ja në Obiliq, të financuara nga Kuvendi Komunal dhe implementuar në partneritet me KFOR-in, SHPK-në dhe Shoqatën Lokale për Gjueti janë treguar të suksesshëm dhe kanë kontribuar në zvogëlimin e sulmeve të qenve ndaj njerëzve në komunë,⁵⁹ siç janë marrë edhe masa të ngjashme në Rahovec dhe Shtërpçë.

Përkundër këtyre arritjeve pozitive, është vështirë të vërtetohet nëse ka pasur ndonjë përmirësim në çështjen e qenve endacak. Megjithatë, duket të dominoj një perceptim në mesin e pjesëmarrësve vlerësues dhe publikut të gjerë, që përkundër disa përmirësimeve të lokalizuara, problemi mbetet ende urgjent. Në të vërtetë, madje edhe në këto komuna ku autoritetet dhe/ose EVSB-të kanë ndërmarrë veprim për të iu drejtuar kësaj çështjeje, ekziston perceptimi që ende ka mbetur një numër i konsiderueshëm i qenve endacak. Kjo është gjendja, sidomos në zonat rurale dhe malore, siç është Dragashi, ku vazhdojnë të ndodhin sulme të tilla.⁶⁰ Mungesa e disponueshmërisë së barnave adekuata kundër rasteve të tërbimit dhe pamundësia

shtator, 2007.


58 Mashkull serb i Kosovës, Zyrtar i SHPK-së, Kamenicë, 5 qershor, 2007.

59 Mashkull shqiptar i Kosovës, Kryetar i Kuvendit të Komunës, Obiliq, 15 maj.

60 Mashkull shqiptar i Kosovës, anëtar i EVSB-së, Dragash, 14 qershor, 2007.

për t'i blerë ato është theksuar si një prej çështjeve më shqetësuese.⁶¹ Më tutje, janë ngritur gjithashtu edhe çështjet e ndryshme financiare. Siç është diskutuar nga zëvendës kryetari i Kuvendit Komunal të Dragashit, në shpenzimet e paraqitura përfshihet rritja kur qenve endacak duhet t'u bëhet eutanazi me injektim vdekjeprurës, gjë që e ka ndaluar implementimin praktik të projekteve, që

(shih më poshtë). Pjesa tjetër e tyre, 11% mendojnë që këto standarde kanë mbetur të pandryshueshme. Rezultatet kanë qenë kryesisht në përputhje me perceptimet për mjedisin në nivel më të lokalizuar: 40% mendojnë që cilësia e mjedisit lokal është përmirësuar në afatin e njëjtë kohor, me pjesën tjetër prej 23%, duke pohuar që kjo ka mbetur e njëjtë.



kishin për qëllim reduktimin e rreziqeve të shkaktuara nga qentë endacak.⁶² Mbështetja nga autoritetet komunale është e një rëndësie të veçantë për EVSB-të dhe partnerët e tyre që të lejohen ligjërisht dhe të pajisen praktikisht për të realizuar projekte për menjanimin e qenve endacak.

3.2.2 Perceptimet e bashkësisë kushtet mjedisore

Ndonëse, tani nuk është e mundur që të vërtetohen perceptimet e tyre, është inkurajuese të shihet që 37% e të intervistuarve konsiderojnë që kushtet mjedisore në Kosovë janë përmirësuar gjatë 12 muajve para fillimit të hulumtimit

Figura 5: Marrë në përgjithësi, çfarë është mendimi juaj se sa ka ndryshuar mjedisi në Kosovë/lagjja juaj gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit në Kosovë? (nr. bazë = 35)

Megjithëse, pjesa dërmuese e pjesëtarëve pakicë (20%: 'lagjja', 23%: 'Kosova') të intervistuar kanë pohuar që mendojnë se cilësia e mjedisit është shkatërruar gjatë 12 muajve të kaluar. Disa prej të intervistuarve theksuan që mungesa e vetëdijesimit të publikut për çështjet mjedisore ka kontribuar në perceptimin jo të duhur të standardeve mjedisore, ku njëri prej të intervistuarve pohon: 'është shumë dëshpëruese që asnjëri nuk kujdeset për ruajtjen e bukurisë së Kosovës ..[Njerëzit] nuk mendojnë për ardhmërinë e fëmijëve të tyre'.⁶³

61 Mashkull shqiptar i Kosovës, anëtar i EVSB-së, Dragash, 14 qershor, 2007.

62 Mashkull shqiptar i Kosovës, Zëvendës kryetar i Kuvendit të Komunës, Dragash, 14 qershor, 2007.

63 Femër serbe e Kosovës, Leposaviq, 29 maj, 2007.

Të intervistuarit në përgjithësi kishin mendim pozitiv për progresin e bërë në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve. Dyzet e pesë përqind (45%) mendojnë që mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve ka shënuar përmirësim gjatë 12 muajve të kaluar, ku 17% e të tjerëve konsiderojnë që gjendja ka mbetur e njëjtë. Megjithatë, i tërë 16% i respondentëve kanë pohuar që çështja në fjalë është përkeqësuar me kalimin e kohës.




Figura 6: Në përgjithësi, çfarë mendoni për çështjen e mosmirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve në lagjen tuaj gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit? A ka ...? (nr. bazë = 64)

Siç u diskutua më lartë, EVSB-të në bashkëpunim me vetë banorët dhe një numër të akterëve kanë ndërmarrë një numër të konsiderueshëm të projekteve për pastrim në vitet e kaluara ku shënjestrim ish-in si zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Është mjaft e mundur që këto veprime të kenë kontribuar në perceptimin e përmirësimit të kushteve mjedisore në komunitetet ku veprojnë EVSB-të.

3.2.3 Përfshirja e shoqërisë në nismat mjedisore

Sa i përket projekteve për sigurinë në trafik,⁶⁴ banorët e komuniteteve ku veprojnë EVSB-të kanë treguar gatishmërinë e tyre për përfshirje në projektet mjedisore. Në të vërtetë, 68% i këtyre të intervistuarve kishin marrë pjesë në projekte për pastrim në dy vitet e kaluara, ku shumica prej tyre kishin marrë pjesë disa herë në projektet e këtilla.




Figura 7: Sa herë keni marrë pjesë në ndonjë projekt zhvillimor siç është pastrimi në komunitet gjatë dy viteve të fundit? (nr. bazë = 35)

Ndikimi pozitiv i përfshirjes së shoqërisë në projektet e tilla është theksuar nga një numër i të intervistuarve. Një individ pohoi se jo që vetëm fëmijët tani luajnë në lum çdo ditë gjatë verës, por nga kjo gjë kanë përfituar edhe ata, të cilët dëshirojnë të peshkojnë, meqenëse janë përmirësuar kushtet dhe cilësia e ujit.⁶⁵ Pjesa dërmuese

64 Shih lartë seksionin 3.1.3.

65 Femër serbe e Kosovës, Leposaviq, 24 maj, 2007.



(91%) e të intervistuarve kanë shprehur gatishmëri për të kontribuar me kohën e tyre në projektet e tilla në të ardhmen. Një pjesë e madhe e njerëzve gjithashtu e kanë bërë me dije që janë të gatshëm për të kontribuar materialisht në aksionet për pastrim.

të këtillë, 80% e tyre kanë shprehur gatishmërinë që të përfshihen në të ardhmen. Vetëm 20% e atyre, të cilët nuk kanë qenë kurrë të përfshirë në pastrimet e komunitetit kanë pohuar që vështirë do të merrnin pjesë në projekte të këtilla, si me




Figura 8: Deri në çfarë mase pajtoheni me deklaratën vijuese: "Jam i gatshëm të kontribuoj me kohën/mjetet e mia në zhvillimin e një projekti, siç është pastrimi në komunitet"? (nr. bazë = 35)

Prandaj, siç u pa në projektet lidhur me sigurinë në trafik, njerëzit janë të gatshëm të kontribuojnë me para në parim dhe zbatimin i kësaj në praktikë ka pak gjasa. Ja se çfarë pohoi njëri prej të intervistuarve, "po të kisha mjaft para do të jepja, por buxheti im shtëpiak është shumë i vogël për t'i mbuluar nevojat tona mujore".⁶⁶

Shkalla e gatishmërisë për t'u përfshirë në nismat për pastrim është në përputhje të drejtë me spektrin e moshës, tregues ky mjaft inkurajues për qëndrueshmërinë e projekteve të tilla. Më tutje, ata të cilët nuk kanë marrë pjesë ende në një projekt

mjete ashtu edhe me kohë dhe vetëm një person (3% prej totalit), i cili kishte marrë pjesë më parë në projekt të tillë pohoi se do ta bënte këtë përsëri.

Çfarë është veçanërisht inkurajuese, është numri i projekteve mjedisore të inicuar nga banorët të mbështetura nga EVSB-të, gjë kjo që u diskutua nga të intervistuarit. Për shembull, një e intervistuar në Istog vëri në dukje që në fshatin e saj ka pasur mungesë të shërbimeve komunale për pastrim, kjo ishte gjithashtu përgjegjësi e fshatarëve për të siguruar mirëmbajtjen e hapësirave publik.⁶⁷ Përsëri, në Istog, "pothuajse të gjithë" banorët e një fshati ndërmarrin aksion për pastrim kolektiv në baza mujore.⁶⁸ Duhet të inkurajohet ndjenja e ngritjes së vetëdijes, meqë kjo inkurajon qëndrueshmëri të ndërmarrjes së aksioneve vetanake dhe

66 Femër serbe e Kosovës, Istog, 20 shtator, 2007.

67 Femër serbe e Kosovës, Istog, 20 shtator, 2007

68 Femër serbe e Kosovës, Istog, 20 shtator, 2007

mund të përsëritet në të gjitha fshatrat, qytetet dhe qytezat në tërë Kosovën.

3.2.4 Përfshirja e të rinjve dhe ndikimi mbi ta

Sipas Hulumtimit për këtë Vlerësim, është vlerësuar që rinia e Kosovës ka qenë e përfshirë në mënyrë shumë aktive. Ngritja e vetëdijes së rinisë për pasojat e ndotjes së mjedisit është një ndikim i dukshëm dhe i përhapur i punës, të cilën e kanë bërë EVSB-të. Projektet për pastrim, në shkollën ku nxënësit marrin pjesë shpeshherë, kanë ndihmuar të kenë një botëkuptim më të avancuar për pasojat e hedhjes së mbeturinave në mjedis, me këtë rast duke e theksuar kuptimin e tyre të ri për vetëdijesim, siç është dëshmuar më poshtë nga disa nxënës.

- *“Tani e dimë ku t’i hedhim mbeturinat... dhe ne sillemi ndryshe, ngase kemi mësuar shumë prej projekteve të realizuara në shkollën tonë”.* Femër shqiptare e Kosovës, nxënëse e shkollës fillore (Shkolla ‘Shaban Shabani’), Dragash, 14 qershor, 2007
- *“Për shkak se isha pjesë e këtij projekti, i cili ka pasur ndikim në vetëdijesimin e nxënësve, unë tani i hedh mbeturinat në vendin e duhur. Kur i shoh fëmijët i them që mos i hedhin mbeturinat në rrugë, ngase shkaktojnë pasoja për shëndetin e tyre”.* Femër shqiptare e Kosovës, nxënëse e Shkollës së Mesme (Shkolla ‘Haxhi Zeka’), Istog, 18 shtator, 2007.
- *“Unë kam marrë pjesë në projektin për pastrimin e mjedisit në shkollë, në qytet dhe në park. Qyteti tani është më i pastër dhe kjo ka pasur efekt në ajër po ashtu... [tani] Unë i hedh mbeturinat në kontejner. Në qytet kemi më shumë kontejner,*

por nëse nuk e gjej ndonjë ndonjëherë, i mbaj [mbeturinat] në xhep dhe [i hedh] kur të shoh ndonjë kontejner”. Femër shqiptare e Kosovës, nxënëse e shollës së mesme (Shkolla ‘Xhelal Hajda’), Rahovec, 18 shtator, 2007.

Efekti i këtyre projekteve është vërejtur gjithashtu nga drejtorët e shkollave, ku njëri prej tyre e kishte përmbledhur këtë çështje kështu: *“Këto projekte kanë efekt shumë pozitiv në sjelljet e fëmijëve. Ata mësojnë shkathtësi që mund t’i vënë në funksion si të rritur...përmes këtyre projekteve i mësojmë nxënësit të mendojnë dhe të jenë të përgjegjshëm. Është një dallim shumë i madh.”*⁶⁹

Kjo mund të shihet gjithashtu, që kuptimi i përgjegjësisë kolektive është kultivuar përmes projekteve mjedisore të EVSB-ve, me shumë nxënës duke e theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe partneritetit dhe nevojën e secilit ‘për t’u kujdesur për mjedisin’.⁷⁰ Në një shkollë në Rahovec, për shembull, nxënësit në mënyrë kolektive bëjnë pastrimin javor të oborrit të shkollës.⁷¹ Në mënyrë më të përgjithshme, tek nxënësit është vërejtur një tendencë më e madhe në inkurajimin e fëmijëve tjerë për mos hedhje të mbeturinave.⁷² Ky ndikim është veçanërisht i rëndësishëm ngase, nëse nivel i vetëdijesimit dhe kuptimit të përgjegjësisë rrezikohet në mesin e rinisë së Kosovës,

69 Mashkull serb i Kosovës, punëtor i shkollës fillore, Shtërpçë, 12 qershor, 2007.

70 Femër shqiptare e Kosovës, nxënëse e shkollës fillore (Shkolla ‘Shaban Shabani’), Dragash, 14 qershor, 2007.

71 Femër shqiptare e Kosovës, nxënëse e shkollës së mesme (Shkolla ‘Xhelal Hajda’), Rahovec, 18 shtator, 2007.

72 Femër serbe e Kosovës, nxënëse e shkollës fillore, Shtërpçë, 12 qershor, 2007.

atëherë ka gjasë që çfarëdo ngritje në aktivitetet e lidhura me mjedisin të jenë të qëndrueshme për një kohë të gjatë. Si të tilla, këto aktivitete të vazhdueshme duhet të inkurajohen si nga EVSB-të ashtu edhe nga udhëheqësit e shkollave.

3.2.5 Kontributi i partnerëve të EVSB-ve

Pjesa dërmuese e individëve të intervistuar për pastërtinë e mjedisit kanë qenë të kënaqur në përgjithësi me nivelin shërbimit të ofruar nga autoritetet kosovare sa i përket pastrimit publik si në komunat e tyre ashtu edhe në tërë Kosovën. Totali i 57% dhe 49% e njerëzve të intervistuar mendonin që autoritetet bënin një punë të ‘shkëlqyeshme’ ose ‘të mirë’ nëpër Kosovë, respektivisht në komunat e tyre të caktuara:

shërbimet publike për pastrim në nivel të Kosovës janë të cilësisë së ultë dhe 23% e konsiderojnë që kjo gjendje mbretëron edhe në komunat e tyre individuale.

Megjithëse numri i njerëzve të intervistuar për këtë çështje është i vogël, është e mundur të shihet që autoritetet në Istog dhe Rahovec kanë ofruar mbështetje, përderisa këta në Shtërpcë janë kritikuar rëndë nga shumica e të intervistuarve lokal. Tre prej katër personave të intervistuar në komunën e fundit kanë pohuar, që niveli i pastrimit publik është ‘i ultë’, ndonëse mungesa e burimeve të duhura është njohur si faktor kontribuues në këtë drejtim.⁷³ Mungesa e pajisjeve të duhura pengon hedhjen e duhur dhe adekuate të mbeturinave të amvisërisë, kjo një ankesë e përsëritur, me njërin prej të




Figura 9: Në përgjithësi, sa mendoni që autoritetet i ofrojnë qytetarëve të Kosovës shërbime të mira për pastrimin publik? (nr. bazë = 35)

Megjithatë, ky mendim vazhdon të mbizotëroj, ngase se një pjesë e madhe e njerëzve kanë shprehur pakënaqësinë e tyre për shërbimet. Katërmbëdhjetë përqind e individëve të intervistuar janë shprehur që

intervistuarve, i cili thekson që: “Problemi kryesor është që nuk kemi ndonjë ndihmë nga komuna për hedhjen e mbeturinave, kështu që i djegim mbeturinat, e plastika nuk mund të shkatërrohet pa riciklim të duhur”.⁷⁴ Prandaj, djegia e pakontrolluar

⁷³ Mashkull serb i Kosovës, punëtor i Shoqatës së Gjuetarëve, Shtërpcë, 12 qershor, 2007.

⁷⁴ Femër serbe e Kosovës, Istog, 20 shtator, 2007.

dhe jo e duhur e mbeturinave mund të prodhoj ndotës të dëmshëm,⁷⁵ dhe si rrjedhim është gjë thelbësore që të jenë në dispozicion mekanizmat adekuat për hedhjen e mbeturinave.

Një numër i personave të intervistuar theksuan që mungesa e inspektimit sistematik ose dënimeve për ata, të cilët nuk i hedhin mbeturinat e amvisërive tyre në mënyrë të duhur, e rëndojnë edhe më shumë nivelin tanimë edhe ashtu të ulët të vetëdijesimit publik ndaj kësaj çështjeje.⁷⁶ Kjo është çështje që duhet të shqyrtohet nga Kuvendet Komunale, si teprim i hedhjes së papërshtatshme të mbeturinave të amvisërive, e cila mund t'i shkakton probleme jo vetëm shëndetit të njerëzve dhe shëndetit estetik dhe material të mjedisit, por kjo i kontribuon edhe rreziqeve të shkaktuara nga qentë endacak.⁷⁷

Problemi i shpyllëzimit ilegal është ngritur gjithashtu nga disa të intervistuar, të cilët kanë shprehur dëshirën për autoritetet në Kosovë, që t'i adresohen kësaj çështjeje në mënyrë efikase. Për shembull, janë ndërmarrë disa masa nga EVSB-të e Istogut për t'iu adresuar kësaj çështjeje në bashkëpunim me autoritetet komunale, edhe pse ka pasur sukses për sa i përket arrestimit, një përfaqësues i EVSB-së ka theksuar që ndikimi që ata kanë mundur ta

75 Agjencia Evropiane për Mjedisin, Substancat e rrezikshme në mbeturina (2000), fq. 16-21. Mund të gjendet në: http://reports.eea.europa.eu/technical_report_no_38/en/tech38.pdf

76 Për shembull, një mashkull shqiptar i Kosovës, anëtar i EVSB-së, Dragash, 14 qershor, 2007 dhe një femër serbe e Kosovës, Leposaviq, 24 maj, 2007.

77 Shih më lartë seksionin xx.

kenë nuk i ka përmbushur pritjet e tyre.⁷⁸ Më tutje, EVSB-ja e Dragashit ka punuar në bashkëpunim të suksesshëm me policinë kufitare të SHPK-së, autoritetet komunale, KFOR-in dhe autoritetet komunale në Shqipëri për adresimin e çështjes së shpyllëzimit ilegal,⁷⁹ dhe ende është i nevojshëm vazhdimi i aksionit nga ana e SHPK-së dhe autoriteteve komunale, që t'i qasen kësaj çështjeje në mënyrë efektive.

Standardi i shpërndarjes së informatave lidhur me çështjet mjedisore është veçanërisht e rëndësishme, duke e ditur që niveli i zhvilluar i kuptimit dhe vetëdijesimit është i rëndësishëm për zhvillimin e aksionit në fjalë. Prandaj, është inkurajuese që shumica e të intervistuarve (63%) konsiderojnë që autoritetet e tyre komunale bëjnë punë 'të shkëlqyeshme' ose 'të mirë' në ofrimin e informatave për çështjet mjedisore, ndonëse një pjesë më e vogël (40%) konsideron të jetë gjendje e njëjtë në tërë Kosovën.

Pra, pjesa dërmuese e pakicës (20%) konsideron që Kuvendet Komunale bëjnë punë të 'dobët' në ofrimin e informatave për mjedisin. Një e intervistuar e ka theksuar shqetësimin e saj për këtë çështje si në komunën e saj ashtu edhe në Kosovë në përgjithësi: "Komuna nuk ofron asnjë informatë për projekte ose aktivitete ...Nëse çdo komunë vepron [si] e jona, më duhet të them që gjendja në [tërë Kosovën] është e keqe."⁸⁰

78 Mashkull shqiptar i Kosovës, përfaqësues komunal/anëtar i EVSB-së, Istog, 20 Maj 2008.

79 Mashkull shqiptar i Kosovës, përfaqësues komunal/anëtar i EVSB-së, Dragash, 20 maj, 2008.

80 Femër serbe e Kosovës, Istog, 20 shtator, 2007.




Figura 10: Në përgjithësi, sa mendoni që autoritetet punojnë mirë në ofrimin e informatave qytetarëve lidhur me mjedisin..?' (nr. bazë = 35)

Kontributi i dhënë nga SHPK-ja në përmirësimin e kushteve të mjedisit është theksuar gjithashtu nga të intervistuarit për këtë Vlerësim. Në të vërtetë, përveç rolit të njëjësive të SHPK-së që kanë luajtur në adresimin e çështjes së qenve endacak ekzistojnë edhe shumë shembuj të shkëlqyeshëm të SHPK-së që punon në partneritet me EVSB-të për implementimin e projekteve, që kanë ndikim mbi sigurinë e mjedisit dhe vetëdijesimit. Pothuajse në të gjitha nismat e 'pastrimit' të diskutuara lartë në seksionin 3.2.1, për shembull, zyrtarët e SHPK-së kanë qenë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt. Më tutje, SHPK-ja ka qenë veçanërisht aktive në shkolla. Për shembull, në Shtërpçë, një komunitet së bashku me SHPK-në dhe në partneritet me shkollën lokale kanë bërë iniciimin e projektit për pastrim dy herë në vit.⁸¹

81 Mashkull serb, punëtor shkolle, Štrpce/Shtërpçë, 12 qershor 2007.

3.2.6 Partneritetet dhe zgjidhja e problemeve

Edhe pse ka pasur sfida e kufizime, projektet e ndërmarra nga EVSB-të në fushën e sigurisë mjedisore kanë kontribuar në krijimin e marrëdhënieve bashkëpunuese të shumanshme, mes faktorëve të ndryshëm dhe anëtarëve të komunitetit. Jo vetëm që këto kanë pasur ndikim të qartë dhe pozitiv mbi banorët e këtyre komunave, ato kanë pasur rëndësi të madhe për qëndrueshmërinë. Pa marrë parasysh a janë këto partneritete të rastit dhe për një projekt të caktuar, apo më të strukturuar dhe të rregullta prej natyrës, mund të vërehet që EVSB-të rregullisht kërkojnë të zhvillojnë marrëdhënie pune mbështetëse me organizatat dhe aktorët gjegjës për të arritur synimet e projektit.

Përveç partneriteteve që EVSB-të kanë krijuar me autoritetet komunale dhe njësitë e SHPK-së në implementimin e projekteve të përqendruara në mjedis, ato kanë punuar edhe në bashkëpunim me shoqatat e gjahtarëve. Kjo ka ndodhur jo

vetëm në lidhje me iniciativat që synojnë zvogëlimin e pranisë së qenve të rrugës, por edhe në lidhje me aktivitete tjera më të përgjithshme. Për shembull, në Shtërpçë, shoqata e gjahtarëve është përfshirë në aktivitete të pastrimit të lumit dhe rrugëve disa herë gjatë vitit, në partneritet me EVSB-në lokale, SHPK-në, shkollat lokale dhe autoritetet komunale.⁸² Shoqata e gjahtarëve në Leposaviq shpesh mban takime mujore me përfaqësuesit e EVSB-së për të diskutuar problemet e komunitetit.⁸³

Tutje, përfshirja dhe bashkëpunimi me bashkësitë lokale janë të domosdoshme për mirëmbajtjen e programeve të tilla për një periudhë më të gjatë. Një i intervistuar theksonte që “ne [i kemi treguar] komunitetit që asgjë nuk mund të ndryshojë vetvetiu... Nëse duam të bëjmë diçka në lidhje me përmirësimin e kushteve të jetesës... ne duhet të punojmë si ekip... Ky lloj i punës ka rritur vetëdijen e bashkësisë, ashtu që askush nuk zgjidh problemet tuaja nëse nuk bëni një lëvizje të tillë vetë”.⁸⁴

Si rezultat i partneriteteve vazhdimisht të zhvilluara dhe të përdorura nga EVSB-të, jo vetëm që vetëdija mjedisore është në nivel të mirë, siç është provuar nga përfshirja e konsiderueshme sociale në projektet mjedisore të EVSB-ve, por ekziston edhe një nivel i mirë i besimit që EVSB-të mund të qasen dhe të jenë të besueshme në zgjidhjen e problemeve të ndryshme

në partneritet me vetë banorët.⁸⁵ Siç ka theksuar një anëtar i EVSB-së, banorët e Kosovës janë të mësuar me premtimet e organizatave e aktorëve të ndryshëm, dhe si të tillë, nivelet e besimit mund të jenë të ulta. Megjithatë, “njerëzit shohin veprimet [e EVSB-ve], [të cilat] kanë vërtetuar fjalët tona. Si rezultat, besimi publik në EVSB-të është rritur ... [Njerëzit] shohin rezultatet e projekteve [të EVSB-ve] dhe iu besojnë [atyre].”⁸⁶ Rëndësia e një bashkëpunimi të tillë u përshkrua edhe më mirë nga një anëtar i EVSB-së, i cili thoshte që “pa partneritet, disa gjëra serioze nuk mund të bëhen”.⁸⁷ Zëvendës-Kryetari i Kuvendit Komunal të Dragashit theksoi më tutje këtë ndikim të vlefshëm, duke theksuar që “duke iu falënderuar programit të EVSB-ve, partneriteti mes komunës, SHPK-së dhe komunitetit është përmirësuar. Komunikimi është përmirësuar, edhe mjedisi është përmirësuar”.⁸⁸

3.3 Konkludim

Është e qartë që puna e EVSB-ve ka pasur një ndikim të dukshëm mbi nivelin e perceptuar të sigurisë së komunikacionit në disa komuna, si dhe ka krijuar parakushtet e domosdoshme për përmirësimin e sigurisë në të vërtetë. Një numër shenjash trafiku dhe kalimesh për këmbësorë paraqesin zhvillime pozitive, edhe pse

82 Mashkull serb, punëtor i Shoqatës së Gjahtarëve, Shtërpçë, 12 qershor 2007.

83 Mashkull serb, anëtar i EVSB-së, Leposaviq, 24 maj 2007.

84 Mashkull serb, anëtar i EVSB-së, Leposaviq, 09 gusht 2007.

85 Mashkull serb, Leposaviq, 29 maj 2007.

86 Mashkull shqiptar, anëtar i EVSB-së, Istog, 20 shtator 2007.

87 Mashkull shqiptar, anëtar i EVSB-së, Istog, 20 shtator 2007.

88 Mashkull shqiptar, Zëvendës Kryetar i Kuvendit Komunal, Dragash, 14 qershor 2007.

mbetet mjaft për t'u bërë. Për të rritur suksesin, është e domosdoshme mbështetja e plotë nga autoritetet komunale. Personat e përfshirë në programin e EVSB-së, kanë raportuar që ndjehen më të sigurt brenda dhe mes trafikut, si dhe që ndjejnë se SHPK-ja përgjithësisht po vepron përgjithësisht mirë për të plotësuar nevojat e trafikut të komuniteteve të tyre. Mijëra studentë janë edukuar mbi sigurinë në trafik, si dhe si rezultat, tani kanë nivel më të lartë të vetëdijes mbi rreziqet e trafikut. Tutje, partneritetet mes EVSB-ve, SHPK-së, shkollave, komuniteteve dhe autoriteteve komunale po përforcohen për shkak të synimeve të përbashkëta që kanë. Megjithatë, mbetet shumë për t'u bërë në këtë fushë, nga EVSB-të, bashkësitë në përgjithësi, si dhe autoritetet, të rendit dhe ato komunale.

Suksesi i një numri të konsiderueshëm të projekteve të ndërmarra nga EVSB-të që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejt dhe pozitiv në cilësinë e mjedisit në bashkësitë lokale është gjithashtu i dukshëm. Edhe pse në këtë moment është gati e pamundur të thuhet nëse puna e EVSB-ve ka ndikuar në shkallën e ndotjes në Kosovë, është e qartë që mjedisi vizual është përmirësuar në fshatra dhe qyteza ku ato funksionojnë. EVSB-të kanë bërë përparim të konsiderueshëm në motivimin e bashkësive lokale që të kujdesen për rrethanat e tyre të afërta si dhe ngritjen e vetëdijes mbi çështjet mjedisore tek fëmijët. Megjithatë, për të pasur një ndikim të qëndrueshëm, aksionet e pastrimit duhet të jenë të rregullta, ndërsa përpjekjet për edukimin e njerëzve mbi rreziqet që bart shkarkimi i pakujdesshëm

i mbeturinave duhen intensifikuar, ashtu që të sigurohet një zgjidhje më afatgjatë e problemit. Përfundimisht, partneritetet gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, nganjëherë edhe përtej "kufijve etnikë" janë krijuar tashmë, duke pasur kontaktin mes EVSB-ve, bashkësive, Kuvendeve Komunale, SHPK-së, shoqatave të gjahtarëve dhe OJQ-ve lokale, KFOR-it, e të tjerëve.

3.4 Rekomandimet

Siguria në komunikacion

- Orientimi i dukshëm kah veprimi social në fushën e sigurisë në trafik qartësisht theksohet nga puna e deritanishme e EVSB-ve, si dhe ndikimit që kanë pasur ato. Si i tillë, implementimi i qëndrueshëm i projekteve të trafikut duhet marrë parasysh nga autoritetet komunale dhe drejtoritë gjegjëse qeveritare, për t'u ndërtuar mbi sukseset e arritura deri tani, si dhe për të arritur sukseset e ardhshme.
- Autoritetet komunale duhet të sigurojnë mbështetjen e mjaftueshme, logjistike e financiare, për projektet e sigurisë në trafik të ndërrmarra nga EVSB-të dhe partnerët e tyre për të shmangur dështimin e projekteve.
- SHPK-ja, në partneritet me EVSB-të dhe shkollat vendore, duhet të vazhdojë të ketë programe të rregullta të ngritjes së vetëdijes mbi trafikun.
- SHPK-ja duhet të kërkojë implementimin e një qasjeje “së nga poshtë lartë” në policinë e trafikut, duke pasur për qëllim përfundimtar dhe të qëndrueshëm ndryshimin e qëndrimeve.

Kushtet dhe siguria mjedisore

- EVSB-të duhet të vazhdojnë të punojnë në angazhimin e banorëve në projektet mjedisore, si dhe në ngritjen e vetëdijes mbi përfitimet që mund të arrihen, si dhe rreziqet që shkaktohen nga dëmet mjedisore.

Ka nevojë për një përqendrim më të veçantë në rininë e Kosovës, për të siguruar përmirësime të qëndrueshme.

- Autoritetet komunale duhet të ndajnë resurset adekuate për projekte mjedisore më afatgjate, si mbjellja e trungjeve, pastrimet afatgjate të lumenjve, si dhe iniciativat për uljen e nivelit të ndotjes në mënyrë që të përforcohen ndikimet pozitive të aktiviteteve të pastrimit dhe ngritjes së vetëdijes.
- Autoritetet komunale dhe qeveria duhet të mundohen të ndërtojnë mekanizma për trajtimin efektiv të çështjes së prerjes së paligjshme të drurit në bashkëpunim me SHPK-në.
- Autoritetet komunale duhet të sigurojnë që gjitha fshatrat dhe qytetet të kenë stabilimentet e duhura për deponimin e mbeturinave. Ato gjithashtu duhet të kenë një sistem gjithëpërfshirës të “kontrolleve” në gjithë komunën për të siguruar që mbeturinat amvisnore po deponohen në pajtim me standarde të pranueshme. Vendosja e dënimeve mbi ata që nuk respektojnë rregulloret e tilla gjithsesi duhen marrë parasysh.
- Autoritetet komunale duhet të sigurojnë që mbështetja adekuate, financiare e praktike, t'i jepet projekteve mjedisore nga EVSB-të dhe partnerët e tyre.

- Autoritetet komunale duhet të sigurojnë marrjen e vendimeve me kohë mbi veprimet e propozuara kundër qenve të rrugës, si dhe mbështetja e duhur i duhet dhënë atyre që janë të përfshirë.

4. NDIKIMET E GJERA PROGRAMORE

Ashtu si ndikimi i menjëhershëm i dukshëm në çështjet si siguria e trafikut dhe kushtet mjedisore,⁸⁹ EVSB-të kanë pasur një mundësi të gjerë të ndikimit në çështje më të gjera, kjo për shkak se EVSB-të janë gjithëpërfshirëse në qasjen e tyre: ato përbëhen nga banorët, zyrtarët komunalë, udhëheqësit e bashkësive dhe zyrtarët e SHPK-së: meshkuj, femra e të rinj, të cilët punojnë bashkë si pjesë e një ekipi të vetëm. Më tutje, gjatë punës së tyre, ata bashkëpunojnë me shumë aktorë të ndryshëm, duke përafruar kështu një spektër të gjerë faktorësh, si dhe duke vepruar përgjatë vijave etnike. Edhe pse ndikimet e gjera të programit janë të ndryshme, Vlerësimi ka kërkuar të hulumtojë dy aspekte të kësaj çështjeje: bashkëpunimi ndëretnik në zona shumëetnike dhe ndikimi i EVSB-ve në raportet mes banorëve dhe SHPK-së. Pasi këto çështje gjithsesi përmbajnë përqendrimin në qëndrimet individuale, secili ndryshim më i madh do të vihet në dukje vetëm pas një periudhe më të gjatë kohore. Por përsëri, është e mundur të shihen shenjat e një bashkëpunimi të rritur dhe raporteve të ndërsjella që dalin nga programi deri në këtë moment.

⁸⁹ Shih pjesën 3, 'Ndikimet specifike të projekteve'.

4.1 *Bashkëpunimi ndëretnik*

Tema e raporteve ndëretnike mbetet çështje e ngutshme dhe e ndjeshme, ndërsa bashkësitë dhe raportet mes tyre në Kosovë janë shpesh temë e diskutimeve ndërkombëtare. Një nga parashikimet fillestare të Ekipit të Programit në fillim të programit është që EVSB-të të krijojnë një forum për komunikimin dhe dialogun ndëretnik.⁹⁰ Ka pasur një numër projektesh përmes të cilave EVSB-të drejtpërsëdrejti janë munduar të përmirësojnë këto marrëdhënie, por shumë më shpesh ndikimi vjen edhe si produkt anësor i projekteve që kanë kërkuar të arrijnë qëllime më diskrete apo të prekshme, si pastrimi i mjedisit. Për shkak të rëndësisë, ekipi i hulumtimit ka vendosur të përqendrohet në këtë çështje, si dhe pa marrë parasysh sfidat në lidhje me vlerësimin e saktë të ndryshimeve në marrëdhëniet ndëretnike te këto zona, hulumtimi tregon disa zhvillime pozitive.

4.1.1 **Brengat kryesore dhe çështjet e trajtuara nga EVSB-të**

EVSB-të kanë ndërmarrë një numër projektesh që në mënyrë specifike kanë kërkuar të afrojnë bashkësitë e ndryshme si dhe të përmirësojnë bashkëpunimin e raportet mes tyre. Një nga më të shpeshtit dhe më të suksesshmit nga ta ka qenë seria e kampeve rinore që janë organizuar nga apo me ndihmën e EVSB-ve. Këto kampe kanë bashkuar fëmijët e bashkësive

⁹⁰ Ish-anëtar i Programit të EVSB-ve, Vushtrri, 28 maj 2008.



EVSB-JA E OBILIQIT ORGANIZON
KAMPIN RINOR SHUMETNIK NË
BREZOVIÇË

të ndryshme për një javë në aktivitete e punëtori të përbashkëta. Për shembull, kampe të tilla janë mbajtur në kompleksin malor të Brezovicës, të organizuar nga EVSB-të në Dragash, Kamenicë dhe Rahovec, ndërsa EVSB-të në Novobërdë, Prizren dhe Shtërpçë kanë siguruar mbështetjen organizative dhe fond-mbledhëse për kampe në komunat e tyre. Tutje, kampi rinor shumetnik iniciuar nga autoritetet komunale në Fushë Kosovë, si dhe organizuar në bashkëpunim me EVSB-të, përfshinte jo vetëm fëmijë shqiptarë, serbë, ashkali e romë, por edhe një numër të rinjsh nga Gjermania. Vlera e përafrimit të të rinjve në këto forume është e konsiderueshme: përveç hyrjes në dialog, ata mësojnë të punojnë bashkë në arritjen e qëllimeve të tyre, gjë që është e domosdoshme për stabilitetin afatgjatë të Kosovës. Të ndara, por në plotësim të kampeve rinore shumetnike të EVSB-ve, ishin kampe rinore të “Udhëheqësve të Ardhshëm”, të administruar nga Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës⁹¹ në partneritet me ekipin e programit të EVSB-ve dhe ICITAP-in gjatë vitit 2004 dhe 2005. vijuar nga bashkësitë shqiptare, serbe, boshnjake, rome, ashkali, egjiptiane dhe turke, kampe i ofronin pjesëmarrësve një mundësi të përfitimit të aftësive për menaxhimin e konflikteve dhe zgjidhjes së problemeve, në mjedise shumetnike. Kampe ishin pranuar mirë, duke u bazuar në një përmbledhje të dhënë nga një pjesëmarrës: “Pata kënaqësinë të jem me grupin tim punues, mësonim, diskutonim

dhe luanim bashkë. Njohja me studentë nga bashkësitë tjera etnike qe një mundësi që nuk e kemi pasur ndonjëherë më parë.”⁹²

Një shembull tjetër i mirë i projekteve ndëretnike ishte më 2005, kur EVSB-ja e Vushtrrisë, në bashkëpunim me OJQ-në ndërkombëtare “Gratë për Gratë” dhe bashkësinë lokale, implementoi një projekt të quajtur “Muret përreth Shtëpive”. Kjo iniciativë lindi nga diskutimet për kthimin e familjeve ashkali të cilat kishin braktisur komunën gjatë dhunës së marsit 2004, ku u dogjën 72 shtëpi të tyre. Ashkallitë e zhvendosur kishin kërkuar që, në ruajtjen e traditës kulturore, muret të ngriheshin përreth shtëpive në të cilat do të ktheheshin. Projekti kishte 13 familje përfituese me shtëpitë e tyre, si dhe fitoi mbështetje të fuqishme nga bashkësia shqiptare e Vushtrrisë, Kuvendi Komunal, njësitë lokale të SHPK-së dhe qeveria. Natyra bashkëpunuese e këtij projekti ishte theksuar nga një pjesëmarrës, i cili theksoi që “me mbështetjen që kemi nga banorët, komuna dhe institucionet tjera, gjithmonë do të jemi të suksesshëm”.⁹³ Një tjetër pjesëmarrës gjithashtu përshkruante mënyrën në të cilën projekti ka pasur ndikim në jetën e përditshme të komunës: “Tani komuniteti ashkali jeton në liri të plotë në shtëpitë e tyre. Ata kanë liri të lëvizjes [dhe mund të] vizitojnë vendet

91 Tani Qendra Kosovare për Sigurinë Publike, Edukim dhe Zhvillim.

92 Pjesëmarrës serb i “Kampit Rinor të Udhëheqësve të Ardhshëm”, 2 – 4 korrik 2004.

93 Grua, anëtare e EVSB-së, Vushtrri, 13 shtator 2007.

që duan”.⁹⁴ Një anëtar tjetër i EVSB-së së përfshirë në këtë projekt fliste për mënyrën në të cilën integrimi i plotë i komunitetit ashkali në shoqërinë e Vushtrrisë i siguroi atij motivin personal për t’u përfshirë në projekt, si dhe faktin që parashikimet e tij për suksesin ishin tejkaluara tanimë.⁹⁵ “Roli kryesor” që pati EVSB-ja në këtë iniciativë dhe përpjekjet e vazhdueshme për ri-integrim diskutoheshin më tutje nga një përfitues i projektit, i cili theksonte që “me ndihmën [e EVSB-së], gjithë fëmijët e bashkësisë [ashkali] tani shkojnë në shkollë... Për çfarëdo kërkesë, nevoje apo problemi, ne shkojmë tek EVSB-ja”.⁹⁶ Ndikimi i EVSB-së së Vushtrrisë në këtë rast është i konsiderueshëm, si dhe siguron themelin për zhvillimin e qëndrueshëm të marrëdhënieve ndëretnike.

Përveç kësaj, EVSB-ja në Vushtri punonte me partnerët për të ndërtuar një rrugë të re (“Rruga e Integritit”) e cila lidh bashkësinë ashkali me zonën shqiptare në qytet, duke rritur nivelin e kontaktit dhe duke përmirësuar në masë të konsiderueshme marrëdhëniet mes dy komuniteteve.⁹⁷ Anëtarët e EVSB-së janë gjithashtu të përfshirë në iniciativën e ndërtimit të “Urës së Integritit”. Ky projekt doli nga një iniciativë e Departamentit Britanik për Zhvillimin

94 Anëtar i EVSB-së, Vushtri, 10 gusht 2007.

95 Anëtar i EVSB-së, Vushtri, 10 gusht 2007.

96 Qytetar ashkali dhe përfitues i projektit të EVSB-së, Vushtri, 14 gusht 2007.

97 Mashkull shqiptar, përfaqësues komune/anëtar i EVSB-së, Vushtri, 28 maj 2008.

Ndërkombëtar (DFID) dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë, për mundësimin e dialogut mes udhëheqësve shqiptarë dhe serbë të Prelluzhes më 2004, gjatë të cilit ishte ngritur nevoja për një urë të re – fizike e mendore - mes bashkësive. EVSB-ja kishte grumbulluar nënshkrimet nga 250 përfaqësues nga bashkësia, komuna, TMK-ja dhe KFOR-i, për mbështetjen e rindërtimit të urës mbi lumin Sitnicë për të lidhur bashkësitë shqiptare dhe serbe. Tani ata janë në përgatitje të diskutimit të çështjes me udhëheqësit e bashkësisë serbe. Ky është një shembull i shkëlqyeshëm i asaj se si EVSB-të janë përfshirë në një iniciativë dhe kanë marrë hapa proaktiv në zhvillimin e saj, për të ndërtuar nivelet e komunikimit dhe ndërveprimit/pajtimit mes bashkësive të ndryshme.

Shembuj tjerë projektesh me ndikim ndëretnik përfshijnë projektin e quajtur “Duar të shkathta”, i cili ishte iniciuar nga EVSB-ja në Lipjan më 2006. Ky projekt bashkoi gratë e komunitetit shqiptar, atij serb dhe ashkali për të mësuar aftësitë e fitimit të vendit të punës, si dhe angazhimit në dialogun mes bashkësive.⁹⁸ Edhe lëvizjet nga EVSB-ja e Kamenicës për heqjen e barrierave që ndanin shqiptarët dhe serbët në Kamenicë, të cilat ishin vendosur nga kontingjenti amerikan i KFOR-it për shkak të ndjenjës së pasigurisë tek banorët serbë kishin pasur një ndikim pozitiv në raportet

98 EVSB-ja implementoi këtë në bashkëpunim me SHPK-në, një shkollë të mesme (Adem Gllavica). Ai mori financimin nga OJQ-ja norvegjeze ‘Norges Vell’.



PJESËMARRËSIT E TURNIRIT MULTI-ETNIK NË FUTBOLL NË ISTOG

ndëretnike. Më 2006, EVSB-ja lokale propozoi që barrierat të hiqeshin si rezultat i pengesave që krijonin për rrjedhën e trafikut. Edhe pse edhe KFOR-i dhe bashkësia serbe në fillim nuk pranuan të bënin një gjë të tillë për shkak të brengave për sigurinë, marrëveshja u arritur pas një diskutimi të gjatë mes përfaqësuesve komunalë, EVSB-së dhe udhëheqësve të serbëve në qytezë. Për të zbutur brengat e mbetura të sigurisë, udhëheqja komunale u pajtua të instalonte ndriçim rruge, shenja trafiku dhe trotuar shtesë në qytezë,⁹⁹ si dhe me ndihmën financiare dhe praktike të disa dhjetëra banorëve, si dhe bashkëpunimin e SHPK-së, barrierat u hoqën. Barriera nuk ka më për momentin, ndërsa anëtarët e EVSB-së kanë raportuar që liria e lëvizjes dhe komunikimet mes bashkësive janë përmirësuar si rezultat i kësaj.¹⁰⁰

Arti dhe sporti shpesh janë përdorur nga EVSB-të si mënyra për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike. Në Kamenicë për shembull, EVSB-ja lokale dhe kontingjenti i KFOR-it organizuan një garë futbollit për gjitha bashkësitë.¹⁰¹ Kishte ngjarje të ngjashme shumëtnike edhe në Shtërpçë dhe Istog, në të cilat merrnin pjesë shqiptarët, serbët, boshnjakët, romët dhe ashkalitë. EVSB-ja në Rahovec implementoi një projekt në partneritet me një pronar të një pishine që mblodhi 100 banorë nga

gjitha bashkësitë për të notuar bashkë pa pagesë, për një muaj. Si rezultat i iniciativës, njerëzit nga bashkësitë e ndryshme lidhën miqësi, ndërsa EVSB-ja tani dëshiron ta ketë projekt për çdo vit.¹⁰² Një konkurs arti, me temën “toleranca ndëretnike”, është mbajtur në Fushë Kosovë. Studentët nga të gjitha komunitetet morën pjesë për të “treguar vizionin e tyre që [ata] të gjithë mund të jetojnë bashkë në Kosovë”.¹⁰³

Mund të shihet gjithashtu që projektet me qëllime më të ndryshme e të prekshme, si përmirësimi i standardeve mjedisore kanë pasur ndikim pozitiv në marrëdhëniet ndëretnike. Për shembull, projektet e rregullta të pastrimit në Istog, të cilat implementohen në bashkëpunim me disa aktorë të ndryshëm,¹⁰⁴ kanë rezultuar në një bashkëpunim më të mirë mes komuniteteve të ndryshme, si shqiptarët, serbët e ashkalitë.¹⁰⁵ Siç diskutohet më gjerësisht në pjesën 3.2.1, EVSB-ja në Fushë Kosovë gjithashtu ka zbatuar një projekt me qëllim të përmirësimit të lagjes së banuar nga ashkalitë. Ky projekt është ndërmarrë në partneritet me vetë bashkësinë ashkali, Kuvendin Komunal dhe një OJQ ndërkombëtare.¹⁰⁶

Qasja interaktive që EVSB-të kanë marrë në përgjigje ndaj marrëdhënieve ndëretnike është nënvizuar nga

102 Anëtar i EVSB-së, Rahovec, 18 shtator 2007.

103 Femër shqiptare, oficere e SHPK-së, Fushë Kosovë, 17 maj 2007.

104 Për më shumë informata mbi këtë projekt, shih pikën 3.2.1.

105 Shqiptar, Istog, 20 shtator 2007.

106 Shqiptar, përfaqësues i Kuvendit të Komunës, Fushë Kosovë, 17 maj 2007.

99 Mashkull serb, Kamenicë, 5 qershor 2007.

100 Anëtar i EVSB-së, Kamenicë, 20 maj 2008.

101 Mashkull shqiptar, Anëtar i EVSB-së Kamenicë, 05 qershor 2007.

një përfaqësues komunal në Klinë, i cili ka theksuar që “gatishmëria për të dëgjuar dhe për të ndihmuar njerëzit në problemet e tyre” ka qenë një nga sukseset më të mëdha të programit”.¹⁰⁷ Suksesi që EVSB-të kanë pasur në lidhje me komunikimin dhe bashkëpunimin ndëretnik është pra pozitiv, si dhe ata duhet të vazhdojnë të përqendrohen në këtë fushë, për të pasur një kontribut më të qëndrueshëm në raportet mes komuniteteve të shumta e të ndryshme etnike të Kosovës.

- *“Duke iu falënderuar programit të EVSB-ve, shumë çështje janë përmirësuar. Për shembull, siguria është më e mirë, marrëdhëniet ndëretnike janë përmirësuar, ndërsa partneriteti mes publikut dhe komunës, e institucioneve tjera është përmirësuar”. Boshnjak, Zëvendës Kryetar i Kuvendit të Komunës, Dragash, 14 qershor 2007.*
- *“Ndikimi i EVSB-ve është i madh. Ato gjenden prapa shumë ndryshimeve.” Shqiptar, Kryetar i Kuvendit të Komunës, Fushë Kosovë, 17 maj 2007.*
- *“Roli i EVSB-ve në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe sigurisë në Fushë Kosovë është tejet i lartë... Duke iu falënderuar EVSB-ve, njerëzit tani punojnë bashkë”. Shqiptar, Zëvendës Kryetar i Komunës, Fushë Kosovë, 17 maj 2007*

¹⁰⁷ Zëvendës Kryetar i Kuvendit të Komunës, Klinë, 10 shtator 2007.

4.1.2 Perceptimet e bashkësisë mbi marrëdhëniet ndëretnike

Hulumtimet e gjera dhe të reja nga organizatat e ndryshme tregojnë që marrëdhëniet ndëretnike vazhdojnë të mbesin brengë e popullsisë së Kosovës. Dymbëdhjetë përqind (12%) të të anketuarve në një anketë të vitit 2007 theksonin marrëdhëniet ndëretnike si një nga problemet më të ngutshme të sigurisë, edhe pse kjo gjë shkonte deri në 56.9% tek të anketuarit serbë.¹⁰⁸ Megjithatë, hulumtimet e bëra më 2007 tregojnë që një masë e madhe e popullsisë së Kosovës konsideron marrëdhëniet ndëretnike të jenë përmirësuar. Shtatëdhjetë e katër përqind (74%) e shqiptarëve, 35% e serbëve dhe 80% e komuniteteve tjera janë raportuar të kenë këtë mendim në tetor të vitit 2007, edhe pse këto statistika tregojnë një rënie të vogël nga qershori 2007.¹⁰⁹ Ky perceptim pozitiv në rritje mbështetet nga statistikat zyrtare të SHPK-së, të cilat tregojnë që krimet apo incidentet e regjistruara me elementin potencial “etnik” kanë pasur një rënie të vazhdueshme në tri vitet e kaluara, deri në numrin 24 në vitin 2007.

¹⁰⁸ FIQ dhe Saferworld, Siguria njerëzore në Kosovë: një Anketë perceptimesh (Human security in Kosovo: A survey of perceptions) (maj 2006), p. 20. gjendet tek: http://www.saferworld.org.uk/images/pubdocs/Human_Security_in_Kosovo_English.pdf

¹⁰⁹ Ku 92%, 90% dhe 95% e secilit grup mbante këtë mendim. Shih UNDP Kosovo, Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, Nr. 18, (tetor 2007), p. 35. gjendet tek: http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/EWR_eng.pdf




Figura 11: Numri i incidenteve kriminale të klasifikuara si elemente potenciale etnike (Burimi: Të dhënat zyrtare të SHPK-së)

EVSB-të e komunave që ia vlen të përmenden për mungesën e incidenteve të tilla më 2007 janë Dragashi, Fushë Kosova, Gjakova, Istogu, Klina, Kaçaniku, Lipjani, Novobërda, Obiliqi, Prizreni, Rahoveci dhe Vitia.

Hulumtimet e bëra nga UNDP në Kosovë tregojnë që ka pasur një zvogëlim të numrit të serbëve që do të jetonin apo punon me anëtarë të një bashkësie tjetër, duke pasur vetëm 30% të këtij grupi që thonë se do të jetonin në të njëjtin qytet me shqiptarët në tetor 2007. Statistika gjegjëse për të anketuarit shqiptarë është 40%.¹¹⁰ Megjithatë, shumë shqiptarë që kanë marrë pjesë në këtë vlerësim kanë theksuar që në kohën e anketës kanë shumë më tepër mundësi që të vizitojnë një serb të Kosovës sesa më 2002. Pjesëmarrësit serbë kanë raportuar një qasje të ngjashme për takimin me shqiptarë. Duhet mbajtur mend që

shqiptarët dhe serbët e intervistuar për këtë anketë jetojnë në komunitetet ku EVSB-të kanë qenë aktive, si dhe që këto rezultatet tregojnë që përfshirja në programin e EVSB-së ka pasur një ndikim pozitiv në perceptimet e anëtarëve të komunitetit mbi marrëdhëniet ndëretnike.

Konflikti i Kosovës, për mendimin e shumë të intervistuarve, është shkaku i shumë vështirësive në marrëdhënie brenda Kosovës. Siç thoshte një i intervistuar boshnjak: “nuk është e lehtë të pihet kafja [me një person nga një bashkësi tjetër] nëse keni humbur dikë nga familja në luftë”.¹¹¹ Një tjetër i intervistuar, ashkali, thoshte që në të kaluarën, takimi me një anëtar të bashkësisë shqiptare do të kishte qenë “problem”, për shkak të numrit të madh të njerëzve që ende janë të zhdukur nga fshati i tij, si dhe marrëdhëniet e vështira nga kjo.¹¹² Disa anëtarë të EVSB-ve gjithashtu theksojnë që në nivelin personal të komunikimit ndëretnik, dialogu, sidomos mes shqiptarëve e serbëve, mund të arrihet menjëherë, por nganjëherë ai raport mund

110 UNDP Kosovo, Raporti i Paralajmërimit të Hershëm Kosovë, Nr. 18, (tetor 2007), f. 36. Gjetet në: http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/EWR_eng.pdf

111 Boshnjak, Zëvendës Kryetar i Kuvendit të Komunës, Dragash, 14 qershor 2007.

112 Mashkull Ashkali, Zëvendës Kryetar i Kuvendit të Komunës, Fushë Kosovë, 17 maj 2007.

të "politizohet", duke e bërë dialogun formal të vështirë.¹¹³ Në këtë kuptim, ekziston brenga që proceset dhe retorika politika mund të jenë duke penguar nivelin e suksesit që po arrihet në këtë fushë.¹¹⁴ Megjithatë, nëse EVSB-të vazhdojnë të punojnë në mundësimin e komunikimit ndëretnik, atëherë mund të ndërtojnë raporte personale të cilat kanë mundësi të anashkalojnë politikën.

Megjithatë, disa komuna janë spikatur nga të intervistuarit për nivelet e tyre veçanërisht pozitive të bashkëpunimit ndëretnik. Për shembull, marrëdhënia mes shqiptarëve dhe bashkësisë së madhe gorane/boshnjake në Dragash është mjaft e njohur për nivelin e lartë të bashkëpunimit ndëretnik. Zëvendës Kryetari i Kuvendit të Komunës theksoi masën në të cilën bashkësia ndërvepron dhe bashkëpunon, por edhe nënvizoi numrin relativisht të lartë të martesave të përziera.¹¹⁵ Ky qëndrim mbështetet edhe nga statistikat e SHPK-së që tregojnë mungesën e "incidenteve etnike" në komunë gjatë vitit 2007, me vetëm një rast të tillë më 2005 dhe një tjetër më 2006.¹¹⁶

Fushë Kosova është theksuar gjithashtu si komunë në të cilën marrëdhëniet ndëretnike janë pozitive, një komunitet i integruar në të cilin "gjithçka mund të zgjidhet".¹¹⁷ Këtu, bashkësitë shqiptare

dhe serbe punojnë në partneritet kundër krimit, si dhe në afarizëm,¹¹⁸ ndërsa incidentet etnike kanë rënë. Edhe pse ka pasur "incidente potencialisht etnike" të raportuara më 2005, ky numër ka rënë në 2 më 2006 dhe zero më 2007. E njëjta gjë mund të thuhet për Gjakovë: numri i incidenteve të tilla ka rënë nga 17 më 2005 në 0 në vitet 2006 dhe 2007. Një nga të anketuarit në Gjakovë gjithashtu theksoi pozitivitetin e rritur të raporteve mes shqiptarëve dhe ashkalive, ndërsa thoshte për ndërveprimin mes shqiptarëve dhe bashkësisë serbe: "Mendoj që raportet janë më të mira tani: po punojmë së bashku për një të ardhme më të mirë".¹¹⁹

4.1.3 Përfshirja sociale në projektet me elemente ndëretnike

Përfshirja sociale në projektet me ndikim ndëretnik ka qenë e shkëlqyeshme. Tanimë është përcaktuar se komunitetet e ndryshme kanë punuar së bashku, për shembull, në projekte mjedisore,¹²⁰ por edhe përfshirja e individëve në iniciativat me synim specifik në rritjen e komunikimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme ka qenë e mirë (shih më lart). Gatishmëria publike për t'u përfshirë, e cila kishte përcjellë disa iniciativa të EVSB-së, siç janë projekti 'Ura e Integrit' në Vushtrri dhe heqja e pengesave në Kamenicë, ka treguar prirje të vërtetë drejt dialogut etnik. Si e tillë, kjo përfshirje duhet të kultivohet dhe zhvillohet.

113 Shqiptar, Përfaqësues Komunal/Anëtar i EVSB-së (Istog), Vushtrri, 28 maj 2008.

114 Ish anëtar i Programit EVSB, Vushtrri, 28 maj 2008.

115 Boshnjak, Zëvendës Kryetar i Kuvendit të Komunës, Dragash, 14 qershor 2007.

116 Statistikat zyrtare të SHPK-së.

117 Shqiptar, Kryetar i Kuvendit të Komunës, Fushë Kosovë, 17 maj 2007.

118 Shqiptar, Zëvendës Kryetar i Kuvendit të Komunës, Fushë Kosovë, 17 maj 2007.

119 Shqiptar, Gjakovë, 10 shtator 2007.

120 Shih pjesën 3.2.



FËMIJËT NË FUSHË KOSOVË DUKE MARRË
PJESË NË INICIATIVËN 'TOLERANCA DHE
BASHKËJETESA'

4.1.4 Përfshirja e të rinjve dhe ndikimi në ta

Është me rëndësi të jashtëzakonshme që të rinjtë të angazhohen në komunikim ndëretnik, duke parë se afro gjysma e popullatës së Kosovës është nën moshën 25 vjeçe.¹²¹ Siç ka theksuar një përfaqësues i OJQ-ve, shpeshherë janë "fëmijët [ata] që të parët kuptojnë se duhet të ketë bashkëpunim të mirë me komunitetet tjera".¹²² Meqë të rinjtë e Kosovës janë e ardhmja e saj, duhet të krijohen marrëdhënie pozitive në mes të fëmijëve të komuniteteve të ndryshme. Është inkurajues fakti që disa iniciativa të EVSB-së kanë qenë drejtpërdrejtë të synuara në lehtësimin e ndërveprimit ndërmjet fëmijëve të komuniteteve të ndryshme, siç janë 'kampet rinore shumëtnike', që është shtjelluar në më shumë hollësi në pjesën 4.1.1. Po ashtu, projekte tjera me ndikim të mundshëm ndëretnik, siç janë projektet për siguri në komunikacion, kanë qenë të shënjestruara për të rinjtë. Ndonëse ndikimi që mund të ketë ngjarë do të bëhet më i dukshëm në kuptim afatgjatë (për shembull, rritja e bashkëpunimit ndërmjet gjeneratave të ardhshme të rritura), pjesëmarrësit e rinj në projektet e EVSB-ve kanë mirëpritur kontaktin e shtuar me fëmijët e grupeve tjera etnike. Për shembull, një nxënës foli mbi përfshirjen e tij në iniciativa të ndryshme për sigurinë

në komunikacion dhe iniciativa sportive të organizuara nga EVSB-ja dhe ShPK-ja në Shtërpcë ku morën pjesë fëmijë shqiptarë dhe serbë. Ai theksoi se ndonëse nuk kishte fare kontakt me pjesëmarrës serbë, kjo ndodhi për shkak të pengesave gjuhësore; përndryshe ai "nuk do të kishte fare problem që të bisedojë me ta".¹²³

Veç kësaj, janë organizuar turne shumëtnike të futbollit në Dragash. EVSB-ja në Fushë Kosovë ka punuar, në bashkëpunim me Departamentin e MB-së për zhvillim ndërkombëtar, ShPK-në dhe Misionin e OSBE-së në Kosovë, në organizimin e garës për posterin më të mirë në temën 'Toleranca dhe bashkëjetesa' në një shkollë fillore lokale. Kjo ngjarje kishte pjesëmarrjen e fëmijëve shqiptarë, serbë dhe ashkali dhe shërbeu për të theksuar nevojën për marrëdhënie të mira ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

Fëmijët shqiptarë, serbë dhe romë në një shkollë shumëtnike në Rahovec morën pjesë në programe këmbimi me shkollat tjera, si dhe morën pjesën në programe dhe aktivitete të përbashkëta si ndërtimi i rrethojës përreth shkollës. EVSB-të luajnë rol të rëndësishëm në këtë drejtim, duke lehtësuar kontakte dhe duke ofruar masa tjera përkrahëse.¹²⁴ Është me rëndësi që EVSB-të të vazhdojnë të punojnë me shkolla për të kërkuar mënyra për të krijuar partneritete ndërmjet fëmijëve me prapavija të ndryshme, posaçërisht duke pasur parasysh hulumtimin e vitit

121 Shih UNDP Kosovë, Rinia: Një gjeneratë e re për një Kosovë të re Kosovo (Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2006) (2006). Në dispozicion në: http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/hdr_eng.pdf

122 Serbe, Përfaqësues e OJQ-ve (Kamenicë), Vushtrri, 28 maj 2008.

123 Shqiptar, nxënës në shkollë fillore, Shtërpcë, 12 qershor 2007.

124 Serb, Drejtor shkolle, Rahovec, 18 shtator 2007.

2006 që sugjeronte se 25% të rinj serbë e kundërshtojnë idenë e krijimit të miqësisë me shqiptarë dhe 62% shqiptarë të rinj janë kundër krijimit të miqësisë me serbë.¹²⁵ Integrimi i plotë i të gjitha komuniteteve është i domosdoshëm si për zhvillimin ashtu dhe për qëndrueshmërinë dhe kjo është një drejtim në të cilin EVSB-të mund të vazhdojnë të punojnë, përmes përfshirjes së tyre me të rinjtë e Kosovës.

4.1.5 Partneritetet dhe zgjidhja e problemeve.

Siç është dëshmuar në tërë këtë pjesë, EVSB-të kanë punuar në partneritete jo vetëm me banorët lokalë, por me institucione të ndryshme, veçanërisht me Kuvendet Komunale dhe ShPK-në, në mënyrë që të lidhen komunitetet dhe të rriten nivelet e sigurisë, rendit, bashkëpunimit dhe partneritetit. Krahas këtyre shembujve ditorë të bashkëpunimit për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në komunat e Kosovës, ka pasur edhe raste kur bartësit kanë kërkuar përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike me iniciativa vetanake. Për shembull, njësia e ShPK-së në Kamenicë ka iniciuar hapjen e tregut 'shumetnik' në vitin 2000, dhe ndonëse besimi në suksesin e tij ishte fillimisht i vogël,¹²⁶ tregu tani funksionon mirë, me kushte përgjithësisht të favorshme për tregti.¹²⁷ Veç kësaj,

Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) kanë hapur një zyre në lagjen e ashkalive në Vushtrri pas dhunës së marsit të 2004.¹²⁸ Njësitë e ShPK-së në Klinë kryejnë vizita ditore në fshatrat e banuara me serbë në mënyrë që të ofrojnë çfarëdolloj ndihme që mund të kërkohej,¹²⁹ dhe niveli i mirë i bashkëpunimit ndërmjet udhëheqësisë së komunës së Fushë Kosovës dhe ShPK-së ka kontribuar në rritje të lirisë së lëvizjes për banorët ashkali.¹³⁰

Krahas të qenit i domosdoshëm për arritjen e objektivave afatshkurte të projekteve të caktuar, është vërejtur se kjo qasje bashkëpunuese e zgjidhjes së problemeve mund të ketë ndikim pozitiv në nivelet e besimit dhe partneritetit ndëretnik që janë të domosdoshme për përmirësimin afatgjatë në këtë çështje.

4.2 Marrëdhëniet Bashkësi – ShPK

ShPK-ja është themeluar në vitin 1999 dhe që atëherë është rritur në një shërbim prej mbi 7000 pjesëtarë. Meqë EVSB-të janë "mekanizëm përmes së cilit zbatohet filozofia e policisë së komunitetit",¹³¹ përfshirja e ShPK-së në program është e lartë, me nga disa policë të pranishëm në çdo EVSB, duke rritur në mënyrë të drejtpërdrejtë nivelin e kontaktit ndërmjet policëve të ShPK-së dhe pjesëtarëve

125 UNDP Kosovë, Rin ia: Një gjeneratë e re për një Kosovë të re Kosovo (Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2006) (f. 25). Në dispozicion në: http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/hdr_eng.pdf

126 Serb, Polic i ShPK-së, Kamenicë, 5 qershor 2007.

127 Serb, Kamenicë, 5 qershor 2007.

128 Polic i ShPK-së/pjesëtar i EVSB, Vushtrri, 13 gusht 2007.

129 Shqiptar, Polic i ShPK-së, Klinë, 10 shtator 2007.

130 Ashkali, Nënkryetar i Komunës, Fushë Kosovë, 17 maj 2007.

131 Ish pjesëtar i stafit të programit EVSB, Vushtrri, 28 maj 2008.

të komunitetit. Trajnimi që pranuan policët e ShPK-së i dha atyre aftësitë e nevojshme për të punuar bashkërisht me komunitetin dhe të zbatojnë parimet e policisë së komunitetit.¹³² Pavarësisht sfidave të lidhura me vlerësimin e saktë të ndryshimeve të marrëdhënieve ndërmjet ShPK-së dhe publikut të përgjithshëm, mund të shihet se ky fokus në integrimin e komuniteteve dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit bashkërisht në procesin e zgjidhjes së problemeve ka rezultuar në disa zhvillime pozitive. Si e tillë, marrëdhënia në mes të policëve të ShPK-së dhe komuniteteve ku ata shërbejnë ishte zgjedhur si fokus i këtij hulumtimi.

4.2.1 Koncepti i veprimeve policore në bashkësi

Motivimi prapa veprimeve policore në komunitete, por edhe vetë programit të EVSB-ve, ishte lehtësimi i marrëdhënieve bashkëpunuese dhe të besueshme ndërmjet policëve të ShPK-së, zyrtarëve komunalë dhe udhëheqësve/përfaqësuesve të komunitetit. Bazuar në filozofinë “populli është polici dhe policia është popull”, veprimet policore në komunitet në Kosovë synojnë të afrojnë së bashku bartës të ndryshëm në mënyrë që të adresojnë probleme të krimit, sigurisë, rendit dhe jetesës. Kështu, banorët janë drejtpërdrejtë të përfshirë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në trajtimin e këtyre çështjeve në partneritet me autoritetet lokale. Në këtë mënyrë, zyrtari policor

i komunitetit funksionon si zyrtar për qasje dhe kontaktim me publikun, duke ofruar një lidhje në mes të komunitetit dhe institucioneve publike. Si strategji filozofike dhe organizative, veprimet policore në komunitet luajnë rol të vlefshëm në shumë vende të ndryshme. Në Kosovë, ajo ka ndihmuar njerëzit që të rikthejnë besimin në policinë e tyre si dhe ka fuqizuar pjesëtarët e komunitetit dhe policinë. Në baza ditore, EVSB-të ndërveprojnë me policinë në komunitet.

Kur janë pyetur se çfarë domethënie ka policia në komunitet për ta, policët e ShPK-së që u intervistuan u përqendruan në krijimin e marrëdhënieve të besueshme dhe të qëndrueshme me komunitetin dhe punën në partneritet me të gjithë bartësit në Kosovë në identifikimin dhe adresimin e problemeve me të cilat përballen njerëzit në baza ditore. Në këtë mënyrë, policia në komunitet funksionon si “urë e cila lidhë banorët me të gjitha institucionet”¹³³; ajo krijon një mjedis në të cilin njerëzit mund të “kenë besim dhe të bashkëpunojnë me policinë”¹³⁴ në mënyrë që të “zgjidhin problemet e tyre së bashku”.¹³⁵ Pjesëtarët e EVSB-ve e vështronin policinë në komunitet me të njëjtin sy, duke theksuar nevojën për zyrtarë policorë që komunikojnë rregullisht me banorët, jo vetëm duke iu përgjigjur krimit. Përfitimet e “bashkëpunimit të afërt”¹³⁶ ndërmjet ShPK-së dhe komunitetit, një lloj “dere e hapur për të adresuar

133 Shqiptar, Polic i ShPK-së, Viti, 10 maj 2007.

134 Shqiptar, Polic i ShPK-së, Gjakovë, 10 shtator 2007.

135 Serb, Polic i ShPK-së, Kamenicë, 5 qershor 2007.

136 Ashkali, pjesëtar i EVSB (Lipjan), Vushtrri, 28 maj 2008.

132 Ish pjesëtar i stafit të programit EVSB, Vushtrri, 28 maj 2008.



nevojat e banorëve”,¹³⁷ janë theksuar nga disa pjesëtarë të EVSB-ve. Një pjesëtar i EVSB-së dhe një polic i ShPK-së kanë theksuar vleftën e të marrit kohë për të biseduar me pjesëtarët e komunitetit, dhe nëse ata nuk janë në gjendje të ofrojnë asistencë praktike.¹³⁸ Kjo pasqyron përparimin e shkëlqyeshëm të bërë që nga viti 1999, kur koncepti i policisë në komunitet u paraqit në Kosovë.¹³⁹

Ndonëse është koncept relativisht i ri në Kosovë, të gjithë policët e ShPK-së që morën pjesë në këtë hulumtim zotëronin një shkallë të lartë të besimit në aftësinë e qasjes së policisë në komunitet për të përmirësuar partneritetet ndërmjet bartësve të ndryshëm. Mbi tri të katërtat e policëve të ShPK-së të intervistuar mendonin se kjo filozofi ka shumë për të kontribuar në zvogëlimin e krimit dhe të përmirësimit të rendit, sigurinë dhe mënyrën e jetesës. Nëse do të arrihen rezultate të qëndrueshme, është me rëndësi të ketë zotim të vendosur, të përqendruar dhe afatgjatë në integrimin e veprimeve policore në komunitete në thelb të punës së ShPK-së. Ndonëse gjysma e komandantëve të stacioneve policore dhe zyrtarëve policorë të komunitetit të intervistuar mendonin se zotimi i ShPK-së në konceptin e policisë në komunitet ishte i ‘shkëlqyeshëm’, 20% të tyre theksonin se ai ishte ‘i mirë’, një pakicë e konsiderueshme (20%) mendonin se niveli

i zotimit në këtë çështje është ‘i dobët’. Duhet theksuar se ShPK-ja akoma ka çka të bëjë në mënyrë që të ‘rafinojë aftësinë e saj për të zbatuar polici në komunitet’¹⁴⁰ dhe që tërësisht të realizojë zbatim praktik të strategjisë së saj organizative është thelbësor. Synimi, në thelb, është të ketë shërbim ku në vendin e ‘njësive të policisë në komunitet’, çdo pjesëtar i ShPK-së ndihet si pjesë e komunitetit”,¹⁴¹ gjegjësisht, ku koncepti i policisë në komunitet është fuqimisht i ngulitur brenda kulturës së shërbimit.

4.2.2 Shqetësimet dhe çështjet kryesore të adresuara në EVSB

ShPK-ja, me të drejtë, ka zbatuar fushata të shumta të marrëdhënive me publikun në tërë Kosovën.¹⁴² Megjithatë, kanë qenë disa projekte të ndërmarra nga EVSB-të që në mënyrë eksplicite kanë synuar të përmirësojnë marrëdhëniet komunitet-ShPK. Shumë shpesh, janë hartuar projektet të iniciuara nga EVSB-të të synuara në rritjen e niveleve të sigurisë në trafik,¹⁴³ përmirësimin e standardeve mjedisore¹⁴⁴ dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndëretnik¹⁴⁵ dhe/ose të njëjtat janë zbatuar në bashkëpunim me ShPK-në, duke përmirësuar në këtë mënyrë marrëdhëniet komunitet – ShPK.

137 Shqiptar, pjesëtar i EVSB (Kamenicë), Vushtrri, 28 maj 2008.

138 Serb, Polic i ShPK-së/pjesëtar i EVSB (Shtërpçë), Vushtrri, 28 maj 2008.

139 Shqiptar, Polic i ShPK-së/pjesëtar i EVSB (Lipjan), Vushtrri, 28 maj 2008.

140 Ish pjesëtar i stafit të programit EVSB, Vushtrri, 28 maj 2008.

141 Shqiptar, ShPK Komandant stacioni, Fushë Kosovë, 17 maj 2007.

142 Çdo rajon i ShPK-së ka zyra të veta përgjegjëse për fushata informuese. Zëdhënës në ShPK, 20 maj 2008.

143 Shih pjesën 3.1.

144 Shih pjesën 3.2.

145 Shih pjesën 4.1.

Veç kësaj, EVSB-të dhe ShPK-ja kanë punuar së bashku në zbatimin e projekteve që synojnë adresimin e dhunës në familje, problemeve të të pastrehëve, çështjeve delikuentës dhe keqpërdorimit të drogës në shkolla, ngritja e vetëdijes mbi minat, mes tjerash – të gjitha këto shqetësime që kërkojnë asistencën dhe përfitimin e komunitetit të gjerë. Si rrjedhojë e këtyre projekteve, që domosdoshmërisht kanë përfshirë kontaktin e shtuar ndërmjet ShPK-së dhe banorëve të Kosovës, shumë të intervistuar kanë theksuar një përmirësim në marrëdhënien ndërmjet ShPK-së dhe publikut, shoqëruar me një shkallë të ngritur të bashkëpunimit dhe besimit. Siç theksoi një kryetar komune, për shkak të faktit se EVSB-të punojnë në mënyrë proaktive në komunitete, dhe në këtë mënyrë afrojnë ShPK-në dhe komunitetet së bashku, “EVSB-të kanë ndihmuar në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet publikut dhe ShPK-së ... dhe [nivele] i besimit në ShPK-në është rritur”.¹⁴⁶ Kjo shpeshherë është shtyrë përpara përmes vizitave të përbashkëta EVSB-ShPK në fshatra të ndryshëm¹⁴⁷ dhe takimeve të rregullta të komunitetit, që synojnë të rrisin kontaktin ditor me policët e ShPK-së dhe besimin në punën që kryen ShPK-ja, duke inkurajuar bashkëpunimin dhe partneritetin e ardhshëm.

4.2.3 Pikëpamjet e bashkësisë për ShPK-në

Para vitit 1999, policia në Kosovë kishte një histori të përdorimit të masave shtypëse

¹⁴⁶ Shqiptar, Kryetar i Komunës, Viti,

¹⁴⁷ Për shembull, in Kaçanik (Shqiptar, pjesëtar i EVSB, Kaçanik, 08 maj 2007) dhe Dragash (Goran, pjesëtar i EVSB, Dragash, 14 qershor 2007).

ndaj popullatës. Prandaj, bashkëpunimi me policinë në Kosovë për një kohë të gjatë është parë si problematik: siç tha një pjesëtar i EVSB-së, “nëse ne kontaktonim policinë [në të kaluarën], komuniteti na shikonte sikur të ishim tradhtar”.¹⁴⁸ Megjithatë, meqë ShPK-ja u bë më e përfshirë në jetët ditore të banorëve, si përmes njësive të policisë në komunitet ashtu dhe me përfshirjen e tyre në EVSB, ka filluar të dalë një ndjenjë e besimit në zbatimin e ligjit, ku banorët kanë fituar ndjenjën se ShPK-ja “është institucion që i ndihmon dhe mbanë ata të sigurt”.¹⁴⁹ Kjo është pasqyruar në perceptimin e atyre që morën pjesë në këtë hulumtim se komunitetet e tyre janë duke u bërë më të sigurta: shumica e të anketuarve (66%) konsiderojnë se nivelet e krimit kanë rënë në lagjet e tyre nga mesi 2006 deri në mesin e 2007. Ndonëse statistikave zyrtare të ShPK-së tregojnë ajo situatë vlen vetëm për nëntë nga 16 komunat e përfshira në programin e EVSB-së,¹⁵⁰ (këto nivele janë rritur në shtatë komunat tjera nga 2006 në 2007), duhet të përkujtojmë se nivelet e krimit të raportuar nuk do të thotë se pasqyrojnë realitetin, ku përqindja e raportimit të krimeve të kryera ndryshon nga viti në vit. Në të vërtetë, tendenca në rritje drejt dialogut ShPK-komunitet mund të ketë pasur efekt në inkurajimin e njerëzve që të raportojnë krimet në polici. Një pjesëtar i EVSB-së dhe një polic i ShPK-së theksuan se individët


¹⁴⁸ Shqiptar, Polic i ShPK-së/pjesëtar i EVSB (Lipjan), Vushtrri, 28 maj 2008.

¹⁴⁹ Shqiptar, Nënkyetar i Komunës, Dragash, 14 qershor 2007.

¹⁵⁰ Gjakovë, Istog, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Prizren, Rahovec, Shtërpcë dhe Viti. Statistikat zyrtare të ShPK-së të siguruara në mars 2008.

shpeshherë kontaktonin policinë para se të jetë kryer ndonjë krim dhe një Kryetar Komune mendonte se vetë prania e EVSB-së efektive në komunitet mund të jetë në gjendje të kontribuojë në zvogëlimin e

madhe të besimit në policinë.¹⁵² Rezultatet ndryshonin sipas përkatësisë etnike të të anketuarve, ndonëse, shqiptarët ishin më me gjasë të kenë nivel më të lartë të besimit në ShPK sesa të anketuarit serbë.



krimit.¹⁵¹ Ndonëse është vështirë të matet se sa të suksesshëm janë EVSB-të në përpjekjet e tyre për të parandaluar krimin, perceptimi i rritjes së sigurisë që duket se tregohet në këtë hulumtim është i mirëpritur.

Ndjenja e shtuar e sigurisë e përshkruar nga të intervistuarit gjatë këtij hulumtimi është plotësuar me nivelet e larta të besimit dhe bindjes në ShPK-në. Ekipi hulumtues ka pyetur disa njerëz mbi nivelin e besimit dhe bindjes që ata kishin në ShPK-në, në ruajtjen e rendit dhe ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave individuale. Rezultatet ishin inkurajuese, ku shumica e të anketuarve theksonin se kishin besim 'të madh' apo 'të mjaftueshëm' në ShPK-në. Një Nënkyetar komune theksoi se bashkëpunimi i rritur ndërmjet ShPK-së dhe autoriteteve komunale i ka mundësuar ata që të zhvillojnë një ndjenjë më të

Figura 12: çfarë niveli të besimit keni në ShPK-në? (I ndarë sipas përkatësisë etnike) (baza Nr = 64)

Këto gjetje përkrahen edhe nga hulumtimet tjera, të cilat tregojnë se ka nivel të gjerë të besimit publik në ShPK-në, ndonëse kjo është mjaft e kufizuar te popullata serbe,¹⁵³ e cila është më pak optimiste gjatë vlerësimit të marrëdhënieve ShPK-komunitet.¹⁵⁴

152 Nënkyetar i Komunës, Dragash, 14 qershor 2007.

153 Shih, për shembull, Saferworld dhe FIQ, Kosova në udhëkryq: Perceptimet e konfliktit, qasja në drejtësi dhe mundësitë për paqe në Kosovë (dhjetor 2007), f. 11-12. Në dispozicion në:

<http://www.saferworld.org.uk/images/pubdocs/SafePlace%20Conflict%20Analysis%202020Report%2020071202%200English.pdf>

154 Shih UNDP Kosovë, Raport i Paralajmërimit të Hershëm Nr. 18 (tetor 2007), f. 39-40. Në dispozicion në: http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/EWR_eng.pdf dhe UNDP Kosovë Raport i Paralajmërimit të Hershëm Nr. 17 (prill-qershor 2007), f. 45-46.

Në dispozicion në: http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/EWR17_eng.pdf

151 Kryetar i Komunës, Fushë Kosovë, 17 maj 2007.

Veç kësaj, të intervistuarit ishin optimist mbi kapacitetin e ShPK-së për të ruajtur rendin dhe ligjin në Kosovë. Pesëdhjetegjashtë për qind (56%) të të anketuarve raportuan se kishin besim të madh në këto aspekte të përgjegjësive të ShPK-së, ndërsa vetëm 6% theksuan se kishin pak besim në ShPK-në, apo nuk kanë fare. Kur janë pyetur mbi nivelin e besimit në ShPK-në për mbrojtjen e të drejtave të tyre, të anketuarit dhanë përgjigje të ngjashme. Shumica e shqiptarëve të intervistuar thanë se kishin nivel të madh (69%) apo të mjaftueshëm (24%) të besimit në ShPK-në për t'i kryer këto funksione. Vetëm 4% raportuan nivele të ulëta të besimit. Të anketuarit serbë, po ashtu, ishin pozitivë, ku shumica e tyre raportonin se ata besonin shumë apo në masë të mjaftueshme në ShPK-në. Kjo është mjaft befalshme sepse hulumtimet e kryera nga organizata tjera në mënyrë konsistente tregojnë se komunat me shumicë serbe kishin rezultate që tregojnë në nivel të ulët të besimit në ShPK-në.¹⁵⁵ Ndonëse rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë një imazh më të favorshëm të besimit të serbëve në ShPK-në sesa në studimet tjera, hulumtimi për këtë raport ka përfshirë njerëzit që drejtpërsëdrejti janë të përfshirë, apo janë përfitues të programit EVSB, që do të thotë, individë që kanë kontakt të rritur me ShPK-në. Në këtë mënyrë, ky këndvështrim optimist mund të konsiderohet si tregues i komunikimit të përmirësuar, përfshirë atë ndëretnik, të arritur përmes programit të

155 Për shembull, shih Saferworld dhe FIQ, Policia në Kosovë (shkurt 2008), f. 11-15. Në dispozicion në: <http://www.saferworld.org.uk/images/pubdocs/English.pdf>

EVSB-ve dhe pjesëmarrjes së ShPK-së në projekte.¹⁵⁶

Rezultatet pozitive të gjetura nga hulumtimi përforcohen me gjetjet se shumica e të intervistuarve mendojnë se ShPK-ja ka ofruar nivel të 'shkëlqyeshëm' (14%) apo të 'mirë' (64%) të shërbimit për banorët e Kosovës. Vetëm 2% mendojnë se shërbimi ka qenë i 'dobët', ndërsa 13% mendojnë se është i 'duhur'. Kur janë pyetur për lagjet e tyre në veçanti, të anketuarit ishin edhe më pozitivë, me 38% dhe 47% që mendonin se ShPK-ja ka ofruar nivele të 'shkëlqyeshme' apo të 'mirë' të shërbimit, përkatësisht. Kjo përkrahet me hulumtimin e kryer nga UNDP-ja në Kosovë, e cila ka zbuluar se nivelet mbi mendimin pozitiv me ShPK-në janë veçanërisht të larta te popullata shqiptare, ndonëse shumë më të ulëta te të anketuarit serbë.¹⁵⁷

Të intervistuarit, kishin mendime pozitive për sa i përket rolit që ShPK-ja ka luajtur në shpërndarjen e informatave, ku shumica e të anketuarve kanë theksuar se mendojnë se ShPK-ja kryen një punë të 'shkëlqyeshme' (14%) apo të 'mirë' (64%) në këtë lëmi. Vetëm 2% mendojnë se ky aspekt i punës së ShPK-së është i 'dobët'. Të anketuarit, po ashtu, mendojnë se ShPK-ja ka qenë e suksesshme në këtë rol në nivel të lokalizuar, ndërsa 20% dhe 52%

156 Është gjithashtu e rëndësishme të theksojmë se mostra e këtij hulumtimi ishte mjaft e vogël dhe rezultatet nuk mund të konsiderohen si përfaqësuese të Kosovës si tërësi. Megjithatë, siç u shtjellua në pjesën 1, nuk ka qenë synim i hulumtimit të jetë 'anketë publike' përfaqësuese.

157 UNDP Kosovë, Raport i Paralajmërimit të Hershëm Nr. 18 (tetor 2008), f. 39. Në dispozicion në: http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/EWR_eng.pdf

mendojnë se shkëmbimi i informatave është inw standard të 'shkëlqyeshëm' apo 'të mirë' përkatësisht. Roli i EVSB-ve në këmbimin e informatave është nënvizuar,¹⁵⁸ dhe pjesëmarrja e policëve të ShPK-së në takimet e komunitetit është theksuar si mjet posaçërisht i vlefshëm për këmbimin e informatave dhe partneritetin në nivelin e komunitetit.¹⁵⁹ Megjithatë, është ngritur nevoja për dhënie më të rregullt dhe ekstensive të informatave në lidhje me përparimin dhe përfundimet e rasteve penale.¹⁶⁰ Një interval kohor në radio, apo një program i veçantë televiziv që do të përqendrohej në punën e ShPK-së, ishin sugjerime si mekanizma të mundshëm për këtë gjë.¹⁶¹

Fatkeqësisht, një numër i vogël i të intervistuarve shprehën shqetësime në lidhje me profesionalizmin e disa pjesëtarëve të ShPK-së, duke shprehur mosbesimin e vazhdueshëm me të cilin një përqindje e popullatës e vështron ShPK-në. Një i anketuar shprehu mendimin se në komunitete të vogla, ku të 'gjithë e njohin njëri-tjetrin' dhe ku policët janë të 'frikësuar nga kriminelët', ShPK-ja funksionin me më pak efektivitet.¹⁶² Kjo është thënë nga një i intervistuar tjetër i cili ngrii shqetësimin se disa policë të ShPK-së nuk janë të 'kualifikuar e as

të përkushtuar''¹⁶³ dhe nga një polic i ShPK-së që aludonte se disa policë janë lidhur me vepra penale, duke turpëruar Shërbimin.¹⁶⁴ Pavarësisht nëse kjo është e vërtetë apo jo, perceptimi se ShPK-ja nuk mund të besohet, që vazhdon të ekzistojë te disa individë, duhet të adresohet. Përfshirja e vazhduar e policëve të ShPK-së në aktivitetet e EVSB-ve mund të kontribuojë në zbutjen e perceptimit ashtu që aktivitetet e EVSB-së rrisin mundësinë e ndërveprimit ditor ndërmjet policëve të ShPK-së dhe popullatës.

4.2.4 Përfshirja Sociale në marrëdhëniet ShPK-bashkësi

Meqë EVSB-të nuk kanë zbatuar asnjë projekt që drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë synonin përmirësimin e marrëdhënieve ShPK-komunitet, niveli i përfshirjes sociale në këtë fushë vështirë vlerësohet. Megjithatë, niveli i lartë i të punuarit të banorëve të të gjitha 16 komunave bashkë me policët e ShPK-së gjatë pjesëmarrjes në projekte të ndryshme të EVSB-ve vërehet lehtë dhe është shtjelluar në hollësi në pjesën 3. Nevoja për përkrahje të popullit për ShPK-në dhe të gjitha aktivitetet e saj është theksuar nga përfaqësuesi i Kuvendit Komunal në Novobërdë, i cili mendon se sukcesi përfundimtar varet nga bashkëpunimi dhe përkrahja e komunitetit, meqë "aq shumë raste janë zgjidhur në bashkëpunim ndërmjet komunitetit dhe ShPK-së".¹⁶⁵

158 Shqiptar, Polic i ShPK-së, Prizren, 4 shtator 2007.

159 Serb, Shtërpcë, 12 qershor 2007.

160 Shqiptar, Nënkyetar i Komunës, Dragash, 14 qershor 2007.

161 Goran, pjesëtar i EVSB, Dragash, 14 qershor 2007 dhe Nënkyetar i Komunës, Dragash, 14 qershor 2007.

162 Shqiptar, punonjës i shkollës fillore, Dragash, 14 qershor 2007.

163 Shqiptar, pjesëtar i EVSB, Kamenicë, 5 qershor 2007.

164 Polic i ShPK-së, Leposavić/Leposaviq, 24 maj 2007.

165 Serb, Përfaqësuesi i Kuvendit Komunal, Novobërdë, 7 qershor 2007.



POLICËT E SHPK-SË DHE PJESËTARËT E EVSB-SË DUKE PËRKRAHUR FËMIJËT NË KRIJIMIN E VIZIONIT TË TYRE PËR NJË 'BASHKËSI PERFECTË' NË KAÇANIK

4.2.5 Përfshirja e të rinjve dhe ndikimi në ta.

Besimi ndërmjet rinisë së Kosovës dhe ShPK-së është i domosdoshëm për zhvillimin afatgjatë të marrëdhënieve bashkëpunuese ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit dhe publikut, dhe prandaj, çdo ndikim që EVSB-të mund të kenë në këtë fushë është inkurajues. Niveli i pjesëmarrjes së rinisë në projektet e zbatuara nga EVSB-të është shtjelluar në hollësi në pjesët 3.1.4, 3.2.4 dhe 4.1.4, dhe ka zbuluar se përfshirja e ShPK-së në këto projekte ka kontribuar jo vetëm në ngritjen e vetëdijes mbi komunikacionin dhe çështjet mjedisore të fëmijët, por edhe se mund të përmirësojë të kuptuarit e rolit dhe qëllimit të ShPK-së për rininë kosovare dhe për qasjen e shtuar që ata e kanë në ShPK.¹⁶⁶

Për shembull, policët e ShPK-së, shpeshherë në bashkëpunim me EVSB-të, kanë punuar në shkolla në shumicën e komunave të EVSB-ve, duke ofruar ligjërata mbi sigurinë në komunikacion, vetëdijesim për droga, krimin dhe sigurinë, si dhe përkrahje praktike për fëmijët dhe të rinjtë që kanë punuar në projekte mjedisore (për shembull, në Shtërpçë). Veç kësaj, në Kaçanik, nxënësit e shkollës së mesme janë përfshirë në punëtori trajnuese të dizajnuar për të avancuar aftësitë e identifikimit të problemit dhe zgjidhjes së problemit dhe policët e ShPK-së kanë punuar bashkërisht me shkollat lokale dhe autoritetet komunale në zvogëlimin dhe parandalimin e krimit. Përsëri në

Kaçanik, EVSB-të lokale ndërmorën një iniciativë që synonte adresimin e problemeve me të cilat përballen fëmijët që jetojnë në rrugë, në bashkëpunim me ShPK-në lokale. Aktivitetet që janë mbajtur gjatë kampeve rinore 'Liderët e së Ardhmes' (të shtjelluara në pjesën 4.1.1. më lart), kanë pasur për qëllim të fuqizojnë marrëdhëniet ndërmjet ShPK-së dhe rinisë. Si përgjigje ndaj trazirave të marsit të vitit 2004, ata mundësuan një mjedis në të cilin pjesëmarrësit mund të mësonin mbi policinë në komunitet në mënyrë që të rrisin sigurinë në komunitetet e tyre, si dhe ndërveprim të drejtpërdrejtë me policët e ShPK-së, të cilët moderonin grupet.

Këtu më poshtë kemi disa mendime të disa studentëve dhe policëve të SHPK-së të përfshirë në implementimin e projekteve nga EVSB-të.

- *"EVSB-të kanë pasur ndikim shumë pozitiv në bashkëpunimin e pjesëmarrësve dhe SHPK-së kjo është më se e sigurt". Shqipëtar Kosovar, Kryetari i Komunës, Kaçanik, 8 Maj 2007.*
- *"Fëmijët nuk janë të frikësuar aspak nga SHPK-ja. Që nga fillimi ne u kemi mësuar se duhet respektuar SHPK-ja dhe se ata duhet të bashkëpunojnë me SHPK-në pa brengosje". Serb Kosovar, punëtor në shkollë, Shtërpçë, 12 Qeshor 2007.*
- *"Kur ne kemi vizituar stacionin e policisë kemi mësuar më tepër për sigurinë në bashkësi. Tash kemi besim dhe respekt shumë më tepër". Shqipëtare Kosovare, nxënës i shkollës fillore, Lipjan, 3 Maj 2007.*

¹⁶⁶ Shqipëtar, Kryetar i Komunës, Kaçanik, 8 maj 2007.

- *“Mësimi [siguria në trafik] e ligjëruar nga policët në bashkësi ... ka qenë e organizuar të zgjasë një orë por nxënësit kanë qenë të interesuar shumë dhe kanë parashtruar pyetje aq sa mësimi ka zgjatur dy orë. Policët në bashkësi kanë qenë të mahnitur me nxënësit”. Shqipëtar Kosovar, Drejtori i shkollës, Novobërdë, 7 Qeshor 2007.*
- *“Duke falënderuar EVSB-në këshilli i prindërve në shkollë tash ka një bashkëpunim të shkëlqyshëm me policinë. Disa të rinjë kanë qenë në trajnime në [Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim] dhe tani ata janë pjesëtarë të EVSB-së”. Ashkali Kosovar, Zavendës Kryetari i Komunës, Fushë Kosovë 17 Maj 2007.*
- *“Në fillim [mësimdhënësi]- [fëmijët] nuk kanë qenë të hapur me neve, por më vonë kanë qenë më të hapur. Ne kemi mundur të shohim se kanë një mendim krejt tjetër për SHPK-në ... pas kësaj kemi pasur shumë bashkëpunim të mirë me njësitin e policisë në bashkësi”. Shqipëtar Kosovar, polic i SHPK-së, Novobërdë, 5 Qeshor 2007.*
- *“[Vizita në shkollën policore] ka krijuar një atmosferë shumë më të mirë ndërmjet nxënësve dhe SHPK-së. Pjesëmarrja e përbashkët ndërmjet nxënësve dhe SHPK-së ka ndihmuar shumë në mendimin se policia është për njerëzit”. Shqipëtar Kosovar, Zëvendës Kryetari i Komunës, Dragash, 14 Qeshor 2007.*
- *“Bashkëpunimi ndërmjet SHPK-së dhe EVSB-së dhe bashkësisë me neve tash është më i mirë”. Shqipëtar Kosovar, Drejtori*

Shkollës, “Kuvendi i Lezhës” Shkolla e mesme, Viti, 10 Maj 2007.

4.2.6 Bashkëpunimi dhe zgjidhja e problemit

Si evidencë e gjithëmbarshme e ndikimit të diskutimeve, bashkëpunimi ndërmjet EVSB-së dhe bashkëinteresentëve, posaçërisht SHPK-së, kanë qenë vendimtare në suksesin e zhvillimit të programeve të EVSB-së. Prezenca e policëve të SHPK-së në të gjitha EVSB-të dhe pjesëmarrja e njësive në projekte ka kontribuar në rritjen e kuptimit të bashkëpunimit dhe se njerëzit mund të punojnë së bashku “si një grup me të njëjtin qëllim”.¹⁶⁷ Katërdhjetpërqind (40%) të intervistuarve të SHPK-së për këtë hulumtim mendojnë që EVSB-të kanë bërë një punë të mrekullueshme me ndihmesë në shërbim, me një deklaratë të tretë se kontributi ishte i ‘mirë’. Shumica e policëve të SHPK-së kanë theksuar vlerën e partneritetit ndërmjet dy grupeve, duke cituar një polic të SHPK-së se [pa] partnerë, është shumë vështirë të zgjidhet një problem”.¹⁶⁸ Këto lloje të bashkëpunimeve dhe rezultatet të cilat kanë treguar i kanë ndihmuar shumë bashkësive të krijojnë një besim edhe të bashkëinteresantët tjerë, midis tyre edhe SHPK-së. Siç kishte cekur njëri nga pjesëmarrësit, “njerëzit ndihen shumë më të lirë për të bashkëpunuar me SHPK-në nëse shohin bashkëpunimin e

¹⁶⁷ Shqipëtar Kosovar, Përfaqësues i Ministrisë së Qeverisë i EVSB-së, Gjakovë, 7 Shtator 2007.

¹⁶⁸ Polic i SHPK-së, Lipjan, 03 Maj 2007.



POLICËT E SHPK-SË DHE ANËTARËT E EVSB-SË DUKE PUNUAR SË BASHKU NË AFTËSITË E ZGJIDHJES SË PROBLEMIT, KAÇANIK

policëve në [projektet EVSB-së]”.¹⁶⁹ Pasi që vet policët janë pjesëmarës në EVSB-ë, ata janë të rregullt në mbledhjet ndërmjet EVSB-së dhe SHPK-së, EVSB-ja, SHPK-ja dhe autoritetet e Komunave, në çdo komunë marrin pjesë në programe. Gjithashtu me zhvillimin apo afrimin e zgjidhjes së problemit, ky afrim i gjithëmbarshtëm do të jetë shumë ndihmues në të ardhmen për fitimin e besimit në bashkësi si dhe të bashkëinteresentëve¹⁷⁰ dhe të kontribuojnë në kuptimin se zhvillimi është bërë me partnerët, më mirë të themi është bërë si një trup.¹⁷¹ Kjo është vendimtare dhe përfshin të gjithë programin e EVSB-së.

Siç është e theksuar në paragrafin 2, programi EVSB-së është i njohur për zhvillimin e anëtarëve të EVSB-së me dituri dhe aftësi në shumë sfera, përfshirë krijimin e partnerëve, shkathtësitë e komunikimit, moderimin, ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e problemit. Pjesëmarrja e policëve të SHPK-së në këto trajnime dhe me përvojën e tyre në praktikë ka ndikuar pozitivisht për adresimin e problemeve në bashkësi dhe kanë sjellë besim dhe inkurajim për rolin e tyre. Kjo qasje është e përmbledhur nga Komandanti i Stacionit Policor ku tha se “për çdo problem apo brengë që kanë [bashkësitë] ata të na drejtohen neve dhe ne do të mundohemi të gjejmë rrugën e zgjidhjes së bashku. Ne kemi kontakte të

rregullta me EVSB-të, dhe së bashku kemi arritur në zgjidhjen e shumë problemeve në bashkësinë tonë.”¹⁷²

Kjo qasje e bashkëpunimit në zgjidhjen e problemit është cekur nga disa të intervistuar. Disa nga komentet e tyre janë këtu më poshtë.

- *Unë si Polic mendoj se programi [i EVSB-së] mund të na ndihmoj shumë. Ky program përfshin shumë më shumë bashkësinë në zgjidhjen e problemeve...[dhe] me të vërtet kjo realizon komunikim ndërmjet policisë dhe bashkësisë. Aty ku është komunikimi i realizuar aty kemi edhe bashkëpunim më të mirë”.Serb Kosovar, polic i SHPK-së/anëtar i EVSB-së, Leposaviq, 29 Maj 2007.*
- *“Kemi pasur raste të huliganizmit nëpër shkollë dhe të rinjtë duke frikësuar njëri tjetrin. Ne kemi biseduar me [fëmijët] në bashkëpunim me policët e SHPK-së dhe këta të rinjtë na kanë premtuar se këto nuk do të ndodhin më përsëri. Gjithashtu në këtë kanë qenë të implikuar edhe Ministria e Arsimit, Drejtori i Shkollës , KFOR-i dhe Komuna “. Shqipëtar Kosovar, polic i SHPK-së, Kamenicë, 5 Korrik 2007.*
- *“(Me meritat EVSB-së), mardhëniet dhe bashkëpunimi ndërmjet policisë është më i mirë jo vetëm në Gjakovë por në gjithë Kosovën”.Shqipëtar Kosovar Përfaqësues i Ministrisë për Kulturë dhe Sport dhe pjesëtar i EVSB-së, Gjakovë, 7 Shtator 2007.*

169 Serb Kosovar, Polic i SHPK-së pjesëtar i EVSB-së, Shterpçë, 12 Korik 2007.

170 Shqipëtar Kosovar, Zëvendës Kryetari Komunal, Dragash, 14 Korik 2007.

171 Goran Kosovar, anëtar i EVSB-së, Dragash, 14 Korik 2007.

172 Shqipëtar Kosovar, komandant Stacioni i SHPK-së, Dragash, 14 Korik 2007.

- “Bashkëpunimi i jonë me SHPK-në është më se i mirë. Gjatë gjithë kohës kemi patrulla me automobila dhe në këmbë përgjatë kufirit dhe në fshatrat përreth, ne ndihmojmë njëri tjetrin për zgjidhjen e problemeve në situata të ndryshme si p.sh kontrabandimin e cigareve nëpërmjet kufirit”. Përfaqësi i KFOR-it, Kaçanik, 8 Maj 2007.
 - “Ne kemi përforcuar partneritetin me bashkësinë. Ata japin idetë dhe informatat. Detyra jonë tash është më efikase...është shumë më lehtë tash të parandalojmë dhe të reagojmë”. Ashkali Kosovar polic i SHPK-së, Kaçanik, 8 Maj 2007.
 - “Unë mendoj se të gjithë kemi pasur një eksperiencë të mirë gjatë punës dhe bashkëpunimit[ndërmjet veti]. Jemi njohur me kërkesat që qytetarët i kanë parashtruar policisë dhe tash qytetarët presin ndihmën kur atyre ju nevojitet. SHPK-ja gjithmonë e ka konsideruar [EVSB -në] si partner,dhe kjo ka pasur një ndikim pozitiv në punën tonë ”. Goran Kosovar, pjesëtar i EVSB-së, Dragash, 14 Korrik 2007.
 - “[Ka qenë situata e mëhershme që] njerëzit nuk kanë dashur të thërrasin policinë por kanë qenë të interesuar të lajmërojnë Komunën. Kjo tash po ndryshon. Pra tani tregoni popullatës që komuna nuk është vendi për raportim dhe adresoni te SHPK-ja . EVSB-të kanë adresuar këtë problem dhe janë mbajtur trajnime se si të raportohet”. Shqipëtar Kosovar, Kryetari Komunës, Kaçanik, 08 Maj 2007.
 - “Falënderojmë programin e EVSB-së për përmisimin e partneritetin mes komunës, SHPK-së dhe bashkësisë. Komunikimi është përmirësuar...dhe gjithashtu është rritur besimi i qytetarëve ndaj SHPK-së...dhe këtë e kanë bërë EVSB-të ”. Zëvendës Kryetari i Komunës, Dragash, 14 Korrik 2007.
 - “EVSB-të kanë ndihmuar të vendosin bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve dhe SHPK-së. Nëse ka ndonjë problem apo ka diçka të paqartë për qytetarët, EVSB-të do të organizojnë mbledhjen me SHPK-në dhe do të mundohen të ndihmojnë në zgjidhjen e problemit”. Ashkali Kosovar, Zëvendës Kryetari i Komunës, Fushë Kosovë, 17 Maj 2007.
- Megjithatë, pasi ka raste, gjithmonë është e mundshme edhe arkivimi i tyre. Gjatë diskutimit me shumicën prej të intervistuarve për rolin e SHPK-së në bashkësi si pjesë e programit të EVSB-së është pozitive, gjithashtu aty ka pasur edhe kritika që SHPK-ja ka mundur të ndihmojë edhe më shumë në implementimin e projekteve, si përkrahës dhe bashkëpunues (përfshirë dy nivelet atë të policëve dhe të komandantëve të stacionit) dhe janë vendimtar për rezultate të suksesshme të çfarëdo iniciative.¹⁷³

173 P.sh, Serb Kosovar, punëtorë i OJQ-së, Leposaviq, 29 Maj 2007.

4.3 Përfundimi

Përmirësimi i marrëdhënjeve ndëretnike nuk mundet të jetë e vetmja përgjegjësi e EVSB-së, ata luajnë një rol të rëndësishëm në bashkimin ndërmjet bashkëinteresentëve dhe bashkësisë për të punuar në një cak të përbashkët. Siç shihet, EVSB-të kanë ndërmarrë disa projekte që kanë të bëjnë drejtpërdrejt në përmirësimin e marrëdhënjeve ndëretnike në komunat e tyre dhe një numër i madh i këtyre projekteve kanë siguruar pjesëmarrjen e komuniteteve të ndryshme dhe në këtë mënyrë kanë mundësuar përmisimin e bashkëpunimit dhe partneritetin ndëretnik. Nuk është e mundur me saktësi të përcaktojmë efektin afat gjatë që kanë pasur EVSB-të në këtë sferë, por siç shihet vetë nga deklaratat e mara nga pjesëmarrësit mendimet e tyre ndryshojnë nga puna e bërë. Por me protestat të marsit 2004 dhe deklarata e Parlamentit të Kosovës për Pavarësi, 17 shkurt 2008, kanë pasur efekt në proces, por është evidente vazhdimi i procesit: është zhvilluar bashkëpunimi edhe më i madh ndërmjet bashkësive, autoriteteve dhe EVSB-të janë krijuar në shumë komuna, si dhe janë disa hapa para me bashkimin e bashkësive të ndryshme në mënyrë fizike. Por, pa dyshim ka ende hapësirë për një rritje të aktiviteteve për përmirësimin e dialogut ndëretnik, këto masa në një anë shkojnë ka normalizimi dhe bashkëpunimi funksional ndërmjet bashkësive të ndryshme në Kosovë. Si të tilla, duhet të nxiten dhe përkrahen.

Mund të shihet se SHPK-ja te pjesëmarrësit e EVSB-ve dhe përdoruesve të projekteve

ka ndikuar në zhvillimin e një imazhi pozitiv për veten e tyre që është rezultat i pjesëmarrjes së tyre në projektet e EVSB-ve që janë të fokusuara drejt ambientit, siguria në trafik dhe drejtimeve tjera që kanë të bëjnë me sigurinë në bashkësi dhe përparmit të punës me bashkësinë. Bashkëpunimi i SHPK-së në zgjidhjen e problemeve që popullata ballafaqohet, ka mundësuar një afrim dhe kontaktim më të madh ndërmjet tyre dhe një partneritet, që nëse krijohet mirë, mund edhe të mbahet . Por megjithatë mbetet ajo filozofia e punës së policisë në bashkësi duhet të mbetet në të gjithë Kosovën që në mënyrë strikte nga poshtë deri lartë të krijohet dhe të shtohet puna e policisë për sa i përket këtij procesi. Bashkësia vetëm atëherë mundet të jetë e përfshirë në tërësi në punën e policisë dhe puna e EVSB-ve mund të jetë afat-gjate dhe e dobishme. Nga kjo ekziston shpresa që zhvillimi do të vazhdoj dhe që të ndërtohet një besim edhe më i madh në punën e SHPK-së.

4.4 Rekomandimet

Marrëdhënjet Ndëretnike

- EVSB-të duhet të inkurajojnë bashkëveprimin dhe dialogun ndërmjet bashkësive në Kosovë, nëpërmjet zhvillimit dhe implementimin e projekteve të përbashkëta.
- EVSB-të duhet të vazhdojnë të identifikojnë pengesat e komunikimit ndëretnik që ekzistojnë në komunat e tyre dhe tejkalimin e këtyre pengesave me

ndihmën e Komitetit Lokal për Siguri Publike (KLSP) dhe Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

- Edhe për shkak të pengesave të mundshme në gjuhë, EVSB-të duhet të vazhdojnë me punën e tyre me organet komunale dhe shkollat lokale që me projektet e përbashkëta, të 'dyanshme', të krijojnë një partneritet ndërmjet fëmijëve dhe rinisë në bashkësi të ndryshme.

- Marrëdhënjet ndërmjet bashkësive të ndryshme duhet të janë 'jopolitike' në shikimin e retorikës politike dhe fokusimi duhet të bëhet në rritjen e komunikimit individual të përditshëm.

- Qeveria dhe organet komunale duhet të mundohen më shumë në gjetjen e përkrahjes financiare dhe ndihma të tjera praktike për projektet e EVSB-ve për qëllimin të përmisimit të marrëdhënjeve, komunikimit dhe aktiviteteve ndërmjet bashkësive të ndryshme.

Marrëdhënjet SHPK-Bashkësi

- EVSB-të duhet të vazhdojnë me ngritjen dhe konsolidimin e partneritetit përmes SHPK-së në komunat ku ata veprojnë me pjesëmarrësit e tyre të SHPK-së, në mbajtjen e diskutimeve dhe implementimin e projekteve të qëndrueshme.

- EVSB-të duhet të vazhdojnë të punojnë me SHPK-në në shkolla me fëmijët dhe të rinjtë për qëllim të mësimin për punën të cilën e bënë SHPK-ja për të vendosur besim në aktivitetet që ata ndërmarrin.

- EVSB-të dhe SHPK-ja duhet të vazhdojnë me vizitat e vendeve të populluara nga shumica apo pakicat për identifikimin e problemeve të nxënësve dhe zhvillimin e mekanizmave të zgjidhjes së problemeve, të sigurohet komunikimi i rregullt dhe bashkëpunimi me bashkësinë.

- Njësit lokale të SHPK-së kur është e nevojshme duhet të ofrojnë ndihmë në projektet e EVSB-ve.

- SHPK-ja duhet të ofroj ndihmë adekuate dhe resurse për implementimin efektiv të strategjisë së sigurisë në bashkësi.

- SHPK-ja duhet të kërkoj nga popullata këmbimin e informatave në mënyrë sistematike dhe të rregullt.

5. FUQIA, SFIDAT DHE MËSIMET E MËSUARA

Kaptinat e mëposhtme kanë analizuar projektet dhe aktivitetet e ndërmarra nga ana e EVSB-së me qëllim të vlerësimit të ndikimit që programi ka pasur në siguri dhe standard jetësor në bashkësitë ku ata jetojnë dhe veprojnë. Është treguar se ka pasur raste të suksesshme, disa më pak e disa më shumë, po megjithatë janë prekur shumë fusha. Por, duhet cekur se EVSB-të janë ballafaquar me disa sfida, si gjatë përpjekjeve në realizimin e projekteve e poashtu edhe me probleme të aspektit institucional apo organizativ. Në anën tjetër, ky paragraf ka për qëllim të vlerësoj çështjet tjera, jo të bazuara në projekt, e poashtu edhe sukseset dhe sfidat që ju bashkangjiten atyre.

5.1 Fuqitë e programit të EVSB-së

Siç është demonstruar në raport, programi i EVSB-së ka rezultuar me një përparim të dukshëm duke iu ndihmuar bashkësive në fusha të ndryshme. Janë bërë të arritura të rëndësishme sa i përket sigurisë në trafik dhe mjedis, si dhe janë përmirësuar raportet në mes të bashkësive të ndryshme, e poashtu edhe në mes të banorëve dhe pjesëtarëve të SHPK-së. Si rezultat i kësaj, siguria dhe kualiteti jetësor janë përmirësuar, e në disa raste është rritur edhe liria e lëvizjes në bashkësitë minoritare. Duke i kaluar të arrituarit e iniciativës për siguri në

bashkësi në SHBA, mbi të cilat modele është mbështetur ky program, ka një numër të ndikimeve tjera që janë të qëndrueshme dhe tej-arritëse.

5.1.1 Lidhja e bashkësisë dhe institucioneve publike

Siç është demonstruar në qasjen e tyre bazë dhe gjithpërfshirëse, EVSB-të kanë pasur sukses në bashkimin e bashkëinteresentëve të ndryshëm dhe anëtarëve të bashkësisë me qëllim të një bashkëpunimi të mirëfillt sa i përket çështjeve/brengave lidhur me sigurinë. Duke bërë një gjë të tillë, ata kanë “ndërtuar” një “urë” duke ndihmuar në krijimin e një ambienti ku anëtarët e bashkësisë ndihen më të rehatëshëm dhe më të sigurtë me, për shembull, policinë. Si pjesë e aktiviteteve të EVSB-së, pjesëtarët e bashkësisë punojnë me përfaqësuesit komunal, poashtu, si dhe me institucione ndërkombëtare dhe me ata që ofrojnë siguri, së bashku me grupet lokale të shoqërisë civile dhe udhëheqësit e bashkësisë. Komunikimi dhe bashkëpunimi ka përparuar dukshëm, si dhe është themeluar baza për bashkëpunim të mëtejshëm.

Ata të cilët janë përfshirë në EVSB-ë, si pjesëmarrës apo përfitues, vazhdimisht kanë korr sukses, me çrast edhe është krijuar kjo ‘lidhje’. Një anëtarë i EVSB-së dhe përfaqësues i Ministrisë së Qeverisë ka thënë: “ edhe pse nuk kam pritur diçka të veçantë, [është krijuar një zingjir i mirë... dhe shpresojmë se do të vazhdoj kështu”¹⁷⁴

¹⁷⁴ Shqipëtar Kosovar, anëtarë i EVSB-së/përfaqësues i Ministrisë së Qeverisë, Gjakovë 07 Shtator 2007

Komunikimi në mes të pjesëtarëve të bashkësisë dhe bashkëinteresentëve, veçanarisht policisë, poashtu kanë rezultuar me një bashkëpunim¹⁷⁵ më të mirë. Prezenca e një lidhje të tillë ka vepruar në atë mënyrë që ka siguruar një trup vendor përmes së cilës individët mund ta ngrejnë zërin mbi brengat e tyre, të jenë më të vetëdijshëm për çështjet e sigurisë si dhe të kenë rol në proceset e zgjidhjes së problemit.

5.1.2 Krijimim i raporteve të mirëfillta bashkëpunuese

Gjatë trajnimit të tyre dhe gjatë implementimit të projekteve të tyre, anëtarët e EVSB-së janë mësuar se si të zhvillojnë partneritetet dhe të punojnë së bashku si ekipe. Kjo ju mundëson atyre që të 'pajisen' me aftësi që ju nevojitet për të punuar me bashkëinteresent të ndryshëm në bashkësitë e tyre dhe përgjatë Kosovës me partnerë të ndryshëm, e poashtu edhe me njëri tjetrin. Siç është diskutuar në këtë raport, mund të thuhet se të gjitha EVSB-të kanë zhvilluar me sukses partneritetet në baza bashkëpunimi me një numër të bashkëinteresentëve me qëllim të implementimit të projekteve të tyre dhe arritjes së synimeve, e poashtu të theksojnë idenë që problemi i bashkësisë i takon secilit, prandaj njerëzit duhet të bashkëpunojnë që ta gjejnë zgjidhjen.¹⁷⁶ Kjo është një arritje e madhe dhe mund të thuhet që i ka "tejkalluar" të priturat e programit dhe të pjesëmarrësve.¹⁷⁷ Fillimisht ka pasur

175 Serb Kosovar, pjesëtarë i SHPK-së/anëtarë i EVSB-së, Leposaviq, 09 Gusht 2007.

176 Shqipëtarë Kosovar, anëtarë i EVSB-së/përfaqësues i Ministrisë së Qeverisë, Gjakovë, 7 Shtator 2007.

177 Ish trajnues ndërkombëtarë dhe anëtarë i tanishëm i

shqetësime se mund të jetë problematike sa i përket bashkimit të përfaqësive si nga autoritetet komunale, SHPK-së dhe bashkësisë në një forum si EVSB-ja, por sfidat që janë paraqitur gjatë asaj kohe shumë shpejt janë tejkalluar, sidomos nga individët që kanë dëshmuar "se kanë aftësi të sprovonjë veten në gjëra të reja, të punojnë së bashku dhe të themelojnë partneritete të reja dhe t'i fuqizojnë ato të vjetrat."¹⁷⁸ Kjo poashtu është theksuar nga ana e anëtarëve të EVSB-së, njëri prej të cilëve ka cekur se në fillim "ishte një zbrazëtitirë në mes të komunës dhe bashkësisë. Por tash ne ulemi së bashku në tryezë. Puna jonë është e strukturuar [dhe] ne të gjithë komunikojmë".¹⁷⁹

Përfaqësuesit e EVSB-së poashtu marrin pjesë në takime të rregullta të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS-të), në komunat e tyre,¹⁸⁰ gjatë të cilave takime diskutohet për çështjet e krimit dhe sigurisë nga ana e autoriteteve komunale, SHPK-së si dhe bashkëinteresentëve tjerë si vendor ashtu edhe ndërkombëtarë. Me anë të këtij forumi, çështjet/problemet janë të identifikuar dhe zgjidhjet janë të implementuara. Përkushtimi i EVSB-së, me anë të pjesëmarrjes së tyre në këto forume, paraqet rëndësi të veçantë në procesin e përgjithshëm të partneritetit, e

programit të EVSB-së, Vushtrri, 16 Qershor 2008.

178 Ish anëtarë i stafit të programit të EVSB-së, Vushtrri, 28 Maj 2008.

179 Nënpresidenti i komunës së Klinës, 10 Shtator 2007.

180 Shiqo Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54 në Kornizën dhe Parimet Udhëzuese të Shërbimit Policor të Kosovës, 20 Dhjetor 2005. e mundësuar në adresën elektronike:

http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2005regs/RE2005_54.pdf



ANËTARËT E EVSB-SË, ZYRTARË KOMUNAL, POLICË TË SHPK-SË, PËRFAQËSUES NGA KFOR-I DHE OSBE-JA, DUKE PUNUAR SË BASHKU NË KAMENICË.

së voni është rritur niveli i bashkëveprimit me anë të vendimit të Ekipit të Programit që kanë siguruar EVSB-ja të ketë së paku një anëtarë që është poashtu anëtarë i përhershëm dhe përfaqësues të EVSB-së në KKS në komunën e tyre. Për më tepër, përfaqësuesit e EVSB-së marrin pjesë në takime dhe aktivitete në grupin drejtues të policisë në bashkësi të Kosovës, së bashku me anëtarët e Ekipit të Programit, duke iu dhënë mundësinë atyre të ndikojnë në parime dhe proceset vendimarrëse të nivelit më të lartë.

Së fundi, EVSB-të jo vetëm që bashkëpunojnë me EVSB-të tjera, por janë të angazhuar në iniciativa regjionale, poashtu. Për shembull, EVSB-ja në Dragash ka ndihmuar në moderimin e takimeve të bashkësisë në Shqipëri, me qëllim që të provojnë të adresojnë aktivitetet kriminele në vijën kufitare e që është paraqitur si problem në komunë. Takimet në mënyrë direkte i kanë mundësuar komunës që të merr hapa pozitive drejt zvogëlimit të krimit, aktivitet i ndërmarë nga ana e atyre që e kalojnë kufirin e Kosovës për këtë qëllim.¹⁸¹

5.1.3 Trajnimi i EVSB-së dhe programi ndihmës

Siç është diskutuar në paragrafin 2.1, çdo anëtarë i EVSB-së merr pjesë në programin e gjërë trajnues, që ka për qëllim t'i pajis ata me shkathtësitë e duhura që ju nevojiten për këtë rol. Trajnimi është pranuar

pozitivisht nga ana e pjesëmarrësve, me një konsensus që i arrin synimet dhe me sukses i përgatit ata për rolin e tyre me "entuziazëm dhe besim se [ata] mund të ndryshojnë diçka".¹⁸² Mësimet e mësuara nga secila fazë trajnuese janë poashtu të implementuara vazhdimisht, me qëllim që të sigurohemi se secili trajnim për EVSB-të përfitojnë nga përvoja e të mëparshmeve. Për më tepër, ata që kanë marr pjesë në kursin e Trajnimit të Trajnerëve për EVSB-të, kanë theksuar se shkathtësitë e fituara kanë qenë të dobishme jo vetëm për raporte me EVSB-të, e sidomos kur kërkojnë ndihmë nga lidhshipi komunal për projektet e tyre, por edhe në komunikimin e përditshëm me anëtarët e familjes së tyre, kolegëve dhe bashkëvendasve.

Një aspekt i veçantë i programit që ka sjell sukses është trajnimi mbi zgjidhje të problemit. Pjesëmarrësit e EVSB-së kanë theksuar rëndësinë e kësaj pjese, duke cekur se gjatë trajnimit ata 'pajisen' me shkathtësi jo vetëm që të identifikojnë zgjidhjet për krimet e mundshme dhe çështjet rreth sigurisë në bashkësitë e tyre, por poashtu të njohin situatat e mundshme kritike si dhe të rrisin vetëdijen publike për çështjet e rëndësishme.¹⁸³ Anëtarët e EVSB-së kanë raportuar poashtu se ata kanë pasur sukses në aplikimin e shkathtësive për zgjidhje të problemit gjatë jetës së tyre të përditshme, si në atë personale poashtu dhe profesionale, duke paraqitur një transfer të suksesshëm të shkathtësive që i kanë fituar gjatë

181 Boshnjak Kosovar, Nënkyetari i Komunës, Dragash, 14 Qershor 2007.

182 Serb Kosovar, anëtarë i EVSB-së, Leposaviq, 09 Gusht 2007.

183 Shqipëtarë Kosovarë, Kryetar Komune në Viti, 10 Maj 2007.



programit. Kjo ka ndikim në përmasa më të gjera: përpjekjet e pjesëmarrësve të EVSB-së që të shkëmbjenë përvojat e tyre me shokë dhe familjarë, duke i tejkaluar përfitimet dhe ndikimet e programit ndaj atyre që janë të përfshirë në mënyrë direkte.

Për sukseset e programit trajnues, është me rëndësi që të vazhdohet me ndërtim të kapaciteteve vendore. Për më tepër, Ekipi i Programit po mundohet në mënyrë aktive ta implementoj këtë parim. Që nga viti 2007, trajnimi i EVSB-së administrohet plotësisht nga anëtarët e EVSB-së ekzistuese, e të cilët kanë kaluar përgjatë trajnimit të quajtur Trajnimi për Trajnerë. Katër fazat e para të EVSB-së, më 2003, 2004 dhe 2005 janë mbështetur kryesisht tek trajnerët ndërkombëtarë me qëllim të shkëmbimit të përvojës dhe ekspertizës së tyre nga SHBA-ja. Tash, megjithatë, ekspertiza më e vlefshme vjen nga vet anëtarët dhe trajnuesit e EVSB-së, pjesëmarrësit e certifikuar nga kursi Trajnimi i Trajnerëve kanë shprehur kënaqësinë duke thënë "Nuk besoj se diçka tjetër do të më ndihmonte më shumë se ky kurs, ndoshta as diploma e Universitetit",¹⁸⁴ si dhe me këtë rast sigurohemi në transferin e qëndrueshëm të shkathtësive dhe njohurive. Në anën tjetër, Ekipi i Programit për EVSB-në ka theksuar se, nëse gjërat ishin përsëritur, do të preferonin që nga fillimi të ketë më shumë trajnime të stafit lokal dhe pjesëmarrësve. Kjo fillimisht do të rriste kapacitetin vendor, do të rriste përgjegjësinë e stafit vendor për program dhe anëtarët e EVSB-së, si

dhe do të kufizonte nevojën për trajnerë ndërkombëtarë.¹⁸⁵

5.2 Sfidat e programit të EVSB-së

EVSB-të janë ballafaquar me një numër sfidash përgjatë realizimit të programit. Këto kryesisht janë të lidhura me çështjet strukturore apo logjistike dhe, sipas rastit, kanë ndikuar në mundësitë e tyre për t'i arritur qëllimet përkatëse.

5.2.1 Përkrahja financiare dhe logjistike

Njëra ndër sfidat më të mëdha me të cilat janë ballafaquar anëtarët e EVSB-së, e të cilën e kanë theksuar ata vetë, ndërlidhet me nivelin e përkrahjes financiare dhe logjistike që ata e marrin. Edhe pse secila EVSB-ë shkon përgjatë trajnimit të plotë dhe inetnziv, e gjithë kjo e përkrahur financiarisht, e poashtu edhe disa nga IT-të, zyret dhe pajisjet e trajnimit që vijnë si pjesë përkrahëse e programit, megjithatë, as Misioni i OSBE-së në Kosovë e as ICITAP-i nuk i siguron përkrahje të vazhdueshme financiare. Qëllimi është që ata të jenë më tepër trupa vetë-mbajtës dhe më të qëndrueshëm, gjithherë të pajisur me shakthtësi për të siguruar përkrahjen e nevojshme nga pala e tretë.

Ekipi i programit vazhdon të punojë për së afërmi me Kryetarët e Komunave, Komandantët e stacioneve policore/SHPK-ja, Ministrinë e Punëve të Mbrendshme dhe Grupin Drejtues të Policisë në

184 Shqipëtarë Kosovarë, anëtarë i EVSB-së dhe Trajnues i trajnuar, Vushtrri 16 Qershor 2008.

185 Ish anëtarë i stafit të programit për EVSB, Vushtrri, 28 Maj 2008.

Bashkësi për Kosovë, për tu siguruar se ata plotësisht e kuptojnë nevojën e tyre për ta përkrahur punën e e EVSB-ve me qëllim të përmirësimit të shansave për sukses përgjatë Kosovës. Megjithatë, kur janë pyetur anëtarët e EVSB-së, gjithnjë kanë cekur përkrahjen e kufizuar financiare si sfida më e madhe me të cilën ballafaqohet programi në tërësi dhe puna me të cilën ata merren. Për shembull, edhe pse autoritetet komunale kanë ofruar përkrahje për shumë projekte të EVSB-ve, mungesa e fondeve në anën tjetër ka qenë pengesë për të implementur iniciativat përkatëse të EVSB-ve, siç janë projektet për të ofruar siguri më të madhe në trafik në Dagash, Fushë Kosovë dhe Lipjan.¹⁸⁶ Pjesëmarrësit e tjerë të EVSB-së kanë shprehur shqetësimin se lidershipi i tyre Komunal kanë dështuar duke mos e marr punën e tyre me seriozitet dhe kanë ofruar përkrahje të kufizuar,¹⁸⁷ duke dështuar në njoftimin e të priturve fillestare.¹⁸⁸ Kjo është problematike. Siç ka cekur njëri nga EVSB-të: “për të gjetur vullnetarë [nuk është problem]. Problem i vetëm [janë] burimet”.¹⁸⁹ Edhe pse është i qartë sukcesi që EVSB-të e kanë arritur në implementimin e projekteve që kanë kërkuar pak apo aspak përkrahje financiare, si dhe ka shembuj të shumtë kur ata kanë kërkuar angazhim financiar nga komunat e ndryshme, bashkëinteresentë vendorë dhe ndërkombëtarë (e poashtu edhe nga

186 Nën-kryetar komune, Dragash, 14 Qershor 2007; polic i SHPK-së/anëtarë i EVSB, Fushë Kosovë; 20 Maj 2008; polic i SHPK-së/anëtarë i EVSB, Lipjan, 20 Maj 2008.

187 Boshnjake Kosovare, anëtre e EVSB-së, Obiliq, 15 Maj 2007.

188 Anëtarë i EVSB-së, Prizren, 04 Gusht 2007.

189 Serb Kosovar, anëtarë i EVSB-së, Lepsaviq, 24 Maj 2007.

bashkësitë), megjithatë është shumë e nevojshme që lidershipi Komunal të siguroj EVSB-të me një përkrahje më të qëndrueshme nga fondi i tyre bugjetor.

Kjo zgjerohet jo vetëm në implementimin e projektit, por edhe në praktikën e ditëpërditshme. Për shembull, një pjesëtarë i OJQ-së në Obiliq ka theksuar se “[EVSB-të] nuk gëzojnë kushte të duhura për punë. [EVSB-të] nuk kanë zyre...askush nuk i motivon pjesëtarët për punë.”¹⁹⁰ Kjo është një ankesë e zakonshme e pjesëtarëve të EVSB-së, si dhe është cekur nga zëvendës Kryetari i Komunës që EVSB-të kanë nevojë të pajisen me telefona dhe transport me qëllim të realizimit të suksesshëm të përgjegjësisve të tyre.¹⁹¹ Edhe pse është e qartë nga ky vlerësim si dhe kontakti i rregullt në mes të EVSB-së dhe Ekipit të Programit, se EVSB-të janë të motivuar për punë dhe zakonisht kanë ndikim në bashkësitë ku ata veprojnë, poashtu është e qartë se mungesa e përkrahjes institucionale mund të çoj drejt de-motivimit në çdo ekip, e poashtu në zvogëlimin e efikasitetit të tyre. EVSB-të janë të përforcuar nga vlerat e punës vullnetare dhe si të tillë, pjesëmarrësit nuk duhet të presin pagesë, por në anën tjetër, pjesëmarrësit nuk mundën dhe nuk duhet të shfrytëzojnë paratë e tyre me qëllim të financimit të pjesëmarrjes së tyre. Shpenzimet e përditshme që ndërliken me punën e tyre, e poashtu edhe transporti që bëhet për takime,¹⁹² duhet të kompenzohet –

190 Kosovo Albanian female, NGO employee, Obiliq/Obilić, 15 May 2007.

191 Boshnjak Kosovar, Nën-kryetar komune, Dragash 14 Qershor 2007.

192 Në disa EVSB, anëtarët shpesh janë në pamundësi për

logjikisht nga lidershipi relevant Komunal. Megjithatë, EVSB-të duhet të rrisin kapacitetin e tyre për të arritur deri tek fondet. Më mirë se të mbështeten në përkrahjen ndërkombëtare, ata duhet të identifikojnë mënyrat me të cilat sigurojnë donacione apo partneritet prej burimeve tjera. Këshilli Ekzekutiv i EVSB-së mund, poashtu të konsiderohet si trup i mundshëm që të jetë i aftë në 'joshjen' dhe sigurimin e fondeve për aktivitetet dhe ngjarjet e EVSB-së. Përfshirja e një sesioni trajnues tërësor për marrjen e fondeve, do të ishte një shtesë e rëndësishme për programin trajnues të EVSB-së si edhe trajnimi mbi zhvillimin e projket propozimeve edhe menaxhimin e projketeve, shkathtësi këto poashtu të rëndësishme për të fituar përkrahje financiare. Kjo atëherë mund ta zavendësoj dhe zgjeroj përkrahjen e tanishme që EVSB-të e gëzojnë, si dhe t'i pajis ata me shkathtësitë e duhura me qëllim që të sigurojnë përkrahjen e nevojitur financiare dhe siguri për ekipet dhe punën e tyre.

5.2.2 Komunikimi brenda EVSB-së

Disa nga anëtarët e EVSB-së kanë ngritur çështjen se, kur një grumbull njerëzish vijnë bashku, ata mund të ballafaqohen me sfida gjatë komunikimit. Edhe pse gjatë trajnimit ata pajisen me shkathtësi për zhvillim të ekipit dhe bashkëpunim, prap dallimet personale kanë ndikuar ndonjëherë në kontributin që EVSB-të mund ta japin. Për shembull, pjesëmarrësit

e EVSB-së kanë theksuar rastet kur ata kanë pasur keqkuptime dhe mospajtime gjatë gjetjes së mënyrës më të mirë për një raport të mirëfilltë në zgjidhjen e një problemi apo çështje përkatëse. Megjithatë, këta pjesëmarrës kanë cekur poashtu se me një komunikim dhe dialog më të gjërë, ata zakonisht kanë qenë në gjendje t'i tejkalojnë problemet në komunikim pa e rrezikuar qëndrueshmërinë e ekipit të tyre.¹⁹³ Ekipi i Programit vazhdon të bashkëpunoj me EVSB-të në këto çështje dhe kur është e nevojshme, të moderojnë në diskutimet e ekipeve për të gjetur bazën e përbashkët dhe për të arritur koncenzus.

Çka është më serioze, disa nga anëtarët e EVSB-së kanë raportuar dështim për një komunikim më efikas nga ana e anëtarëve më të vjetër të ekipit me pjesëmarrësit e tjerë. Mungesa e një organizimi të brendshëm mundet shumë lehtë ta pengoj funksionimin efikas të ekipit dhe pasojat e kësaj janë vërejtur gjatë Vlerësimit, kur një numër i vogël i të intervistuarve kanë qenë të papërgatitur nga fakti se nuk kanë qenë të informuar për këtë hulumtim nga ana e përfaqësuesve të tyre të Këshillit Ekzekutiv. Edhe pse diskutimet vijuese kanë siguruar se këto "zbrazëtira" janë mbuluar në fakt, kjo megjithatë demonstroi se komunikimet dhe takimet e rregullta dhe efikase janë të rëndësishme, e poashtu edhe përkushtimi dhe pjesëmarrja e plotë nga secili anëtarë i EVSB-së. Kjo çështje është ngritur më vonë disa herë nga ana e një numri të pjesëmarrësve që

të vijuar takimet për arsye të mos mbulimit të shpenzimeve në transport.

193 Shqipëtare Kosovare, staf i Programit të EVSB-së, 07 Gusht 2007.

janë ankuar në mosangazhimin aktiv në punën ekimore dhe kanë sugjeruar, se si rrjedhojë e kësaj është paraqitur nevoja të bëhet një proces i selektimit më të "rreptë" nga ana e individëve që e themelojnë një EVSB-ë. Edhe pse përkushtimi në punë i individëve shpesh nënkupton se ata janë në pamundësi të marrin pjesë në të gjitha takimet, ata të cilët kanë në plan t'i bashkangjiten ekipit duhet të sigurohen më parë se kanë mundësi ta përkushtojnë kohën e tyre në mënyrë efikase, kur është e nevojshme, me qëllim të plotësimit të detyrës së tyre. Duke mësuar nga kjo përvojë, Ekipi i Programit tani mundohet ta qartësoj rolin dhe përgjegjësinë e secilit anëtarë të EVSB-së gjatë trajnimit të tyre, si dhe ka zhvilluar trajnim njëjavor, poashtu, për "Anëtarë të ri të EVSB-së". Kjo ka për qëllim që të gjitha EVSB-të të kenë mundësi për të rekrutuar anëtarë të ri në ekipet e tyre edhe në fazat e mëvonshme, e kështu të zëvendësohen ata individë që ose nuk i plotësojnë përgjegjësitë e tyre ose nuk kanë mundësi të japin kontributin e tyre. Deri më sot, disa nga EVSB-të kanë shfrytëzuar këtë metodë me qëllim të kompletimit të ekipeve të tyre me anëtarë të ri që tregojnë motivim dhe përkushtim ndaj ekipit dhe punës së tyre.

5.3 Mësimet e mësuara dhe drejtimi i përparuar

Çështjet e theksuara nga ky Vlerësim ka ngritur një numër të mësimeve të mësuara, të cilat veç se aplikohen dhe vazhdojnë si të tilla me qëllim të shmangjes apo zvogëlimit të sfidave dhe rritjes së suksesit. Ndikimi

pozitiv që programi i EVSB-së ka pasur në siguri dhe standard jetësor për njerëzit e Kosovës nuk duhet të nënçmohet dhe, edhe pse ata vazhdojnë të zhvillohen, të rriten dhe t'i tejkalojnë pengesat, megjithatë duhet të bëhet zgjerimi i tyre në nivel të Kosovës. Nga ndikimi i qartë që EVSB-ja ka pasur në qëllime të caktuara, siç është: siguria në trafik dhe mjedisin jetësor, më pak në çështje solide si marrëdhëniet ndër-etnike dhe raportet bashkësi – SHPK, programi ka punuar poashtu në zhvillimin e shkathtësive që secili anëtarë i EVSB-së i zotëron, duke mundësuar që secili individ të përcjell dituritë e tyre tek të tjerët dhe kështu zgjeroj ndikimin e programit.

Siç është theksuar në këtë vlerësim, Ekipi i Programit të EVSB-së, ka kërkuar për identifikimin e mënyrave se si të përmirësohet programi dhe ka vendosur elemente të reja dhe aktivitete që të mundësohet kjo. Duke e zhvilluar vazhdimisht programin trajnues që të përshtatet me nevojat e bashkësive individuale, ekipi ka qenë në gjendje t'i adaptoj shkathtësitë dhe njohuritë e nevojshme për të rritur mundësitë për sukses. Për më tepër, Ekipi i Programit ka zhvilluar mekanizëm të ri që të rris bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet dhe në mes të EVSB-së si dhe të siguroj kapacitet për trajnime dhe shkathtësi të qëndrueshme. Megjithatë, takime më të shpeshta dhe/apo takime strukturore vijuese në mes të EVSB-së dhe Ekipit të Programit do të parqiste një mjet të dobishëm për zgjidhjen e sfidave të shquara në suaza kohore të caktuara dhe të rrisin suksesin, e poashtu të sigurohet se motivimi

dhe përkushtimi nga të gjithë anëtarët e ekipit janë në nivelin më të lartë.

Me qëllim që të arriturat e EVSB-së të jenë të njohura plotësisht dhe në suaza të gjëra, si dhe sfidat të adresohen në mënyrë të suksesshme, duhet të implementohet një sistem i duhur i monitorimit dhe vlerësimit. Edhe pse Ekipi i programit përmban informata lidhur me aktivitetet e EVSB-së, mekanizmi i vetëm proaktiv që ekziston momentalisht është raportimi që EVSB-të e bëjnë te Këshilli Ekzekutiv në takimet tre mujore. Të gjitha monitorimet tjera bëhen në baza të rastësisë dhe kjo mbetet si njëra ndër sfidat kryesore me të cilën ballafaqohet programi. Kjo ka rezultuar me vështirësi sa përket mbledhjes së informatave më të reja dhe gjithpërfshirëse për aktivitetet dhe projektet e EVSB-së, e poashtu për një analizë të saktë për ndonjë problem apo sfidë më të madhe. Prandaj është rekomanduar që EVSB-të të paraqesin më të rehat nga projektet e tyre dhe aktivitetet, në mënyrë të rregullt dhe me detaje, e të cilat pastaj mund të rishiqohen, vlerësohen dhe futen në arhivë. Kjo siguron një platformë më efektive për vlerësime të tanishme dhe të ardhshme të programit dhe ndikimit të tij, si dhe siguron një bazë më gjithëpërfshirëse për shkëmbim të informatave. Është sugjeruar se një mekanizëm i tillë i përcjelljes dhe monitorimit të administrohet nga Këshilli Ekzekutiv, me mbikqyrje të Ekipit të Programit, e kështu do të ipet mundësia për qëndrueshmëri më të madhe në nivel vendor, më mirë se të lidhet ky proces monitorimi me trupat ekzistues të jashtëm (ndërkombëtarë). Edhe pse kjo është diskutuar me grupet punuese brenda Këshillit Ekzekutiv, është

rekomanduar se duhet një përkushtim i madh që të relizohet kjo. Vetëm atëherë EVSB-të mund të publikojnë përpjekjet dhe sukseset e tyre: edhe pse diçka është arritur në këtë pikë përmes trajnimit për media dhe iniciativave për vetëdijësim publik, ende ka shumë punë për tu bërë.

Ekziston nevoja për përfshirje më të madhe të rinisë dhe femrave në EVSB. Edhe pse EVSB-të në përmbajtjen e tyre kanë pjesëmarrës që i takojnë rinisë dhe femra, është mirë që të përfshihen më shumë, si në EVSB ashtu dhe në projektet e tyre. Siç ka thënë një anëtarë i EVSB-së, të rinjtë sjellin “energji dhe dinamikë” për ekipin,¹⁹⁴ si dhe kontributin që ata mund ta japin është i madh. Anëtarët e Ekipit të Programit poashtu e kanë cekur këtë çështje: edhe pse përfshirja e të rinjëve ka qenë e paraparë që nga fillimi, megjithatë është e nevojshme që të rritet niveli i pjesëmarrjes së tyre, si pjesëmarrës të rregullt të EVSB-së apo si krijues të një EVSB-je vetëm me të ri.¹⁹⁵ Pjesëmarrja e femrave poashtu ka nevojë për zhvillim më të madh, edhe pse përfshirja e tyre do të përkrahej më shumë kur të arrihet një raport më i fuqishëm me liderët e bashkësisë të gjinisë mashkullore.¹⁹⁶ Organizimi i trajnimit për anëtarë të ri të EVSB-së ka ofruar një mundësi të mirë për të rinjtë dhe femrat që të kyçen në fazat e mëvonshme të zhvillimit të EVSB-së dhe kurse të tilla veç se janë organizuar në disa raste.

194 Shqipëtarë Kosovari, anëtarë i EVSB-së/Ministria e Qeverisë, Gjakovë, 7 Shtator 2007.

195 Ish anëtarë i stafit të programit të EVSB-së, Vushtrri, 28 Maj 2008.

196 Ish anëtarë i stafit të programit të EVSB-së, Vushtrri, 28 Maj 2008.

Së fundi, një çështje që duhet të adresohet, e që sipas natyrës që ka disa herë është përsëritur, ndërlidhet me “statusin” e EVSB-së. Një numër i përfaqësuesve të EVSB-së radhazi kanë parashtruar kërkesën se rolet dhe përgjegjësitë e tyre duhet të formalizohen në atë mënyrë siç është bërë edhe për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe Komitetet Lokale për Siguri Publike si psh: përmes ndonjë rregulloreje të qeverisë. Ata ndihen se me këtë do të fitonin “legjimitet” apo “autorizim” që t’i adresojnë problemet e bashkësisë, një gjë të cilën ata mendojnë se nuk e gëzojnë ende. Megjithatë, kjo qasje vepron përkundrajt filozofisë së programit që bazohet në nivelin bazë (të shoqërisë) dhe pjesëmarrës. EVSB-të kanë legjitimitet, që është krijuar me fitimin e shkathhtësive, krijimin e marrëdhënjeve dhe ndikimit që e kanë arritur si anëtarë të bashkësisë. Rregullorja mbi aktivitetet e EVSB-së, në vend se të ndihmojë në rolet e tyre, e që do të përcjell çdo “formalizim” të aktiviteteve të tyre, do të shërbejë vetëm në “kufizimin apo politizimin” në qasjen “lartë – poshtë”, e që me qëllim është shmangur në të mirë të qasjes “poshtë – lartë”.¹⁹⁷ Ekipi i Programit janë munduar vazhdimisht që të sigurohen se EVSB-të janë të lirë nga pengesat e tilla dhe është rekomanduar se ata pjesëmarrës që kërkojnë formalizim të tillë të koncentrohen në rolin kryesor dhe të pavarur të tyre, rol ky që kanë pasur synim ta arrijnë kur ju kanë bashkangjitur programit në fillim. EVSB-të janë vullnetarë, si dhe programi bazohet

në dëshirën dhe vullnetin e mirë për t’i ndihmuar bashkësisë ku ata jetojnë, duke gjetur mënyra për adresimin e brengave të tyre. Edhe pse është qenësore që qeveria plotësisht të jetë e vetëdëshme dhe përkrahëse për punën që ekipet e realizojnë, mundësitë më të mëdha për suksesin e EVSB-së mund të relalizohen plotësisht vetëm pa restriksione që mund ta bëjë rregullorja.

¹⁹⁷ Ish anëtarë i stafit të programit të EVSB-së, Vushtrri, 28 Maj 2008.

6. KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET

Ky raport paraqet vlerësimin e ndikimeve që EVSB-të kanë bërë në katër çështjet kryesore në Kosovë: siguria në trafik, siguria në mjedisin jetësor, marrëdhënjet ndër-etnike dhe marrëdhënjet bashkësi - SHPK. Të dhënat paraqesin një përparim pozitiv nga parashikimet e EVSB-së, të cilat ekipe kanë bërë ndikim të dukshëm në bashkësitë e tyre.

EVSB-të kanë bërë një përparim të shkëlqyeshëm sa i përket projekteve të sigurisë në trafik. Projektet e tyre edukative për të rinjtë kanë ndihmuar në ngritjen e vetëdijës tek të rinjtë dhe përpjekjet e tyre për të instaluar shenja trafiku dhe kalimet për këmbësorët kanë ndikuar në parakushte për të përmirësuar nivelet e tanishme të sigurisë në trafik. Megjithatë, duhet të bëhen përpjekje të mëtutjeshme për të konsoliduar dhe zhvilluar më tutje përparimet që veç se janë arritur.

EVSB-të poashtu, kanë bërë hapa të dukshëm drejt përmirësimit të kushteve në mjedis dhe standardeve në bashkësitë ku ata veprojnë. Aksionet e rregullta të ndërmarra për pastrim të mjedisit kanë ndihmuar sa i përket përmirësimit vizuel të mjedisit jetësor, e poashtu ka ndihmuar edhe në largimin e qenëve endacak – që paraqet një rrezik të madh për siguri dhe shëndet. EVSB-të kanë ndihmuar poashtu në ngritjen e vetëdijës për çështjet e mjedisit jetësor tek të rinjtë dhe popullata

në përgjithësi, si dhe të motivoj bashkësitë vendore që ta mbrojnë rrethinën e tyre.

Përmes strukturës së tyre gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse, partneritetet që ata i kanë krijuar dhe projektet që i kanë realizuar, EVSB-të poashtu kanë krijuar ndikim pozitiv në marrëdhënjet ndër-etnike në shumë bashkësi. Duke sjellur së bashku bashkësi të ndryshme për të arritur qëllimin e përbashkët, bashkëpunimi është përmirësuar në mes të individëve dhe në disa raste është rritur bashkëveprimi në baza ditore dhe liria e lëvizjes. Një numër i EVSB-ve kanë luajtur rol kyç në përmirësimin e standardit jetësor në bashkësitë jo-shqiptare, duke rritur kështu nivelin e besimit dhe bashkëpunimit.

Si rezultat i përfshirjes së tyre në projektet e EVSB-së dhe përkushtimit të tyre në polici në bashkësi, SHPK-ja shkon drejt një imazhi publik më pozitiv. Roli që e ka luajtur EVSB-ja, duke ndihmuar në rritjen e kontaktit në mes policëve të SHPK-së dhe banorëve (si rezultat edhe te prezencës së SHPK-së në EVSB edhe të bashkëpunimit në projekte të ndryshme në mes EVSB-së dhe njësisive të SHPK-së), është shumë i madh. Megjithatë, duhet të jetë një përkushtim i madh në implementimin praktik të policimit në bashkësi dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me EVSB-të, me qëllim të rritjes së besimit publik ndaj policisë dhe besimit në polici.

EVSB-të kanë arritur sukses në krijimin e bashkëpunimit dhe partneritetit të qëndrueshëm në mes të ofruesve të ndryshëm të sigurisë dhe bashkësive ku ata punojnë, si dhe në mes të grupeve të ndryshme brenda bashkësisë. Është rritur dukshëm vetëdija për

aktivitete të përbashkëta në mes bashkësisë, komunës dhe policisë. Programi trajnues të cilën e ka kaluar secili anëtarë i EVSB-së, i ka pajisur me shkathtësi të nevojshme që me sukses të identifikojnë dhe analizojnë brengat e nivelit bazë të shoqërisë lidhur me sigurinë, si dhe nëse paraqitet ndonjë sfidë, të zhvillojnë dhe implementojnë masa të nevojshme për adresimin e tyre. Edhe pse anëtarët e EVSB-së punojnë në baza vullnetare, është e rëndësishme që ekipet të gëzojnë përkrahjen e nevojshme financiare dhe logjistike për të implementuar projektet e tyre, për derisa ka shumë rrëfime të suksesshme, kjo prap paraqet një rëndësori të sfidat më të mëdha të ekipit.

Më në fund, përvoja të fituara janë veç se të identifikuar dhe implementuara, sidomos sa i përket përpilimit dhe zhvillimit të vet programit. Përmirësime në selektim dhe programin trajnues janë implementuar si rezultat i përvojës së më hershme dhe vazhdimisht janë krijuar mekanizma për të adresuar problemet e bashkëpunimit të brendshëm dhe komunikimit. Përkushtimet e vazhdueshme për të përmirësuar këto aspekte dhe përpjekja e përbashkët për të adresuar sfidat tjera, më problematike, paraqesin siguri se EVSB-të do të vazhdojnë të rriten, zhvillohen dhe korrin suksese në bashkësitë e tyre. EVSB-të në Kosovë kanë dëshmuar se janë të aftë për ngritjen e sigurisë dhe përmirësimit të standardit jetësor dhe si të tilla duhet të vazhdojnë të punojnë së bashku që të bëhen liderë të qëndrueshëm në bashkësitë e tyre dhe në tërë Kosovën.¹⁹⁸

198 Ish-trajnues ndërkombëtarë dhe anëtarë i tanishëm i programit të EVSB-së, Vushtrri, 16 Qershor 2008.

Rekomandimet

Siguria në trafik

- Tendencat e fuqishme drejt veprimeve shoqërore në fushën e sigurisë në trafik është e paraqitur qartë në punën e deri tanishme të EVSB-së, si dhe shihet ndikimi që ata e kanë bërë. Në këtë mënyrë, implementimet e qëndrueshme të projekteve të ndërlidhura me trafik duhet të mirren në konsideratë nga autoritetet komunale dhe ministritë relevante qeveritare me qëllim që të vendosin theksin në suksesin e tanishëm dhe të vazhdojnë edhe më tutje.

- Autoritet komunale duhet të ofrojnë përkrahje të mjaftueshme, si logjistike ashtu edhe financiare, për projektet e sigurisë në trafik që realizohen nga ana e EVSB-së dhe partnerët e tyre me qëllim të shmangjes së dështimeve të mundshme në të kaluarën.

- SHPK-ja duhet, në partneritet me EVSB-në dhe shkollat lokale, të vazhdojë të implementoj programet edukative të rregullta për vetëdijësim trafiku.

- SHPK-ja duhet të përpiqet të implementoj qasjen “poshtë – lartë” për të adresuar çështjet e sigurisë në trafik, me ndryshime në qëndrim duke qenë qëllimi kryesor dhe më i qëndrueshëm.

Siguria në Mjedis Jetësor

- EVSB-të duhet të vazhdojnë të punojnë me bashkëvendësit në projektet e mjedisit, si dhe të rrisin vetëdijën sa i përket

dobive nga kjo dhe pasojave si rrjedhojë e shkatërrimit të mjedisit. Përqëndrim i veçantë duhet të bëhet në angazhimin e të rinjëve Kosovar me qëllim të një përmirësimi më të qëndrueshëm.

- Autoritetet komunale duhet të ofrojnë resurse për projekte afat-gjate të mjedisit, siç është mbjellja e drujve, pastrimi i qëndrueshëm i lumenjve dhe iniciativat për zvogëlimin e nivelit të ndotjes me qëllim të fuqizimit të ndikimit pozitiv për pastrim dhe ngritjes së vetëdijës.
- Autoritetet komunale dhe qeveria duhet të shiqojnë për zhvillimin e mekanizmit që në mënyrë efikase të adresohet çështja për prerje ilegale të pyjeve në bashkëpunim me SHPK-në.
- Autoritetet komunale duhet të sigurohen se të gjitha fshatrat dhe qytetet kanë deponitë e duhura për hudhjen e mbeturinave. Ata poashtu duhet të implementojnë një sistem gjithëpërfshirës të "kontrollimeve" përgjatë komunave për tu siguruar se plehërat shtëpiake hudhen në përputhje me standardet e pranueshme. Duhet të mirret në konsideratë dhënja e dënimeve për ata që nuk i respektojnë rreguloret.
- Autoritetet komunale duhet të sigurohen se përkrahja adekuatë, si financiare ashtu edhe praktike, t'ju ipet projekteve për mjedis jetësor që realizohen nga ana e EVSB-ve dhe partnerëve të tyre.
- Autoritetet komunale duhet të sigurohen se vendimet për veprimet e propozuara

rreth qenëve endacak të mirren me kohë dhe të ipet përkrahja e duhur për ata që janë të përfshirë në këtë aktivitet.

Marrëdhënjet ndëretnike

- EVSB-të duhet të vazhdojnë me inkurajimin e ndërveprimit dhe dialogut në mes të bashkësive të ndryshme në Kosovë, përmes zhvillimit dhe implementimit të projekteve gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese.
- EVSB-të duhet të vazhdojnë ti identifikojnë barrierat ekzistuese në komunikimet ndër-etnike në komunat e tyre, si dhe zhvillojnë një mekanizëm me anë të cilit mund t'i adresojnë ato, duke përfshirë edhe forumet ekzistuese të sigurisë publike si KKSB dhe KLSP.
- Pavarësisht barrierave gjuhësore, EVSB-të duhet të vazhdojnë të punojnë me autoritetet komunale dhe shkollat lokale me qëllim të zhvillimit të partneritetit në mes fëmijëve dhe të rinjëve të bashkësive të ndryshme përmes aktiviteteve praktike të përbashkëta dhe projekteve "këmbyese" shkollore.
- Raportet ndërmjet bashkësive të ndryshme duhet të "de-politizohen" sipas retorikës politike dhe koncentrimi duhet të vihet në rritjen e kontaktit të përditshëm në mes të individëve.
- Autoritetet komunale dhe qeveria duhet të bëjnë më shumë përpjekje që të siguroj përkrahje financiare dhe praktike për projektet e EVSB-së që kanë të bëjnë me përmirësimin e raporteve, komunikimit

dhe aktiviteteteve në mes të bashkësive të ndryshme.

Marrëdhëniet bashkësi - SHPK

- EVSB-të duhet të vazhdojnë të ndërtojnë dhe konsolidojnë partneritet me SHPK-në në bashkësitë e tyre përkatëse, edhe me pjesëmarrje nga ana e përfaqësuesve të SHPK-së në ekipet e tyre, dialog të qëndrueshëm si dhe implementim të projekteve në baza bashkëpunimi.
- EVSB-të duhet të vazhdojnë të punojnë me SHPK-në në shkolla me qëllim të edukimit të fëmijëve dhe të rinjëve për punën e SHPK-së me qëllim të krijimit të besimit në aktivitetet e tyre.
- EVSB-të dhe SHPK-ja duhet të vazhdoj me vizitat e përbashkëta si në bashkësitë Shqipëtare e poashtu edhe në ato jo-Shqipëtare me qëllim të identifikimit të problemeve tënorëve dhe të zhvillojnë mekanizmat për t'i adresuar ato, e poashtu të sigurojnë komunikime të rregullta dhe bashkëpunim me popullatën.
- Njësitet vendore të SHPK-së duhet të sigurojnë ndihmë për projektet e B-së kur është e nevojshme dhe e përshtatshme.
- SHPK-ja duhet të jap përkrahje adekuate dhe burime për implementimin plotë dhe efikas të startegjisë së tyre operative për polici në bashkësi.
- SHPK-ja duhet të shiqoj për shkëmbim të informatave në mënyrë më sistematike dhe të rregullt me banorët.

Zhvillimi i Kapaciteteve

- EVSB-të duhet të vazhdojnë të punojnë në aftësitë e komunikimit dhe në përmirëmin e marrëdhënjeve ndërmjet tyre, përbrenda ekipeve të tyre dhe me ekipet e EVSB-ve tjera. Gjithashtu duhet të rrisin nivelin e shkëmbimit të informatave që të mësojnë sa më shumë nga eksperiencia e njëri tjetrit.
- EVSB-të duhet të vazhdojnë për rritjen e ndërgjegjës së popullatës për aktivitetet e tyre dhe informimin sukseseve të tyre. Këshilli Qendror duhet gjithashtu të shikoj mundësin për formimin e tij si resurs qendror për ata që janë të interesuar në sigurinë në bashkësi në Kosovë
- Të gjithë pjesëtarët e EVSB-ve duhet të mbajnë përgjegjësit për pjesëmarrjen në programe dhe të jenë të dhënë pas punës që ata e kanë.
- EVSB-të duhet që të inkuadrojnë më shumë femra dhe të rijnë në ekipet e tyre, si dhe në implementimin e projekteve.
- Udhëheqësit e programit të EVSB-ve duhet të vazhdojnë më trajnimin e instruktorëve lokal që ata mandej të janë më përgjegjës për rritjen e aftësive të pjesëtarëve të EVSB-ve.
- Autoritetet komunale duhet që të shikojnë për vendosjen e fondeve buxhetore për EVSB-të që të sigurojnë ndihmën e domosdoshme për projektet specifike të EVSB-ve. Ekzistimi i EVSB-ve varet shumë nga niveli i duhur i përkrahjes.

- EVSB-të dhe Këshilli Ekzekutiv duhet të zhvillojnë kapacitetet tyre që në mënyrë të pavarur ti sigurojnë ndihmën financiare nga resurset lokale dhe ndërkombëtare. Kishte me qenë shumë në dobi nëse programi trajnues i EVSB-ve të mbaj një trajnim për projektet dhe gjetjen e donatorëve për përkrahje financiare.

- Ekipet e EVSB-ve, Këshilli Ekzekutiv dhe ekipi i programit duhet që të bëjnë një sistem të mbikëqyrjes së përgjithshme dhe të rregullt që të janë më azhur në aktivitetet që kanë projektet e EVSB-ve dhe të vlerësojnë arritjen e tyre dhe të zgjidhin ndonjë problem apo pyetje të paqartë. Kjo duhet të kordinohet nga Këshilli Ekzekutiv që të sigurohet qëndrueshmëria lokale si dhe të ndalet varësia nga ajo e jashtëmja (ndërkombëtare) në monitorime që është duke vazhduar.

